

**TAP**

Trans Adriatic Pipeline



**Raporti i Studimit, Scoping të VNMS-së  
(Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social)  
për Shqipërinë**

**Trans Adriatic Pipeline AG - Albania (Branch Office)**  
Torre Drin, Abdi Toptani street, 5th Floor  
Tirana, Albania

Phone: + 355 44 308 770 Fax: + 355 42 265 685  
[esia-comments@tap-ag.com](mailto:esia-comments@tap-ag.com)  
[www.trans-adriatic-pipeline.com](http://www.trans-adriatic-pipeline.com)

E lëshuar 04/2011

Ruajtja e të Drejtave: Ky dokument nuk mund të kopjohet, t'u tregohet ose të vihet në dispozicion të palëve të treta pa marrë miratimin paraprak të TAP AG. Versioni më i fundit i dokumentit është regjistruar në bazën e të dhënave të Projektit TAP.

## INDEKSI

	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	I
1	HYRJA	1
1.1	VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT	1
1.2	PROCESI I VNMS	3
1.2.1	Hyrja	3
1.2.2	Qasja ndaj "Scoping"	5
1.3	STRUKTURA E "SCOPING"	6
2	RREGULLORET DHE UDHËZIMET	8
2.1	KUADRI LIGJOR SHQIPTAR PËR VNM	8
2.2	KËRKESAT E PERFORMANCËS SË BERZH PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL	9
2.3	KONVENTA/MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE NË LIDHJE ME VNMS	10
3	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PËRZGJEDHURA	11
3.1	HYRJA	11
3.2	PJESA KONTINENTALE	11
3.2.1	Të përgjithshme	11
3.2.2	Metodologjia	13
3.2.3	Gjetjet e Vlerësimit të Alternativave	13
3.2.4	Stacionet e Kompresorit	14
3.3	NË DET DHE KALIMI NË DET	15
3.3.1	Hyrja	15
3.3.2	Procesi i Përzgjedhjes së Gjurmës dhe Rezultatet	15
3.3.3	Kalimet në det	16
4	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	18
4.1	HYRJA	18
4.1.1	Përshkrimi i Përgjithshëm	18
4.1.2	Siguria	19
4.2	PJESA KONTINENTALE	19
4.2.1	Hyrja	19
4.2.2	Ndërtimi i Tubacionit	19
4.2.3	Para-Përdorimit	25
4.2.4	Funksionimi	25
4.2.5	Nxjerrja nga përdorimi	26
4.3	PJESA DETARE	26
4.3.1	Hyrja	26
4.3.2	Ndërtimi i Tubacionit	26
4.3.3	Para-Përdorimi (Hidrotestimi)	30
4.3.4	Funksionimi	30
4.3.5	Nxjerrja nga Përdorimi	30

5	<b>KUSHTET BAZË</b>	31
5.1	<i>PJESA KONTINENTALE</i>	31
5.1.1	<i>Hyrja</i>	31
5.1.2	<i>Mjedisi</i>	31
5.1.3	<i>Aspektet Socio-Ekonomike</i>	37
5.1.4	<i>Trashëgimia Kulturore</i>	38
5.2	<b>SEKSIONI DETAR</b>	38
5.2.1	<i>Mjedisi</i>	38
5.2.2	<i>Aspektet Socio-ekonomike</i>	41
5.2.3	<i>Trashëgimia Kulturore</i>	43
6	<b>NDIKIMET E MUNDSHME DHE MASAT ZBUTËSE</b>	44
6.1	<b>HYRJA</b>	44
6.2	<i>PJESA KONTINENTALE</i>	46
6.2.1	<i>Ndërtimi</i>	46
6.2.2	<i>Operimi</i>	56
6.3	<i>PJESA DETARE</i>	61
6.4	<i>GJETJET KRYESORE TË VLERËSIMEVE PARAPRAKE</i>	65
7	<b>TERMAT E REFERENCËS PËR VNMS</b>	66
7.1	<b>HYRJA</b>	66
7.2	<b>OBJEKTIVAT E VNMS</b>	66
7.3	<b>HAPAT E VNMS</b>	67
7.4	<b>STUDIMET E SPECIALISTËVE</b>	67
7.4.1	<i>Studimet nga Zyra</i>	67
7.4.2	<i>Studime në Terren</i>	68
7.5	<b>ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT</b>	68
7.5.1	<i>Konsultimi i kushtevebazë</i>	68
7.5.2	<i>Paraqitja e Raportit VNMS dhe Konsultimet</i>	69
7.6	<b>STRUKTURA E RAPORTIT VNMS</b>	69
7.7	<b>PLANI PARAPRAK PËR VNMS</b>	71
8	<b>ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT</b>	72
8.1	<b>HYRJA</b>	72
8.2	<b>FAZAT E ANGAZHIMIT TË GRUPEVE TË INTERESIT PËR PROJEKTIN TAP</b>	72
8.2.1	<i>Përmbledhje</i>	72
8.2.2	<i>Konsultimet Para fazes Para-Studimore “Scoping”</i>	73
8.3	<b>FAZA PARA-STUDIMORE “SCOPING” DHE ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT</b>	75
8.3.1	<i>Objektivat</i>	75
8.3.2	<i>Aktivitetet e Angazhimit të Aktorëve</i>	76
8.4	<b>MEKANIZMI I ANKIMIMIT</b>	78
8.5	<b>BURIMET DHE PËRGJEGJËSITË</b>	78
8.6	<b>KOMENTET DHE SUGJERIMET E PUBLIKUT</b>	79

## LISTA E SHTOJCAVE

**SHTOJCA A - Hartat**

**SHTOJCA B - Formulari i Komenteve**

**SHTOJCA C - Lista e Grupeve të Interesit**

**SHTOJCA D - Plani i Veprimit të VNMS**

**SHTOJCA E - Referencat**

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1.1	TAP në Shqipëri (pjesa kontinentale)
Figura 1.2	TAP në Shqipëri (pjesa detare)
Figura 1.3	Skematika e Procesit VNMS
Figura 3.1	CS3 Vendndodhja Alternative
Figura 3.2	Alternativat e Daljes në Det
Figura 4.1	Brezi normal i Punimeve
Figura 4.2	Brezi i Punimeve i Reduktuar
Figura 4.3	Stacioni i Kompresorit – Planimetri tipike
Figura 4.4	Tuneli
Figura 4.5	Platformë Lundruese Standarte për Vendosjen e Tubave në Ujëra të Cekta
Figura 4.6	Teknika Tipike e Shtrimit të Tubave
Figura 4.7	Skema e një Veprimi Dragimi me Thithje
Figura 5.1	Prodhimi i Peshkut sipas Kapjes në Shqipëri midis 1970 dhe 20073
Figura 5.2	Linjat e Transportit të Mallrave në Detin Adriatik dhe Jon

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1.1	Përmbledhja e Procesit VNMS
Tabela 2.1	Kuadri Ligjor Shqiptar për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor
Tabela 2.2	Konventat Ndërkombëtare dhe Marrëveshjet e Nënshkruara/Ratifikuara nga Shqipëria në Lidhje me Procesin e VNMS
Tabela 6.1	Ndikimet e Mundshme Mjedisore dhe Masat Zbutëse Lidhur me Ndërtimin në Tokë dhe Futjen në Punë
Tabela 6.2	Ndikimet e Mundshme Socio-ekonomike dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Ndërtimin në Tokë dhe Futjen në Punë
Tabela 6.3	Ndikimet e Mundshme të Trashëgimisë Kulturore dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Ndërtimin në Tokë dhe Futjen në Punë
Tabela 6.4	Ndikimet e Mundshme Mjedisore dhe Masat Lehtësuese lidhur me Operimin në Pjesën Kontinentale
Tabela 6.5	Ndikimet e Mundshme Socio-ekonomike dhe Masat Zbutëse lidhur me Operimin në Pjesën Kontinentale
Tabela 6.6	Ndikimet e Mundshme mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Operimin në Pjesën Kontinentale dhe Nxjerrjen nga Përdorimi të Gaz-sjellesit
Tabela 6.7	Ndikimet e Mundshme të Trashëgimisë Kulturore, socio-ekonomike dhe Mjedisore dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Ndërtimin në Det
Tabela 6.8	Ndikimet e Mundshme të Trashëgimisë Kulturore, Socio-Ekonomike dhe Mjedisore dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Operimin në Det
Tabela 7.1	Struktura e Sygjeruar e Raportit VNM
Tabela 7.2	Kalendari për VNMS dhe Konsultimet me Grupet e Interesit
Tabela 8.1	Fazat e Angazhimit të aktorëve gjatë VNMS
Tabela 8.2	Përmbledhje e Çështjeve të Paraqitjes
Tabela 8.3	Grupet kryesore të palëve të interesuara për Fazën e Angazhimit gjatë VNMS
Tabela 8.4	Takimet për fazën Para-Studimore “Scoping”

## AKRONIMET DHE SHKURTIMET

<b>BAT</b>	Best Available Technique - Teknikat më të Mira të Disponueshme
<b>BERZH</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim - European Bank for Reconstruction and Development (EBRD)
<b>CEP</b>	Community Engagement Plan - Plani i Përfshirjes së Komunitetit
<b>CoNISM</b>	Consorzio Nazionale Interuniversitario per le Scienze del Mare
<b>CORINE</b>	Coordination of Information on the Environment - Koordinimi i Informacionit mbi Mjedisin
<b>CS</b>	Compressor Station - Stacioni i Kompresorit
<b>ESD</b>	ESIA Scoping Document - Raporti i Studimit Scoping të VNMS
<b>ESIA</b>	Environmental and Social Impact Assessment - Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
<b>GIS</b>	Geographic Information System - Sistemi i Informacionit Gjeografik
<b>HSE</b>	Health, Safety and Environment - Shëndeti, Siguria dhe Mjedisi
<b>ICH</b>	Intangible Cultural Heritage - Trashëgimia Kulturore Jomateriale
<b>INSTAT</b>	Statistical Institute of Albania - Instituti i Statistikave të Shqipërisë
<b>IUCN</b>	International Union for Conservation of Nature - Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
<b>MARPOL</b>	International Convention for the Prevention of Pollution From Ships - Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet
<b>MMK</b>	Miliardë Metra Kub
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>RAP</b>	Resettlement Action Plan - Plani i Veprimit të Risistemimit
<b>RoW</b>	Right of Way - E Drejta e Gjurmës
<b>SSS</b>	Side Scan Sonar
<b>TAP</b>	Trans Adriatic Pipeline - Gazsjellësi/Tubacioni Trans Adriatik
<b>UXO</b>	Unexploded Ordinance - Mina të Pashpërthyer
<b>VNM</b>	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
<b>VNMS</b>	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social

## **PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**

### **1**

#### **HYRJA**

Gazsjellësi Trans Adriatik Pipeline (TAP) është një tubacion i propozuar brenda Korridorit Jugor, i cili sjell gaz nga burime të reja në zonën e Detit Kaspik drejt Evropës Perendimore dhe Juglindore.

Tubacioni prej 520 km do të lidhë rrjetet ekzistuese të gazit në Greqi, do të kalojë nëpër Shqipëri dhe Detin Adriatik dhe do të përfundojë në brigjet e Italisë Jugore, duke lejuar gazin që të rrjedhë drejtpërdrejt nga bazeni i Kaspikut drejt tregjeve evropiane.

Aksionerët e TAP janë kompania zvicerane EGL (42.5%), kompania norvegjeze (42.5%) dhe kompania gjermane E.ON Ruhrgas (15%).

TAP do të kontribuojë në sigurinë dhe diversifikimin e furnizimeve me gaz, duke ofruar infrastrukturën e nevojshme për transportin e gazit nga fusha e Shah Deniz II në Azerbajxhan, përmes rrugës së drejtpërdrejtë drejt Evropës Jugore, sapo të fillojë prodhimi i kësaj fushe në fillim të vitit 2017. Ndërsa furnizimi me gaz do të rritet, TAP do të ketë aftësinë të transportojë 10 mmk më shumë në vit, duke e rritur kapacitetin në 20 mmk, sipas nevojave.

TAP mbështetet financiarisht nga aksionerë të fortë/të qendrueshëm. Projekti nuk do të kërkojë fonde nga subvencione apo nga qeveritë e vendeve pritëse. TAP mund të sjellë përfitime të rëndësishme përsa u përket investimeve të mëdha dhe punësimit në vendet ku ai kalon. Bashkimi Evropian e njeh këtë projekt në kuadrin e udhëzimeve të të ashtuquajturave TEN-E (Rrjetet e Energjisë Trans Evropiane) si një Projekt me Interes të Përbashkët për objektivat e përgjithshme të politikë energjitike të Bashkimit Evropian.

Si fillim, sistemi i tubacionit që do të kalojë nëpër Shqipëri do të përbëhet nga një tubacion në pjesën kontinentale prej rreth 200 km të gjatë, një tubacion detar prej rreth 60 km të gjatë dhe një stacion kompresori afër Fierit (të cilit i referohemi gjithashtu edhe si CS3) me një kapacitet prej 10 miliardë metra kub (MMK) gaz natyror në vit (rreth 1.520.000 metra kub në orë). Në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, përafërsisht në çdo 30 km të tubacionit në pjesën kontinentale do të instalohen stacione valvolash të bllokimit për të ndërprerë rrjedhjen e gazit në rast mirëmbajtjeje apo emergjence. Në një fazë më të vonët do të ndërtohet një stacion i dytë kompresori (CS2) afër Mirasit, në afërsi të kufirit me Greqinë, për të rritur kapacitetin e rrjedhjes në tubacion nga 10 në 20 MMK (nga 1.520.000 në 3.040.000 metra kub në orë).


*Figura 1.1* tregon gjurmën e TAP në pjesën kontinentale në Shqipëri, ndërsa *Figura 1.2* tregon seksionin detar. Gjurma e rastit bazë të TAP në Shqipërisë (vija e kuqe në Figurat 1.1 dhe 1.2) është përzgjedhur në bazë të një procesi të gjerë dhe

të plotë të vlerësimit të traseve alternative të kryer nga TAP në vitet 2009-2010, me qëllimin për të përzgjedhur një trase teknikisht të mundshme për tubacionin dhe e cila do të ketë ndikimin më të ulët mjedisor, socio-ekonomik dhe kulturor (ju lutem shihni Seksionin 3 të raportit kryesor). Procesi i identifikimit të gjurmës ka përfunduar për pjesën më të madhe të gjurmës së rastit bazë, me përjashtim të një seksioni prej rreth 30 km ndërmjet kufirit Shqipëri-Greqi dhe Vithkuqit dhe pjesës më perëndimore të gjurmës midis Fierit dhe vijës bregdetare (shihni vijat e verdha në figurën 1.1). Në mënyrë të ngjashme, vendndodhja e saktë e stacionit të kompresorit (CS3) pranë bregdetit dhe alternativat e kalimit nga toka në det janë aktualisht ende nën shqyrtim (shihni Seksionin 3 për vendndodhjet e mundshme).

**Figura 1.1 TAP në Shqipëri (pjesa kontinentale)**



**Figura 1.2 TAP në Shqipëri (pjesa detare)**



Gjurma e rastit bazë të TAP në Shqipërisë (vija e kuqe në Figurat 1.1 dhe 1.2) është përzgjedhur në bazë të një procesi të gjerë dhe të plotë të vlerësimit të traseve alternative të kryer nga TAP në vitet 2009-2010, me qëllimin për të përzgjedhur një trase teknikisht të mundshme për tubacionin dhe e cila do të ketë ndikimin më të ulët mjedisor, socio-ekonomik dhe kulturor (ju lutem shihni Seksionin 3 të raportit kryesor).

Procesi i identifikimit të gjurmës ka përfunduar për pjesën më të madhe të gjurmës së rastit bazë, me përjashtim të një seksioni prej rreth 30 km ndërmjet kufirit Shqipëri-Greqi dhe Vithkuqit dhe pjesës më perëndimore të gjurmës midis Fierit dhe vijës bregdetare (shihni vijat e verdha në figurën 1.1). Në mënyrë të ngjashme, vendndodhja e saktë e stacionit të kompresorit (CS3) pranë bregdetit dhe alternativat e kalimit nga toka në det janë aktualisht ende nën shqyrtim (shihni Seksionin 3 për vendndodhjet e mundshme).

## 1.2

### **QËLLIMI I RAPORTIT**

Një projekt me të tilla karakteristika duhet të kalojë nëpër një proces të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM) sipas legjislacionit shqiptar. Për më tepër, vullnetarisht, TAP ka marrë përsipër të ndjekë Praktikën Ndërkombëtare më të rrepta për këtë projekt, në formën e pajtueshmërisë me standardet e BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim).

Një nga kërkesat e procesit të VNM (i cili nga këtu e më tej do të quhet Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social për të qenë në përputhje me terminologjinë e përdorur nga BERZH), është që të kyej një proces paraprak të quajtur “scoping”. Ky është një proces nëpërmjet të cilit bëhen konsultime me palët e interesuara në mënyrë që këto të fundit të kontribuojnë në identifikimin e çështjeve kyçe që do të shqyrtohen si pjesë e vetë VNMS. Ky dokument i raportit “scoping” të VNMS është përgatitur në zbatim të kësaj kërkesë dhe të kërkesave të Direktivës së EU për VNM. Produkti kryesor i këtij procesi do të jetë përcaktimi i qëllimit dhe përmbajtjes përfundimtare të VNMS së plotë, duke marrë në konsideratë të dhënat nga palët e interesuara, si dhe kërkesat specifike të autoriteteve shqiptare dhe grupeve të tjera të interesit.

### **1.3 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

#### **1.3.1 Pamja e përgjithshme**

Tubacioni në pjesën kontinentale do të ketë një diametër prej 48 inç (1.219 m), ndërsa diametri i tubacionit detar do të reduktohet në 42 inç (1.067 m). Tubacioni do të përbëhet nga seksione të salduara tuba sh çeliku, të cilët do të jenë përafërsisht 18 m të gjatë. Seksionet e tubave të çelikut do të jenë të veshura/mbuluara nga jashtë. Disa nga pjesët e tubacionit do të jenë gjithashtu të veshura/mbuluara dhe me beton të përforcuar për ta mbrojtur tubacionin nga dëmtimi i jashtëm. Në gjithë gjatësinë e tij, tubacioni do të jetë i mbrojtur kundër gërryerjes nëpërmjet një sistemi të mbrojtjes katodike.

Seksioni në pjesën kontinentale të tubacionit do të jetë i futur nën tokë gjatë gjithë gjatësisë së tij me një mbulesë dheu të paktën prej 1 m. Në rastet e kalimeve nën infrastrukturat ekzistuese, do të kërkohet një thellësi më e madhe. Seksioni detar do të shtrihet mbi shtratin e detit, me përjashtim të seksionit në ujërat e cekëta (deri në 10 m thellësi), i cili do të futet në një thellësi që tejkalon 2 m. Në pikën e kalimit në det, tubacioni pritët të futet në një thellësi deri në 4 m. Tubacioni i TAP do të projektohet për një jetëgjatësi teknike prej 50 vjetësh.

#### **1.3.2 Tubacioni në pjesën kontinentale**

Projekti i TAP në pjesën e tij kontinentale në Shqipëri do të përbëhet nga këta komponentë kryesorë: tubacioni në pjesën kontinentale, 6-7 stacione valvolash të bllokimit, stacionet e kompresorëve (CS3 dhe CS2) dhe pajisjet/lehtësirat shoqëruese që do të jenë të nevojshme gjatë procesit të ndërtimit (rrugët hyrëse, kampet, sheshet e ndërtimit, etj). TAP do të ketë nevojë për 7 pika të përkohshme

për mbajtjen/magazinimin e tubave, 5 pika magazinimi të përkohshme për pajisjet dhe 5 sheshe kampimi. TAP do të përmirësojë rreth 90 km rrugë ekzistuese, do të hapë rreth 40 km rrugë të reja dhe në përfundim do t'i rikthejë të gjitha rrugët dhe terrenin në gjendjen që ato ishin para fillimit të projektit.

Tubacioni në pjesën kontinentale do të montohet në një mënyrë konvencionale me ndihmën e pajisjes së posaçme të ndërtimit që vijon përgjatë korridorit të tubacionit. Brezi i ndërtimit kërkon një gjerësi prej rreth 40 m, pasi ai duhet të sigurojë hapësirë për montimin e tubacionit dhe për automjetet që do të lëvizin në të njëjtën kohë. TAP synon që ta rikthejë këtë brez ndërtimi në gjendjen e tij origjinale. Kufizimet kryesore për përdorimin e tokës mbi tubacion do të prekin një korridor të ngushtë, maksimalisht 10 m të gjerë, në të cilin do të kufizohet rritja e pemëve me rrënjë të thella, një korridor maksimalisht 60 m, në të cilin ndërtimi i shtëpive do të kufizohet dhe një korridor prej maksimum 200 m, në të cilin krijimi i lagjeve të shtëpive dhe/ose i infrastrukturës industriale do të jetë i kufizuar. Gjurma e preferuar u përzgjodh duke marrë në konsideratë këto kritere dhe ajo krijon gjithashtu hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e ardhshëm të komuniteteve përreth.

Për të rritur sigurinë e tubacionit, tubacioni do të ketë stacione valvolash të bllokimit, me anë të të cilave çdo segment i linjës mund të izolohet për arsye mirëmbajtjeje ose në rast të një shkëputjeje apo rrjedhjeje. Valvolat e bllokimit nuk do të operohen nga njerëzit dhe do të mbulojnë një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 500 m<sup>2</sup>. Pajisjet kryesore të këtyre stacioneve do të instalohen nën tokë.

Stacionet e kompresorit nevojiten për të transportuar gazin duke rritur trysinë. Çdo stacion kompresori do të përbëhet kryesisht nga pajisjet për trajtimin e gazit, matjen, ngjeshjen dhe ftohjen. Sipërfaqja e terrenit të nevojshëm për stacionin e kompresorit është vlerësuar të jetë rreth 100 ha. Sipërfaqja e nevojshme për ndërtimin e stacionit të kompresorit është përafërsisht 2 ha. Pjesa tjetër e mbetur e sipërfaqes do të mbetet bosh, duke qenë se stacioni i kompresorit do të jetë i pozicionuar brenda kësaj sipërfaqeje, për të siguruar largësi të mjaftueshme nga ndërtesat e tjera apo nga infrastruktura përreth.

Gjatë funksionimit, tubacioni do të monitorohet dhe kontrollohet nga një dhomë qendrore kontrolli në një vendndodhje që mbetet ende për t'u konfirmuar. Gjatë operimit, do të kryhen matje të vazhdueshme të presionit dhe të normave të rrjedhjes në pikat e hyrjes dhe daljes së tubacionit. Nëse ndodh të vërehet një rrjedhje, do të zbatohen menjëherë procedurat e mbylljes së emergjencës. Për të mundësuar inspektimin e brendshëm të tubacionit, do të instalohen pajisje matëse.

### **1.3.3**

#### ***Tubacioni detar***

Gjatësia e gjurmës së tubacioni detar është rreth 60 km nga bregdeti shqiptar deri në pikën e mesme midis Shqipërisë dhe Italisë në ngushticën e Otrantos (Deti Adriatik). Tubacioni më pas vazhdon në drejtim të bregdetit italian.

Tubacioni detar do të instalohet duke përdorur një platformë instalimi e cila është një platformë tipike që përdoret për shtrimin e tubacioneve. Seksionet e tubacionit saldohen së bashku mbi platformë dhe tubacioni shtrihet në shtratin e detit, ndërsa platforma lundruese lëviz përgjatë gjurmës. Hapja e kanaleve pranë brigjeve do të kryhet duke përdorur teknika gërryerje. Sedimentet/llumërat e gërryerjes lihen përkohësisht në afërsi të kanalit dhe më pas këto sedimente do të përdoren për të mbushur kanalën sapo të jetë shtirë tubacioni. Në ujërat e cekëta, kanali mund të përforcohet edhe me një shtresë gurësh shkëmborë të copëtuar apo zhavorri për të stabilizuar tubacionin.

Procesi i gërryerjes do të përdoret gjithashtu edhe në ndërtimin e pikës së kalimit në det që zakonisht përfshin gërmimin e kanalit dhe ndërtimin e një dige izoluese (diga izoluese është një rrethim brenda ujit, e ndërtuar për të lejuar ujin që të nxirret jashtë me pompë për të krijuar një mjedis të thatë pune), futjen e tubave në kanal nëpërmjet çikrikëve, heqjen e digës izoluese dhe zëvendësimin e dheut të gërmuar dhe mbushjen me materiale të tillë si zhavorr dhe gurë. Aktivitetet operacionale të seksionit detar do të integrohen me aktivitetet e seksionit në pjesën kontinentale të tubacionit si një sistem i vetëm. Gjendja e jashtme e tubacionit detar, duke përfshirë edhe kushtet e sistemit të mbrojtjes katodike, do të monitorohet rregullisht.

## **1.4**

### ***KUSHTET BAZË***

#### **1.4.1**

##### ***Seksioni në pjesën kontinentale***

Seksioni lindor i gjurmës ndërpritet nga Mali i Moravës, i cili shtrihet në drejtim veri-jug dhe arrin një lartësi mbi 1800 m në pikën e tij më të lartë. Pyjet halorë dhe gjethegerë të këtij seksioni lindor janë habitate të rëndësishme për gjitarët e mëdhenj dhe mishngrënësit. Kjo pjesë e gjurmës karakterizohet nga vendbanime të vogla; vetëm tre prej tyre kanë një popullsi prej mbi 400 banorësh. Pyjet dhe shkurret janë habitati kryesor në këtë korridor. Kjo tokë, së bashku me tokën e caktuar për kullota, është përdorur nga banorët e zonës për bagëti dhe prodhimin e kulturave sezonale.

Pjesa qendrore e gjurmës kalon nëpër një zonë që karakterizohet nga një relief malor, terrene të thepisura dhe kontraste të mëdha. Në këtë pjesë qendrore përgjatë gjurmës gjenden zonat kryesore me interes për bimësinë dhe florën, duke përfshirë pyje të vjetër, zona natyrore barishtore nën alpine si dhe habitatin lumor të lumit Osum. Terreni është i karakterizuar nga zona pyjore dhe malore me fusha të vogla toke bujqësore përreth vendbanimeve si dhe nga një kombinim i prodhimit të kulturave bujqësore dhe fermave blegtorale, një përqindje e lartë e të cilave përdoret për të mbuluar nevojat e jetesës. Çorovoda është qyteza kryesore në këtë zonë. Pjesa tjetër e vendbanimeve janë relativisht të vogla me popullsi zakonisht nga 100-400 banorë.

Seksioni perëndimor kalon nëpër një sërë tipologjish gjeografike nga zonat malore, në zona kodrinore dhe më pas në zona fushore të sheshta bregdetare. Ekzistojnë dy sisteme kryesore ujëndarëse të lumenjve, sistemet ujëndarëse të lumit Seman-Osum dhe të lumit Vjosë. Habitatet natyrore janë më të rralla në këtë seksion për shkak të shfrytëzimit në një shkallë më të madhe të tokës (shfrytëzim kryesisht për nevoja bujqësore). Habitatet e përrrenjve/lumenjve dhe ligatinat janë ato që paraqesin interes të lartë ekologjik. Rrethi i Beratit ka një terren kodrinor me një mozaik kulturash bimore, sezonale dhe të përhershme, si dhe kullota. Rrethi i Fierit ka një terren më të sheshtë dhe përdoret në mënyrë më të njëtrajtshme për prodhimin e kulturave sezonale. Afërsia e madhe midis qyteteve të Beratit dhe Fierit, përveç zonës së nxjerrjes së naftës në komunën e Roskovecit, sjell një ekonomi më të diversifikuar se në sektorët e tjerë.

Gjurma e tubacionit nuk do të kalojë nëpër ndonjë nga zonat aktualisht të mbrojtura. Në seksionin lindor, zona më e afërt e mbrojtur është Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës, Dangëlli, që shtrihet rreth 3 km në jug të gjurmës. Në seksionin qendror, gjurma kalon në një largësi prej 1 km nga Rezervati Natyror i Menaxhuar i Bogovës. Në seksionin perëndimor pika më e afërt e mbrojtur me gjurmën është Monumenti Natyror i Pyllit të lartë përgjatë shtratit të vjetër të Lumit Seman (Adriatik, Libofshë), që ndodhet përafërsisht rreth 3 km në veri të gjurmës.

#### **1.4.2**

#### ***Seksioni detar***

Thellësia e ujit përgjatë gjurmës së propozuar varion nga 0 deri në rreth 800 m. Sedimentet e gjetura vijnë kryesisht nga materialet e transportuara nga lumenjtë. Grykëderdhja më e afërt me pikën e kalimit në det është lumi Seman në veri. Si rezultat, shtrati i detit përgjatë gjurmës së propozuar është i mbuluar nga sedimente të buta, të formuara kryesisht nga rëra e butë dhe balta. Zona karakterizohet nga një diversitet i ulët llojesh fundore detare, si rezultat i depozitimeve të sedimenteve terrigjene që shkarkohen nga lumenjtë e shumtë të

bregdetit shqiptar. Këto kushte sjellin gjithashtu dhe mungesën e livadheve fundore detare.

Fauna e peshqve të zonës përbëhet si nga llojet demersalë (peshqit që jetojnë në afërsi të fundit të detit) ashtu dhe ata pelagjikë (peshqit që jetojnë zakonisht në kolonën e ujit në zonën pelagjike). Llojet më të rëndësishme të peshkut të tregtueshëm përfshijnë merlucin, levrekun, sardelen dhe kocen. Në detin Adriatik janë regjistruar tre lloje breshkash detare, me te cilat nënkuptojmë breshkën e detit, breshkën e gjelbër dhe breshkën lëkurore detare, kjo e fundit konsiderohet një vizitore e rrallë. Përsa u përket gjitarëve të detit, me gjithë mungesën e studimeve të veçanta, pesë lloje mund të konfirmohen si banorë të ujërave shqiptare: kashaloti, balena me sqep, delfini turishkurtër, delfini me viza dhe delfini i zakonshëm.

Kufiri detar midis Shqipërisë dhe Italisë në pllakën kontinentale është përcaktuar nga një marrëveshje e nënshkruar në vitin 1992. Peshkimi dhe lundrimi janë të hapura për vendet e tjera për aq kohë sa nuk është përcaktuar asnjë Rezervë Peshkimi ose Zonë e Përjashtimit Ekonomik, siç është rasti midis Shqipërisë dhe Italisë. Sektori i peshkimit në Shqipëri është ende një sektor relativisht i vogël për vendin në tërësi. Flota e peshkimit në Shqipëri është shumë e kufizuar. Tregtia e peshqve në Shqipëri është e përqendruar kryesisht në zonat në afërsi të katër porteve kryesore. Modeli i tregtimit është fare i thjeshtë si rezultat i numrit të vogël të operatorëve. Porti i Durrësit, që është porti kryesor i Shqipërisë dhe që ndodhet rreth 75 km në veri të vend-kalimit së tubacionit në det, pret numrin më të madh të anijeve të peshkimit në Shqipëri. Bregdeti i qarkut të Fierit ka një potencial të mesëm deri në të lartë për zhvillimin e turizmit. Aktualisht ekzistojnë shumë pak struktura të organizuara turizmi.

## **1.5**

### ***NDIKIMET E MUNDSHME DHE MASAT LEHTËSUESE***

Ndikimet mjedisore dhe socio-ekonomike të projektit janë identifikuar dhe vlerësuar paraprakisht gjatë procesit të studimit. Vlerësimi është bazuar mbi informacionin që projekti ka aktualisht në dispozicion, të dhënat bazë të mbledhura deri më sot dhe përvojën e fituar në projekte të ngjashme të ndërtuara në kontekste të ngjashme mjedisore dhe socio-ekonomike. Janë identifikuar gjithashtu paraprakisht masa lehtësuese dhe masa menaxhuese për çdo ndikim të mundshëm. Gjasat, përmasat dhe rëndësia e ndikimeve të identifikuara gjatë procesit “scoping” do të vlerësohen më tej në VNMS e detajuar.

Ndikimet kryesore mjedisore, socio-ekonomike dhe kulturore janë shmangur me anë të një vlerësimi të gjerë të gjurmës, i cili kishte qëllim të përzgjidhte një trase me ndikimin më të ulët.

Ndikimet e ndërtimit të një tubacioni dhe ambjenteve/lehtësirave shoqëruese janë zakonisht të përkohshme në llojin e tyre dhe të lokalizuara. Ndikimet kryesore të përhershme janë të lidhura më lehtësirat shoqëruese. Ndikimet e ndërtimit përfshijnë zhurma të përkohshme dhe shkarkime në ajër nga makineritë e ndërtimit, ndikime mbi përdorimin e tokës, humbje/shqetësim të habitateve natyrore (flora dhe fauna), ndikime mbi peizazhet dhe ndikimet të përkohshme mbi cilësinë e ujit dhe të habitateve ujore gjatë kalimeve të lumenjve dhe punimeve detare në afërsi të bregut. Përmasat dhe rëndësia e ndikimit të ndërtimit do të varen nga kushtet vendore. Zakonisht ndikimet e ndërtimit mund të menaxhohen dhe të zbuten në mënyrë efikase.

Tubacioni i pjesës kontinentale do të futet nën tokë dhe terreni do të kthehet në gjendjen e tij fillestare të para ndërtimit. Kufizimet kryesore për përdorimin e tokës mbi tubacion do të prekin një korridor të ngushtë, maksimalisht 10 m të gjerë, në të cilin do të kufizohet rritja e pemëve me rrënjë të thella, një korridor maksimalisht 60 m, në të cilin ndërtimi i shtëpive do të kufizohet dhe një korridor prej maksimum 200 m, në të cilin krijimi i lagjeve të shtëpive dhe/ose i infrastrukturës industriale do të jetë i kufizuar. Gjurma e preferuar u përzgjedh duke marrë në konsideratë këto kritere dhe ajo krijon gjithashtu hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e ardhshëm të komuniteteve përreth. Funksionimi i stacioneve të kompresorëve do të gjenerojë shkarkime në ajër dhe zhurmat do të kenë një ndikim mbi peizazhin. Përmasat dhe rëndësia e këtyre ndikimeve janë të krahasueshme me ato të centraleve të vogla të bashkë-prodhimit me gaz. Do të miratohen praktikatat më të mira dhe masa lehtësuese për të minimizuar ndikimet operacionale. Ndikimet mbi peizazhin do të menaxhohen nëpërmjet restaurimit të peizazhit në gjendjen fillestare përgjatë gjurmës së tubacionit dhe nëpërmjet instalimit të një bimësie të përhershme aty ku është e nevojshme.

## **1.6**

### ***TERMAT E REFERENCËS PËR VNMS***

TAP do të organizojë një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor dhe Social të detajuar dhe të integruar, i cili do të zhvillohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH (2008). Hapat kryesore të VNMS përfshijnë:

- Rifreskimin dhe finalizimin e përshkrimit teknik të projektit, ndërsa bëhen të disponueshme detaje të tjera inxhinierike;
- Kryerjen e konsultimeve të tjera dhe përsosjen më tej të qëllimit të VNMS sipas nevojës;

- Mbledhjen e të dhënave të tjera bazë përmes kërkimeve jo në terren dhe në terren për të plotësuar një përshkrim të plotë të kushteve mjedisore, sociale dhe trashëgimisë kulturore;
- Vlerësimin e ndikimeve;
- Zhvillimin e masave lehtësuese dhe përmirësuese dhe përgatitjen e një Plani të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS), duke përfshirë dhe një qasje për monitorimin;
- Paraqitjen e gjetjeve në një raport të plotë të VNMS, i cili do t'u dorëzohet autoriteteve.
- Për të pasur një të kuptuar të plotë të kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale të zonës mbi të cilën projekti do të ketë ndikim si dhe për të vlerësuar ndikimet, do të ndërmerren studime të mëtejshme si në terren ashtu dhe nga zyra. Këto studime do të ndërmerren nga një ekip ndërdisiplinor specialistësh të kualifikuar shqiptarë dhe të huaj.

Studimet në terren do të përfshijnë marrjen e mostrave dhe analizën e mostrave të dheut, të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore, të sedimenteve të lumenjve, të sedimenteve detare, të cilësisë së ajrit dhe nivelit të zhurmës në mjedis. Përveç këtyre do të ndërmerren dhe vrojtime mjedisore (flora, fauna, habitatet, bimësia), socio-ekonomike (angazhimi i palëve të interesuara, anketat për ekonomitë familjare, etj) dhe të trashëgimisë kulturore. Do të ndërmerren gjithashtu dhe vrojtime specifike në mjedisin detar.

## 1.7

### **ANGAZHIMI ME GRUPET E INTERESIT**

Konsultimet dhe angazhimi me grupet e interesit është një pjesë integrale e procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS). Në përputhje me këtë, TAP ka përgatitur një Strategji të Përfshirjes së Grupeve të Interesit, qëllimi i përgjithshëm i së cilës është që të sigurojë një qasje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe të përshtatshme nga pikëpamja kulturore vendase gjatë procesit të konsultimit dhe prezantimit të projektit. Qasja e ndërmarrë nga TAP është në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në lidhje me VNM, Kërkesat e Performancës së BERZH si dhe politikat përkatëse të IFC dhe Bankës Botërore. TAP synon të ndërmarrë një proces angazhimi të grupeve të interesit nëpërmjet planifikimit të projektit, ndërtimit, funksionimit dhe nxjerrjes së tij nga përdorimi. Plani për këtë angazhim, duke përfshirë identifikimin e grupeve të interesit (d.m.th personave dhe organizatave që luajnë një rol në këtë projekt, ose mund të ndikohen nga projekti apo që janë të interesuara në projekt) dhe paraqitje a informacionit, konsultimet dhe trajtimi i sugjerimeve, komenteve dhe shqetësimeve janë dokumentuar në Planin për Përfshirjen e Grupeve të Interesit për Shqipërinë, i cili do të prezantohet në faqen

e internetit të Projektit. Ky plan do të rifreskohet sipas nevojave, ndërsa projekti përparon.

Axhenda e Projektit për VNMS dhe Konsultimet me Grupet e Interesit është raportuar në *Tabelën 1.1* më poshtë.

**Tabela 1.1 Axhenda e Projektit për VNMS dhe Konsultimet me Grupet e Interesit**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati</b>	
	<b>Fillimi</b>	<b>Mbarimi</b>
Dokumenti Para-Studimor “Scoping”	Nëntor 2010	Mars 2011
Paraqitja e Dokumenti Para-Studimor “Scoping” tek Grupet e Interesit	Fundi i Marsit 2011	Prill 2011
Angazhimi në Vëzhgim i Grupeve të Interesit (duke përfshirë edhe Anketat Familjare)	Prill 2011	Gusht 2011
Studime të Specialistëve në Terren	Prill 2011	Mesi i Qershorit 2011
Hartimi i Raportit të VNMS	Maj 2011	Shtator 2011
Paraqitja e Draftit Final të VNMS tek Autoritetet		Shtator 2011
Konsultimet dhe Paraqitja Publike e Draftit të VNMS	Shtator 2011	Nëntor 2011
Shqyrtimi nga Autoritetet i Draftit të VNMS	Shtator 2011	Qershor 2012
Finalizimi Përfundimtar i VNMS	Qershor 2012	Gusht 2012

Një nga objektivat e rëndësishme të procesit të prezantimit të “Scoping” të VNMS është që t’u krijojë mundësi grupeve të interesit të japin opinionet e tyre në lidhje me Projektin. Në këtë kuadër, TAP ka parashikuar një proces që u krijon grupeve të interesit mundësinë për t’i dërguar komentet dhe sugjerimet e tyre me shkrim tek TAP, pasi të jenë zhvilluar takimet për procesin e “scoping”.

Kështu, TAP do të donte të ftonte të gjitha grupet e interesit të përfshira në procesin “scoping”, duke përfshirë komunitetet vendore dhe publikun e gjerë, që të paraqesin me shkrim komentet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me seksionin shqiptar të Tubacionit Tran Adriatik (TAP) deri në 30 Qershor 2011.

Shtojca B paraqet një formular standard për të lehtësuar paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve si në anglisht ashtu dhe në shqip. Pjesëmarrësit në takimet “scoping” si dhe publiku i gjerë që është i interesuar për projektin, janë të ftuar të dërgojnë formularët e komenteve nëpërmjet postës elektronike ose në adresën e mëposhtme:

Trans Adriatic Pipeline AG – Albania (Dega e Shqipërisë)

Torre Drin, Rruga Abdi Toptani

Tel: + 355 44 308 770

Faks: + 355 42 265 685

Tirana, Shqipëri

[www.trans-adriatic-pipeline.com](http://www.trans-adriatic-pipeline.com)

[esia-comments@tap-ag.com](mailto:esia-comments@tap-ag.com)

### 1.1 VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT

Gazsjellësi Trans Adriatik Pipeline (TAP) është një tubacion i propozuar brenda Korridorit Jugor, i cili sjell gaz nga burime të reja në zonën e Detit Kaspik drejt Evropës Perendimore dhe Juglindore.

Tubacioni prej 520 km do të lidhë rrjetet ekzistuese të gazit në Greqi, do të kalojë nëpër Shqipëri dhe Detin Adriatik dhe do të përfundojë në brigjet e Italisë Jugore, duke lejuar gazin që të rrjedhë drejtpërdrejt nga bazeni i Kaspikut drejt tregjeve evropiane.

Aksionerët e TAP janë kompania zvicerane EGL (42.5%), kompania norvegjeze (42.5%) dhe kompania gjermane E.ON Ruhrgas (15%).

TAP do të kontribuojë në sigurinë dhe diversifikimin e furnizimeve me gaz, duke ofruar infrastrukturën e nevojshme për transportin e gazit nga fusha e Shah Deniz II në Azerbajxhan, përmes rrugës së drejtpërdrejtë drejt Evropës Jugore, sapo të fillojë prodhimi i kësaj fushe në fillim të vitit 2017. Ndërsa furnizimi me gaz do të rritet, TAP do të ketë aftësinë të transportojë 10 mmk më shumë në vit, duke e rritur kapacitetin në 20 mmk, sipas nevojave.

TAP mbështetet financiarisht nga aksionerë të fortë/të qendrueshëm. Projekti nuk do të kërkojë fonde nga subvencione apo nga qeveritë e vendeve pritëse. TAP mund të sjellë përfitime të rëndësishme përsa u përket investimeve të mëdha dhe punësimit në vendet ku ai kalon. Bashkimi Evropian e njeh këtë projekt në kuadrin e udhëzimeve të ashtuquajturave TEN-E (Rrjetet e Energjisë Trans Evropiane) si një Projekt me Interes të Përbashkët për objektivat e përgjithshme të politikë energjitike të Bashkimit Evropian.


Si fillim, sistemi i tubacionit që do të kalojë nëpër Shqipëri do të përbëhet nga një tubacion në pjesën kontinentale prej rreth 200 km të gjatë, një tubacion detar prej rreth 60 km të gjatë dhe një stacion kompresori afër Fierit (të cilit i referohemi gjithashtu edhe si CS3) me një kapacitet prej 10 miliardë metra kub (MMK) gaz natyror në vit (rreth 1.520.000 metra kub në orë). Në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, përafërsisht në çdo 30 km të tubacionit në pjesën kontinentale do të instalohen stacione valvolash të bllokimit për të ndërprerë rrjedhjen e gazit në rast mirëmbajtjeje apo emergjence. Në një fazë më të vonët do të ndërtohet një stacion i dytë kompresori (CS2) afër Mirasit, në afërsi të kufirit me Greqinë, për të rritur kapacitetin e rrjedhjes në tubacion nga 10 në 20 MMK (nga 1.520.000 në 3.040.000 metra kub në orë).

*Figura 1.1* tregon trasenë e TAP në pjesën kontinentale në Shqipëri, ndërsa *Figura 1.2* tregon seksionin detar.

Figura 1.1 TAP në Shqipëri (pjesa kontinentale)



Figura 1.2 TAP në Shqipëri (pjesa detare)



Gjurma e rastit bazë të TAP në Shqipërisë (vija e kuqe në Figurat 1.1 dhe 1.2) është përzgjedhur në bazë të një procesi të gjerë dhe të plotë të vlerësimit të traseve alternative të kryer nga TAP në vitet 2009-2010, me qëllimin për të përzgjedhur një trase teknikisht të mundshme për tubacionin dhe e cila do të

ketë ndikimin më të ulët mjedisor, socio-ekonomik dhe kulturor (ju lutem shihni Seksionin 3 të raportit kryesor). Procesi i identifikimit të gjurmës ka përfunduar për pjesën më të madhe të gjurmës së rastit bazë, me përjashtim të një seksioni prej rreth 30 km ndërmjet kufirit Shqipëri-Greqi dhe Vithkuqit dhe pjesës më perëndimore të gjurmës midis Fierit dhe vijës bregdetare (shihni vijat e verdha në figurën 1.1). Në mënyrë të ngjashme, vendndodhja e saktë e stacionit të kompresorit (CS3) pranë bregdetit dhe alternativat e kalimit nga toka në det janë aktualisht ende nën shqyrtim (shihni Seksionin 3 për vendndodhjet e mundshme).

Ky raport paraqet rezultatet e Raportit “Scoping” të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) të kryer për projektin TAP. Procesi i plotë i VNMS miratuar nga TAP dhe detajet e raportit “scoping” janë të paraqitura në seksionet e mëposhtme.

Për qëllim të këtij raporti “scoping”, projekti përfshin gjurmën e rastit bazë, dy alternativat e gjurmës, alternativat e kalimit në det dhe vendodhjet e mundshme për CS3. Sapo të përfundojë përcaktimi i korridorit, VNMS e detajuar do të kryhet vetëm për variantet e përzgjedhura.

## 1.2 PROCESI I VNMS

### 1.2.1 Hyrja

Metoda e përgjithshme e TAP për VNMS do të jetë në përputhje me rregulloret shqiptare dhe do të kryhet në përputhje me Direktivën Evropiane të BE dhe kërkesat e standarteve ndërkombëtare të zbatueshme, të mishëruara në Kërkesat e Performancës (KP1-10) të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) (shihni *Seksionin 2.2*).

Hapi i parë i procesit VNMS të TAP kishte si qëllim të kryente një vlerësim të alternativave të mundshme të gjurmës përmes Shqipërisë. Vlerësimi i alternativave filloi në fillim të 2009 dhe përfundoi në 2010 me përzgjedhjen e një alternative të preferuar. Vlerësimi ishte bazuar në kritere teknike, mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore, me synimin për të identifikuar një alternativë teknikisht të mundshme e me ndikime sa më të ulta mjedisore, socio-ekonomike dhe në trashëgiminë kulturore. Sapo alternativa e preferuar u identifikua, u njoh dhe u miratua nga të gjitha grupet e interes në fund të 2010, TAP filloi procesin e “scoping” për të përcaktuar qëllimin e kërkuar nga VNMS. Ky raport paraqet gjetjet e kësaj veprimtarie.

Që nga fillimi i procesit të vlerësimit të alternativave, TAP ka punuar me palët e interesuara për të marrë mendimet e tyre, me synimin për t'i marrë ato parasysh gjatë hartimit dhe zbatimit të projektit. Ky proces vazhdoi përgjatë gjithë procesit të “scoping” (shihni *Seksionin 8*) dhe do të vazhdojë përgjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së Projektit.

*Figura 1.3* paraqet procesin VNMS grafikisht . Faza e “scoping” dhe aktivitetet e VNMS përshkruhen shkurtimisht në *Tabelën 1.1*.

Figura 1.3 Skematika e Procesit VNMS




Tabela 1.1 Përmbledhja e Procesit VNMS

Hapi	Përshkrimi
<b>Skanimi</b>	Në VNM shqiptar, skanimi është i nevojshëm për të përcaktuar nëse projekti kërkon një përmbledhje të VNM apo një VNM të detajuar (shihni <i>Seksionin 2.1</i> )
<b>“Scoping”</b>	“Scoping” identifikon çështjet kyçe për t’u trajtuar në VNMS. “Scoping” sikurse paraqitet këtu, do të sigurojë që procesi të përqendrohet në ndikimet e mundshme të rëndësishme mjedisore dhe sociale që mund të vijnv si rrjedhojë e projektit. Do të marrë parasysh rezultatet e konsultimeve të bëra deri më tani për projektin. Së fundi, “scoping” përcakton qëllimin e punës së VNMS, përfshirë këtu angazhimin e palëve të interesuara.
<b>Studimet bazë</b>	Për çështjet kyçe të identifikuara gjatë “scoping”, do të mblidhet informacioni i disponueshëm për kushtet ekzistuese mjedisore dhe sociale (të referuara gjithashtu si kushtet bazë). Ky process do të plotësohet nga studimet dhe vrojtimit në terren, aty ku është e nevojshme. Zhvillimi i ardhshëm i kushteve bazë në mungesë të projektit do të merret gjithashtu parasysh.

<i>Hapi</i>	<i>Përshkrimi</i>
<b>Vlerësimi i ndikimit dhe masat lehtësuese</b>	Kjo fazë përqendrohet në parashikimin e ndryshimeve sociale dhe mjedisore nga gjendja bazë, si rezultat i veprimtarive të projektit (duke marrë në konsideratë të gjithë ciklin e jetëgjatësisë së projektit). Më pas, secili ndikim do të vlerësohet për të përcaktuar rëndësinë e tij për mjedisin dhe shoqërinë. Ku është e nevojshme, do të propozohen masa për të lehtësuar ndikimet me rëndësi.
<b>Planet e menaxhimit mjedisor dhe social</b>	Masat e ndryshme të lehtësimit do të paraqiten në Planin e Menaxhimit Mjedor dhe Social (PMMS), që përshkruan se si masat do të zbatohen përgjatë fazave të ndryshme të projektit. PMMS do të japë në detaje burimet dhe përgjegjësitë për zbatimin, kohën dhe monitorimin dhe planet e auditimit për të siguruar që të gjitha angazhimet e lehtësimit janë përmbushur. Gjithashtu, do të identifikojë kërkesat për trajnim apo për rritjen e kapaciteteve. PMMS do të përfshijë një Plan për Rivendosjen dhe një Plan Veprimi të Risistemimit, të cilët do të detajojnë se si blerja e tokës dhe toka me të drejtë servituti do të menaxhohen në përputhje me politikën e TAP dhe praktikën e mira ndërkombëtare.
<b>Angazhimi i palëve të interesuara dhe Konsultimi</b>	Gjatë studimeve të VNMS, grupi studimor do të kërkojë mendimet e palëve të interesuara, me qëllim që këto të merren parasysh në vlerësim e të pasqyrohen në propozimet për masat lehtësuese. Sapo të përfundojë, Raporti i VNMS do t'i paraqitet publikut dhe do të jetë i hapur për konsultime. Komentet do të merren parasysh në rishikimin përfundimtar të Raportit të VNMS dhe PMMS.

### 1.2.2

#### *Qasja ndaj “Scoping”*

“Scoping” i këtij projekti është parashikuar si një proces komunikimi, prezantimi dhe konsultimi ku, zëdhënësi i projektit, konsulentët e tij dhe palët e interesuara shkëmbejnë informacionin për të arritur mirëkuptim reciprok dhe vendosjen e procesit të VNMS dhe hapave vijuese të përmbledhura si më lart.

Duhet theksuar se që në fazat e para të fillimit dhe hartimit të projektit, deri në fazën aktuale, janë realizuar tashmë disa aktivitete që përfshijnë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit me palët e interesuara, të cilat janë pjesë e procesit të lartpërmendur të “scoping”. Këto aktivitete detajohen më tej në seksionet e mëposhtme të këtij raporti dhe do të vazhdojnë gjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së projektit.

Ky Dokument i “Scoping” është pjesë e procesit formal të Raportit Paraprak dhe objektivi i tij është i dyfishtë:

- a) Shërben si dokumentacion bazë për procesin e “scoping”, për hartimin dhe përmbledhjen e informacionit përkatës e të disponueshëm për projektin në kohën e formalizimit të procesit. Afati kohor i “scoping” duhet të gjejë një ekuilibër ndërmjet gjetjes së informacionit të mjaftueshëm deri në masën që ky është i kuptueshëm, dhe zhvillimit sa më të shpejtë, me qëllim që të ndikojë në hartimin e projektit, nëse e është e nevojshme. Dokumenti do të shpërndahet tek palët e interesuara me qëllim që ata të japin komente të mirinformuara.
- b) Produkti kryesor i procesit të “scoping” do të jetë një Raport përfundimtar “Scoping”, i cili do t’i referohet dhe do të përfshijë të gjitha komentet e bëra nga grupet e konsultuara dhe do të përcaktojë qëllimin përfundimtar dhe përmbajtjen e plotë të vetë VNMS, duke marrë në konsideratë kontributin nga të gjitha palët e interesuara dhe kërkesat specifike të Autoriteteve Shqiptare.

### 1.3

#### *STRUKTURA E “SCOPING”*

Pjesa tjetër e këtij raporti ka strukturën e mëposhtme:

*Seksioni 2 –Rregulloret dhe Udhëzimet:* ofron një përshkrim të shkurtër të kuadrit përkatës rregullator shqiptar dhe ndërkombëtar të VNMS dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje me “scoping”;

*Seksioni 3 –Përshkrimi i Opsioneve të Përzgjedhura:* përmbledh vlerësimin e alternativave të gjurmës, kryer nga TAP me qëllim që të përzgjedhë gjurmën e ‘rastit bazë’;

*Seksioni 4 –Përshkrimi i Projektit:* përshkruan komponentët kryesorë të projektit dhe aktivitetet kryesore të ndërtimit, para-përdorimit, gjatë përdorimit dhe nxjerrjes nga përdorimi;

*Seksioni 5 –Kushtet Bazë:* ofron një përmbledhje të karakteristikave bazë mjedisore, socioekonomike dhe të trashëgimisë kulturore të Zonës së Studimit;

*Seksioni 6 –Ndikimet e Mundshme dhe Masat Lehtësuese:* përmbledh ndikimet e mundshme e të rëndësishme mjedisore, socioekonomike dhe të trashëgimisë kulturore dhe ofron një tregues të masave të mundshme të lehtësimit dhe menaxhimit;

*Seksioni 7 –Termet e Referencës të VNMS:* paraqet termat e propozuara të referencës, strukturën e detajuar të VNMS dhe një axhendë të përkohshme të aktiviteteve të VNMS;

*Seksioni 8 –Angazhimi i Palëve të Interesuara* paraqet propozimet për konsultim me palët e jashtme të interesuara e të identifikuara, përfshirë edhe komunitetet e prekura, që mund të jenë të interesuara në projekt gjatë “scoping”. Seksioni gjithashtu përmbledh aktivitetet e konsultimit të ndërmarra më parë në procesin e VNMS.

- Shtojca A-Hartat:* Harta 1 paraqet karakteristikat kryesore teknike, ato mjedisore, socioekonomike dhe të trashëgimisë kulturore të gjurmës së rastit bazë në pjesën kontinentale. Harta 2 paraqet gjurmët në det dhe Harta 3 paraqet të gjitha alternativat e gjurmës në tokë.
- Shtojca B-* Formulari i komenteve – formulari për t’u përdorur për dhënien e komenteve dhe opinioneve në lidhje me “scoping”.
- Shtojca C* –Lista e palëve të interesuara
- Shtojca D-* Plani i Veprimit të VNMS– paraqet listën e studimeve (bazë dhe të modelimit) për t’u kryer gjatë VNMS dhe kohën e aktiviteteve.
- Shtojca E-* Referencat

### 2.1 KUADRI LIGJOR SHQIPTAR PËR VNM

Kuadri ligjor për procedurën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM)<sup>12</sup> në Shqipëri bazohet në *Ligjin Nr. 8990 për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor*, miratuar më 23 Janar 2003. Kuadri i plotë ligjor është dhënë në *Tabelën 2.1*.

Procedura për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Shqipëri mund të përmblihet në tre fazat e mëposhtme:

- Skanimi: aplikuesi duhet t’u japë Agjencive Rajonale Mjedisore (ARM) një përshkrim paraprak të projektit, me qëllim që të përcaktohet nëse projekti kërkon një përmbledhje të VNM apo një VNM të detajuar;
- Faza e Konsultimeve Vendore: me synimin për të marrë një deklaratë zyrtare “asnjë kundërshtim” nga qeveria vendore (Bashkitë dhe Komunat). Ky proces përfshin hapat e mëposhtëm:
  - Zëdhënësi i projektit u dërgon qeverive vendore një përmbledhje jo teknike të VNM dhe autorizimin paraprak të METE
  - Komuna/Bashkia organizon një takim Konsultimi Publik
  - Këshilli i Komunës/ Bashkisë shpreh mendimin e tij për projektin.
- Miratimi nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU):
  - Kërkesa për lejen VNM dorëzohet tek Qendra Kombëtare për Licensim, e cila i përcjell dokumentat tek Drejtoria e Lejeve Mjedisore dhe Licensimit në MMPAU.
  - MMPAU i përcjell dokumentat tek ARM, këto të fundit vlerësojnë dokumentat, kryejnë vrotime në terren dhe përgatisin mendimin e tyre për projektin, përfshirë këtu dhe kërkesat e posaçme për lejen
  - Duke marrë në konsideratë mendimin e ARM, MMPAU lëshon lejen dhe ia dërgon QKL, e cila më pas ia dërgon aplikuesit.

<sup>1</sup> Legjislacioni Shqiptar i referohet VNM dhe jo VNMS. Nëse i referohemi procedurave shqiptare do të përdoret akronimi VNM. Nëse i referohemi metodës më të gjerë të TAP, do të përdoret akronimi VNMS.

**Tabela 2.1** *Kuadri Ligjor Shqiptar për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor*

<i>Referimi</i>	<i>Viti</i>
Ligji nr. 8990, i datës 23.1.2003 "Për vlerësimin e ndikimit mjedisor" ndryshuar me Ligjin nr.10050, i datës 24.12.2008;	2003
VKM nr. 249 i datës 24.4.2003 "Për miratimin e dokumentacionit për lejen mjedisore dhe elementët e lejes mjedisore";	2003
Urdhër nr. 6, i datës 27.12.2006, "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin paraprak të ndikimit mjedisor të një aktiviteti";	2006
VKM nr. 538, i datës 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet të trajtuara nga / ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit";	2009
Urdhër i Ministrisë nr. 429, i datës 17.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për lejen mjedisore";	2009
Udhëzim i Ministrisë nr.1, i datës 03.03.2009 "Për detyrimet e subjekteve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe OJQ mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit mjedisor";	2009
Udhëzim i Ministrisë nr. 2, i datës 29.6.2010 "Për dokumentacionin e nevojshëm për të kërkuar një leje mjedisore".	2010

## 2.2

### ***KËRKESAT E PERFORMANCËS SË BERZH PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL***

TAP ka miratuar Kërkesat e Performancës të BERZH (KP), si standarti ndërkombëtar i referencës, për strategjitë e tij sociale dhe mjedisore.

Projekti TAP duhet të klasifikohet në Kategorinë A sipas kriterëve të BERZH, dhe si i tillë kërkon një proces tëposaçëm zyrtar pjesëmarrjeje vlerësimi sipas Standarteve të BERZH. Procesi duhet të përfshijë:

- Një Vlerësim gjithëpërfshirës të Ndikimit Mjedisor dhe Social në përputhje me KP 1 Menaxhimi i Vlerësimit Mjedisor dhe Social dhe KP 10 Dhënia e Informacionit dhe Angazhimi i Palëve të Interesuara.<sup>1</sup>
- Një shqyrtim i alternativave të mundshme teknike dhe financiare dhe arsyeja për përzgjedhjen e alternativës.
- Gjithashtu duke iu referuar KP 2 dhe 4, VNMS duhet të identifikojë çështjet në lidhje me rreziqet e mundshme që ndikojnë mbi shëndetin, sigurinë dhe mbrojtjen e komunitetit, si dhe kushtet e punës.
- Një vlerësim i çështjeve të ri-sistemimit të pavullnetshëm sipas KP 5, Blerja e Tokës, Ri-sistemimi Ekonomik dhe Zhvendosja e Pavullnetshme.
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive natyrore dhe mbrojtja e biodiversitetit duhet të merren parasysh, siç udhëzohet në KP 6.
- Një vlerësim i ndikimeve në trashëgiminë kulturore në përputhje me KP 8. Trashëgimia Kulturore.

Gjithashtu KP e mëposhtme mund të përmenden në këtë fazë:

<sup>1</sup> Përkufizimi i BERZH për Grupet e Interesit: Persona ose organizata të cilat (i) ndikohet apo kanë gjasa të ndikohen (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi) nga projekti (palët e prekuar), ose (ii) janë të interesuar në projekt (palët e tjera të interesuara).

KP2 – Kushtet e Punëtorëve dhe Kushtet e Punës: Kjo KP zbatohet më shumë për çështjet organizative dhe operacionale, megjithatë, për aq kohë sa disa aspekte janë pjesë përbërëse e VNMS, ato do të trajtohen në të gjitha seksionet përkatëse të VNMS, dhe në veçanti tek PMMS.

KP3 – Parandalimi dhe Ulja e Ndotjes: Kjo KP ka përshkuar dhe përshkon projektimin inxhinierik të TAP, dhe për rrjedhojë, do të ushqejë të gjithë procesin e VNMS.

Në lidhje me kërkesat shqiptare për VNMS, zbatimi i standarteve të BERZH kërkon proceset e mëposhtme plotësuese:

- *“Scoping”*: një proces ku palët e interesuara janë konsultuar për të kontribuar në identifikimin e çështjeve kyçe për t’u shqyrtuar si pjesë e VNMS. Ky Dokument *“Scoping”* është përgatitur në zbatim të kësaj kërkesë.
- *Plani i Angazhimit të Palëve të Interesuara*: një metodë gjithëpërfshirëse komunikimi dhe konsultimi me palët e interesuara të identifikuara përgjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së projektit.
- *Përqendrimi tek Çështjet Sociale*: ndërsa legjislacioni shqiptar kryesisht i referohet ndikimeve në mjedis, metoda e BERZH gjithashtu përqendrohet në identifikimin e ndikimeve mbi komunitetet e prekura dhe më pas në përcaktimin e masave të nevojshme lehtësuese.

### 2.3

#### **KONVENTA/MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE NË LIDHJE ME VNMS**

Shqipëria ka ratifikuar të dy konventat ndërkombëtare të Aarhus dhe Espoo në lidhje me procesin e VNMS (shihni *Tabelën 2.2*). Përbushja e kërkesave të përcaktuara nga konventa e Aarhus për pjesëmarrjen publike do të mbulohet plotësisht nga TAP nëpërmjet pajtueshmërisë me legjislacionin shqiptar dhe standartet e BERZH.

Qasja për të qenë në pajtim me konventën Espoo do të përcaktohet nëpërmjet bashkëpunimit me tre Shtetet e përfshira (Shqipërinë, Greqinë dhe Italinë).

**Tabela 2.2**

#### ***Konventat Ndërkombëtare dhe Marrëveshjet e Nënshkruara/Ratifikuara nga Shqipëria në Lidhje me Procesin e VNMS***

<b><i>Emri i Konventës</i></b>	<b><i>Ratifikuar nga Shqipëria</i></b>
• Konventa Espoo (1991): Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar	12/05/2006
• Konventa e Aarhus (Konventa për të Drejtën e Publikut për Informacion (1998). Pjesëmarrje në Vendim-Marrje dhe të Drejtën për t’iu Drejtuar Gjykatës për Çështjet që lidhen me Mjedisin	27/06/2001

### 3.1 *HYRJA*

Gjurma e TAP në Shqipëri është përzgjedhur pas një procesi vlerësimi të gjerë dhe të detajuar të alternativave të gjurmës të kryer nga TAP, me qëllimin për të përzgjedhur një trase tubacioni teknikisht të mundshme me ndikimet më të ulta në mjedis, socio-ekonomi dhe në trashëgiminë kulturore. Si rezultat i procesit të vlerësimit, Alternativa 6 është përzgjedhur si korridor i preferuar (shihni *Seksionin 3.2*).

Me përzgjedhjen e gjurmës së preferuar (apo 'rastit bazë'), u fillua një proces i përcaktimit të korridorit për optimizimin e gjurmës, në veçanti nëpër ato seksione që paraqesin sfida më të mëdha teknike, mjedisore, socioekonomike dhe të trashëgimisë kulturore. Procesi i përcaktimit të korridorit për rastin bazë është përfunduar për pjesën më të madhe të gjurmës me përjashtim të një seksioni afërsisht 30 km të gjatë ndërmjet kufirit Shqipëri - Greqi dhe Vithkuqit dhe në seksionin më perëndimor të gjurmës ndërmjet Fierit dhe vijës bregdetare (shihni vijat e verdha në *Figurën 1.1*). Gjithashtu, vendodhja e saktë e stacionit të kompresorit CS3 dhe CS2 dhe alternativat e kalimit në det janë ende duke u shqyrtuar. Për momentin, ka 4 vende alternative të kalimit në det që janë ende duke u studiuar (Dalja në det A – D, shihni *Figurën 3.2*) dhe tre vendodhjet për CS3 (Variantet 3, 5 dhe 6 – shihni *Figurën 3.1*). Si rezultat i pranisë së vendndodhjeve ku janë hedhur mina të pashpërthyerë dhe për shkak të paqëndrueshmërisë së truallit, gjurma jugore e alternativave në det u zgjodh si gjurma e rastit bazë. Gjurma e rastit bazë në det për momentin kalon në det tek Dalja C, megjithëse, përcaktimi i gjurmës së kalimit në det po vazhdon ende dhe si i tillë seksioni pranë bregdetit mund të ketë një drejtim të ri të gjurmës, sapo të përzgjidhet dalja e preferuar në det.

### 3.2 *PJESA KONTINENTALE*

#### 3.2.1 *Të përgjithshme*

Studimi i Fizibilitetit të TAP u krye për herë të parë midis viteve 2003 dhe 2005 me objektivin për të identifikuar korridorin më të përshtatshëm nga Evropa jug-lindore deri në Itali. Rrugët e analizuara u vlerësuan brenda një korridori 2 km të gjerë (1 km në secilën anë të gjurmës). Pika e fillimit të TAP u identifikua në Selanik, në Greqi si pika më lindore brenda rajonit të Ballkanit. Dalja në det e gjurmës që kalon nëpër detin Adriatik, si fillim u parashikua të ishte në veri të qytetit të Vlorës.

Në bazë të konsultimeve fillestare me palët e interesuara gjatë Fazës së Projektimit Bazë (Korrik 2006-Prill 2007) dalja në det në bregdetin Adriatik shqiptar u zhvendos më në veri në rajonin e Hoxharës, në përfundim të qytetit të Fierit. Si rrjedhojë, korridori i gjurmës u degëzua nga korridori i parashikuar fillimisht pranë Kalivacit/Shkozë drejt veri-perëndimit duke ndjekur kryesisht lumin Vjosë (shihni *Shtojcën A – Harta 3*). Kjo fazë përfundoi

me konfirmimin e korridorit të gjurmës së vlerësuar më parë gjatë fazës së fizibilitetit. Kjo rrugë përshkon Parkun Kombëtar Bredhi i Hotovës -Dangëlli<sup>1</sup>.

Ndonëse e mundshme nga ana teknike, kjo gjurmë do të kalojë për 27 km përmes Parkut Kombëtar, 7 km përmes zonës së tij qendrore dhe do të kërkojë ndërtimin e rrugëve të tjera hyrëse për 25 km brenda Parkut Kombëtar.

Në përputhje me kushtet e përcaktuara nga qeveria shqiptare (KRRTRSH Vendimi 1, 14/8/2007) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, TAP e rishikoi përcaktimin e gjurmës në 2008, dhe gjatë 2009-2010 në përputhje me Ligjin Shqiptar për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (Nr. 8990, 23/1/2003)<sup>2</sup> kreu një Vlerësim të Alternativave. Gjetjet e studimit të vlerësimit të alternativave të kryer gjatë 2008 dhe 2010 janë raportuar në Vlerësimin e Alternativave Shqipëri dhe shtojcat e saj (*referenca 1, Shtojca E*). Objektivi i këtij procesi ishte i trefishtë:

- Identifikimi i gjurmës më të përshtatshme;
- Identifikimi i alternativave dhe masave për të shmangur dhe/ ose minimizuar ndikimin mjedisor, social dhe në trashëgiminë kulturore dhe
- Angazhimi me autoritetet kombëtare, rajonale e vendore si dhe me popullatën në tërësi.

Studimet nga zyra filluan të vlerësonin korridore alternative të gjurmës teknikisht të mundshme në Rajonin e Hotovës (shihni *Shtojcën A – Harta 3*). Qëllimi i studimeve ishte të identifikonte një rrugë alternative që do të shmangte Parkun Kombëtar dhe do të kishte ndikime më të pakta mjedisore, socio-ekonomike dhe në trashëgiminë kulturore. Faktorët kufizues në identifikimin e alternativave teknikisht të mundshme në Rajonin e Hotovës ishin paqendrueshmëritë e gjera gjeologjike (kryesisht rrëshqitjet e tokës) dhe kufizimet morfologjike (kreshta të vogla, lëndina të ngushta, male të larta).

Gjatë 2009, u identifikuan gjithsej 6 korridore alternative në Rajonin e Hotovës. Dy nga gjashtë alternativat (Alternativa 5 dhe 6) u projektuan që të anashkalonin Parkun Kombëtar deri në Veri. U identifikua një tjetër rrugë teknikisht e mundshme (Alternativa 3), e cila anashkalonte zonën qendrore të Parkut Kombëtar por përsëri kalonte përmes Zonave të Qëndrueshme/Përdorimit Tradicional të Parkut Kombëtar (shihni *Shtojcën A – Harta 3*).

Si rrjedhojë, u studiuan rrugët në lindje dhe perëndim të Rajonit të Hotovës për Alternativën 3 dhe 6, duke përfunduar vlerësimin për të gjithë pjesën kontinentale në Shqipëri. Alternativat u vlerësuan brenda një korridori prej 2 km (1 km në secilën anë të pjesës qendrore). Rezultati i studimit ndërdisiplinor të vlerësimit të alternativave në Shqipëri çoi në identifikimin e dy alternativave teknikisht të mundshme të gjurmës, për të cilat u

---

<sup>1</sup>Ky park njihet gjithashtu si Parku Kombëtar i Hotovës dhe Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës dhe shpesh përmendet në tekst si 'Parku Kombëtar'

<sup>2</sup>Neni 9 i Ligjit 8990/2003 kërkon të përfshijë në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis "Procedurat dhe arsyet e përzgjedhjes së vendit ku projekti do të zbatohet, përshkrimi i të paktën dy varianteve të tjera shtesë të vendndodhjes së projektit" si dhe "Planin e negociatave të mundshme me organet e qeverisë vendore, organizatat jo fitimprurëse publike dhe mjedisore gjatë fazave të planifikimit, rishikimit dhe zbatimit të projektit".

identifikuan aspektet kryesore mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore. Alternativat janë (*Shtojca A – Harta 3*):

- Alternativa 6 e gjurmës veriore;
- Alternativa 3 e gjurmës jugore.

Aspektet mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore dhe kufizimet në lidhje më vendet e logjistikës (kantieri, sheshi i kampimit, etj) dhe rrugët hyrëse të propozuara për Alternativën 3 dhe 6 gjithashtu u përfshinë në vlerësim. Informacioni u përfitua nga një dokument i vetëm i quajtur Studimi i Logjistikës Shqipëri (*Ref.2 – Shtojca E*).

### 3.2.2

#### *Metodologjia*

Kategorizimi bazë teknik, mjedisor, socio-ekonomik dhe i trashëgimisë kulturore dhe vlerësimi i alternativave u krye nëpërmjet një kombinimi të studimeve jo në terren dhe vrojttimeve në terren. Për secilën alternativë u shqyrtua një korridor i gjerë prej 2 km (1 km në secilën anë të gjurmës së propozuar).

Sapo u përcaktuan karakteristikat teknike, mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore për secilën Alternativë, 'treguesit e ndikimit' për secilën disiplinë u përdorën për të theksuar tiparet kyçe të mundshme të një projekti për një tubacion standart gazi dhe gjithashtu për specifikat e zonës së studimit (d.m.th mbi bazën e gjetjeve të studimit jo në terren dhe vrojttimeve në terren). Përdorimi i këtyre treguesve, në fund, lejoi krahasimin dhe identifikimin e ndryshimeve dhe ngjashmërive përkatëse midis Alternativave nën studim.

### 3.2.3

#### *Gjetjet e Vlerësimit të Alternativave*

Nga gjashtë Alternativat, katër të mëposhtmet u hodhën poshtë për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- Alternativa 1 nuk ishte e mundshme nga pikëpamja e ndërtimit pasi kalonte nëpër disa rrëshqitje toke aktive.
- Alternativa 2 ishte e pamundur për të shmangur ndikimet në zonën qendrore të Parkut Kombëtar, pasi ishte e nevojshme të ndërtohej pjesërisht përgjatë kufijve të zonës qendrore, ku ndërtimi dhe rrugët hyrëse do të shkaktonin ndryshime të pakthyeshme në peizazhin e mbrojtur e të ndjeshëm dhe në habitatet e pyllit.
- Alternativa 4 kishte si qëllim të shmangte zonën qendrore dhe të ulte në tërësi ndikimet në Parkun Kombëtar duke përdorur lidhjen më të drejtë midis zonës malore dhe luginës së Vjosës. Vlerësimi nxorri si konkluzion se kjo rrugë ishte teknikisht e pamundur pasi kalonte nëpër disa rrëshqitje toke aktive dhe ndiqte për 8 km shtratin e lumit Osum.
- Alternativa 5 kishte si objektiv të jepte një rrugë tërësisht jashtë Parkut Kombëtar, por vrojtimit në terren nxorri konkluzionin, se kjo rrugë nuk është e mundshme teknikisht për shkak të një numri rrëshqitjeje toke aktive dhe nevojës për të ndjekur lumin Osum në shtratin e tij për 8 km.


Si rrjedhojë, vetëm Alternativa 3 dhe 6 u konsideruan si alternativa të preferuara dhe iu nënshtruan një vlerësimi më të detajuar. Të dy alternativat u menduan teknikisht të realizueshme dhe hasin sfida të ngjashme përsa i përket ndikimeve të sigurisë, sociale dhe trashëgimisë kulturore. Alternativa 6 përballet me më pak sfida përsa i përket ndikimeve në mjedis dhe ndërhyrjeve në planifikimin zyrtar të zonave. Nga ana tjetër, ndërtimi i Alternativës 3 nuk do të ishte në pajtim me legjislacionin shqiptar dhe Evropian për shkak të ndikimeve të tij në Parkun Kombëtar të Hotovës pasi kalon përmes tij për 18 km.

Për shkak të rezultateve të vlerësimit të alternativave, TAP vendosi të përdorë Alternativën 6 si gjurmën bazë për procesin e planifikimit të mëtejshëm dhe miratimit në Shqipëri.

### 3.2.4 Stacionet e Kompresorit

Gjashtë vendndodhje alternative janë identifikuar për CS3. Nga këto gjashtë, tre pika ndodhen në kodrën e Ardenicës për të siguruar kapacitetin mbartës dhe qëndrueshmërinë e tokës (CS3 Varianti 1, 2 dhe 4). Për shkak të aspekteve teknike (punime në tokë të gjera dhe mungesa e hapësirës), mjedisore (zona me vlera të larta natyrore) dhe socio-ekonomike (kultura të përhershme) të tre këto vendndodhje u hodhën poshtë. Për momentin tre variante janë ende nën shqyrtim: CS3 Varianti 3, 5 dhe 6 (shihni *Figurën 3.1*).

**Figura 3.1** CS3 Vendndodhja Alternative



*Hyrja*

Për përzgjedhjen e gjurmës në det u përdor një proces rishqyrtimi , i cili mund të karakterizohet si një rishqyrtim i një apo më shumë korridoresh tubacioni të mundshëm. Procesi i përzgjedhjes, kryesisht, u krye nëpërmjet vlerësimit të kufizimeve, batimetrisë së zonës dhe mundësisë për të vendosur lidhjen më të shkurtër të mundshme midis pikave të fillimit dhe mbarimit (daljes në det).

Gjatë këtij procesi, secili korridor alternativ u rishqyrtua gjatë një sërë vlerësimesh edhe në terren ku kufizimet përgjatë gjurmëve u identifikuan dhe u vlerësuan, kundrejt vlerësimit të alternativave të projektimit të përshtatshëm dhe metodave të ndërtimit. Aspektet e mëposhtme janë marrë parasysh gjatë zgjedhjes së gjurmës në det:

- Zonat e Mbrojtura;
- Habitatet Detare me një vlerë të lartë ekologjike (p.sh. zona barishtore);
- Vendet arkeologjike;
- Zonat ushtarake;
- Zonat e peshkimit;
- Zonat e ankorimit;
- Gjeo-rreziqet (p.sh. rrëshqitjet nën-det);
- Kufizimet e daljes në det;
- Zonat turistike;
- Instalimet ekzistuese nën det (p.sh. platformat, tubacionet, puse nën-det, kablllo).

*Procesi i Përzgjedhjes së Gjurmës dhe Rezultatet*

Procesi i përzgjedhjes së gjurmës në det fillimisht çoi në identifikimin e tre korridoreve për lidhjen midis Shqipërisë dhe Italisë. Dërsa projekti përparonte, procesi i përzgjedhjes së gjurmës në tokë në Shqipëri ishte shtyja kryesore si për korridorin e daljes në det dhe gjurmën në det. Në fund, vendndodhja e gjurmës në tokë përcaktoi vendndodhjen e përafërt të daljes në det në Shqipëri dhe si rrjedhojë, korridorin në det, i treguar me të kuqe në figurën e mësipërme.

Hapi tjetër në procesin e përzgjedhjes së gjurmës ishte analizimi i kufizimeve për korridorin e përzgjedhur. Kufizimi kryesor për gjurmën në det ishin vendet ku kishte mina të pashpërthyera që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, të cilat janë hedhur në fund të detit p.sh. silure, mina detare, bomba, etj. (gjithashtu referuar si UXO) (*shihni Hartën 2 – Shtojca A*). Nga vlerësimi i kufizimeve bëhet e qartë se gjurma në det duhet të kalojë në veri ose jug të vendeve ku janë hedhur lëndët eksplozive.

Si rrjedhojë, disa alternativa dolën, si në veri ashtu dhe në jug të vendeve të hedhjes. Për shkak të dallimeve në qëndrueshmërinë e shpatit në anën shqiptare, duke pritur që kjo të jetë më e përshtatshme në gjurmën jugore, dhe për shkak të alternativave të vendndodhjes së daljes në det në Itali, gjurma veriore u zgjodh si korridori i preferuar nga TAP.

### 3.3.3


### *Kalimet në det*

Procesi i përzgjedhjes së gjurmës në Shqipëri u nxit nga fizibiliteti teknik si në seksionet kontinentale ashtu dhe ato detare si dhe nga pika më e shkurtër dhe më e cekët e kalimit në detin Adriatik midis Shqipërisë dhe Italisë. Sapo u identifikua zona përreth Fierit, u krye një përzgjedhje e shesheve të përshtatshme të kalimit në det, duke përdorur kritere shumë-disiplinore për të shmangur ndërhyrjet tek:

- Zonat e mbrojtura;
- Zonat me vlerë të lartë ekologjike (në tokë dhe në det);
- Vendet e njohura të trashëgimisë kulturore;
- Zonat me një potencial të lartë arkeologjik;
- Zonat ushtarake;
- Zonat turistike;
- Vendet e peshkimit;
- Zonat me sedimente të njohura të ndotura;
- Fshatrat/qytetet/vendbanimet.

Të gjitha alternativat e daljes në det të identifikuar dhe të vlerësuara janë paraqitur në *Figurën 3.2*.

*Figure 3.2 Alternativat e Kalimit në Det*



Vlerësimet duke përfshirë edhe ato në terren, përcaktuan që Alternativat F dhe E përfshihen brenda kufijve të zgjeruar të zonës së mbrojtur të Lagunës së Karavastasë (Sheshi Ramsar) dhe si të tilla u hodhën poshtë. Alternativat A, B

dhe C kalojnë në afërsi të kanalit të Hoxharë që karakterizohet nga ndotja e naftës nga venburimet e naftës përreth Fierit. Gjatë vërtetimeve në terren, shenja të dukshme ndotjeje u vunë re në plazhet afër kanalit. Për rrjedhojë, alternativat A, B, C dhe D janë ende nën shqyrtim.

#### 4.1 HYRJA

##### 4.1.1 Përshkrimi i Përgjithshëm

TAP në Shqipëri do të përbëhet nga një seksion kontinental prej 200 km nga kufiri Greqi/ Shqipëri deri në bregdetin Adriatik dhe një tubacion në det përafërsisht 60 km nga bregdeti deri në mes të detit Adriatik. Tubacioni në tokë do të ketë një diametër prej 48 inches (1.219 m), ndërsa diametri i tubacionit në det do të reduktohet deri në 42 inches (1.067 m).

Tubacioni do të përbëhet nga seksione tubash çeliku të salduara, të cilat do të variojnë nga 8 deri në 18 m gjatësi. Seksionet e tubave të çeliktë do të izoloohen nga brenda dhe jashtë. Izolimi i brendshëm do të bëhet me rrëshirë epoksine, e cila redukton fërkimin, ndërsa izolimi i jashtëm do të jetë prej polietileni me 3 shtresa për të mbrojtur tubacionin nga gërryerja. Disa nga seksionet e tubacionit do të izoloohen më tej me armaturë për të mbrojtur tubat nga dëmtimet e jashtme. I gjithë tubacioni do të mbrohet nga gërryerja nga një sistem mbrojtjeje katodik.

Seksioni në tokë i tubacionit do të jetë i mbuluar gjatë gjithë gjatësisë. Për arsye sigurie dhe në mënyrë që të minimizohen ndikimet në shfrytëzimin e tokës ekzistuese (p.sh. tokë bujqësore) tubacioni nën tokë do të mbulohet nga dheu me një trashësi minimale prej 1 m. Një thellësi më e madhe do të kërkohet kur kalohet nën infrastruktura ekzistuese (shihni *Seksionin 4.2.1*). Seksioni në det do të shtrihet në fund të detit me përjashtim të seksionit në ujëra të cekta (midis thellësisë 0 dhe 10 m) që do të futet në thellësi që tejkalojnë 2 m. Në pikat e daljes, thellësia e futjes në tokë pritet të jetë deri në 4 m.

Kapaciteti i transportimit të tubacionit mund të rritet nga një kapacitet prej 10 miliardë m<sup>3</sup>/vit deri në 20 miliardë m<sup>3</sup>/vit. Për fazën e 10 miliardë m<sup>3</sup> kërkohen vetëm dy Stacione Kompresori (CS1 në Greqi dhe CS3 në Shqipëri). Stacioni i tretë (CS2) do të shtohet për të rritur kapacitetin transportues nga 10 miliardë m<sup>3</sup> në 20 miliardë m<sup>3</sup>.

Tubacioni TAP do të projektohet për një jetëgjatësi teknike prej 50 vitesh. Jetëgjatësia e parashikuar për pajisjet dhe tubacionet e stacioneve është 20 vjet. Projekti do të sigurojë që sistemi i transportimit të gazit të përmbushë të gjitha kërkesat e sigurisë të Kodeve dhe Standarteve bazë Evropiane.

Seksioni në tokë i tubacionit do të ketë një trysni të projektuar prej 95 bar (bar mbi trysninë atmosferike) që do të jetë e mjaftueshme për kapacitetin bazë të TAP prej 10 miliardë m<sup>3</sup>/vit dhe për një zgjerim të mundshëm në të ardhmen të kapacitetit të sistemit të TAP deri në 20 miliardë m<sup>3</sup>/vit. Trysnia përfundimtare e projektit do të caktohet pas finalizimit të procesit të projektimit duke marrë parasysh të gjithë parametrat përkatës.

Stacionet e kompresorit dhe stacionet e valvolave të bllokimit do të projektohen sipas Kodeve Evropiane, përveç rastit kur një pajisje e veçantë është e projektuar sipas standarteve të tjera të caktuara në specifikimet

funkcionale përkatëse. Projektimi dhe ndërtimi i strukturave civile dhe ndërtesave do të jetë në përputhje me Kodet Kombëtare dhe Eurokodet, Standartet Evropiane dhe TR1827. Projektimi për mbrojtjen e strukturave nga zjarri do të jetë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Ndërtimit (KNN).

Detajet e projektit do të zhvillohen më tej dhe do të përcaktohen në hapat e ardhshëm të projektimit. *Seksionet 4.2 dhe 4.3* më poshtë ofrojnë informacion për metodat e ndërtimit, para-përdorimit, gjatë përdorimit dhe nxjerrjes nga përdorimi që do të pëdoren për seksionet kontinentale dhe detare të projektit.

#### **4.1.2 Siguria**

Një vlerësim paraprak i rrezikut të gjurmës së tubacionit në tokë u krye për të verifikuar sigurinë e tubacionit. Afërsisht 20% e gjurmës kalon në rajone të populluara. Vlerësimi paraprak përcaktoi që gjurma ishte e mundshme përse i përket sigurisë së tubacionit dhe popullsisë në afërsi të tij. Në seksione me popullsi më pak të dendur, u identifikua një mundësi për optimizimin e gjurmës për të reduktuar më tej afërsinë ndaj vendbanimeve. Më tej, seksionet më të populluara të identifikuar janë relativisht të shkurtra, duke bërë të mundur zbatimin efikas të lehtësimit të rrezikut teknik ku është i nevojshëm ose i kërkuar.

Për seksionin e tubacionit në det u krye një vlerësim i rrezikut për të konfirmuar funksionimin e sigurtë në përputhje me politikën e sigurisë të përcaktuar nga TAP. Vlerësimi i rrezikut u përqendrua në dëmtimet e tubacionit në det nga ndikimet e jashtme (ankorimet, gjeo-rreziqet, etj.) dhe në rrezikun e mundshëm ndaj palëve të treta (ndaj personave në bordin e anijeve që operojnë në afërsi të tubacionit).

## **4.2 PJESA KONTINENTALE**

### **4.2.1 Hyrja**

Projekti i TAP në pjesën kontinentale në Shqipëri përbëhet nga komponentët e mëposhtëm kryesorë:

- Përafërsisht 200 km tubacion në tokë;
- 6-7 Stacione të Valvolave të Bllokimit (në varësi të projektimit përfundimtar);
- 2 Stacione Kompresori CS2 dhe CS3;
- Një tunel prej 2.5 km të gjatë dhe me një diametër afërsisht 4 m;
- Lehtësira shoqëruese të kërkuara gjatë ndërtimit (rrugë hyrëse, sheshe kampimi dhe ndërtimi etj.).

### **4.2.2 Ndërtimi i Tubacionit**

Tubacioni në pjesën kontinentale do të montohet në një mënyrë tradicionale me një platformë lëvizëse përgjatë korridorit të tubacionit. Së pari, hiqet pjesa e sipërme e dheut dhe ruhet veçmas, dhe më pas hapet një kanal. Nyje të veçanta tubash me një gjatësi prej 8 deri në 18 m saldohen në vargun e tubacionit, i cili më pas futet në kanal. Dheu hidhet përsëri në kanal dhe

peizazhi natyror ri-kthehet në gjendjen e mëparshme, ndërsa platforma lëvizëse ecën përpara.

Në terren të sheshtë dhe të butë mesatarja e progresit të ndërtimit do të jetë deri në 600 m / në ditë, në rajonet kodrinore ose malore kjo mesatare do të jetë midis 300 dhe 450 m / në ditë, ndërsa në seksionet e vështira si në shpatet e pjerrëta dhe shkëmbinjtë progresi i ndërtimit mund të jetë i ngadaltë deri në 50 m/në ditë.


Një kabëll fibrash optike do të shtrihet përgjatë tubacionit brenda kanalit për komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave gjatë funksionimit. Teknika të specializuara do të përdoren për kalimin e rrugëve dhe hekurudhave. Kalimi i rrugëve kryesore/autostradave, hekurudhave dhe kanaleve të mëdha mund të kërkojë përdorimin e metodave që nuk kanë lidhje me kanalet (p.sh shpime horizontale). Nëse kryhet një instalim ku tubacioni nuk futet nën tokë ose në kanal, tubacioni duhet të instalohet të paktën 2-3 m poshtë infrastrukturës ekzistuese që do të kalohet.

Ndërtimi standart i tubacionit në tokë, i zbatueshëm përgjatë segmenteve të TAP, përbëhet nga elementët e mëposhtëm kryesorë:


- Brezi i punimeve kërkon një gjerësi afërsisht 40 m. Pjesa e sipërme e tokës pjellore (normalisht 0.3-0.5 m e trashë) do të hiqet me një gjerësi prej afërsisht 22-24 m. Ky dhë do të ruhet përkohësisht në fund të brezit të punimeve (shihni *Figurën 4.1*).
- Dheu i pjesës së “poshtme të tokës” jo pjellore që do të dalë nga gërmimet e kanalit të tubacionit do të ruhet në anën përballë brezit të punimeve. Dheu i sipërm pjellor duhet të ri-depozitohet mbi dheun jo pjellor për të siguruar rritjen e përshtatshme të kulturave bujqësore dhe bimësisë.
- Gjerësia e brezit të punimeve duhet të lejojë hapësirë për montimin e tubacionit (lidhja e tubave dhe saldimi, izolimi dhe testimi me cilësi i seksionit të tubacionit të montuar, futja në kanal), si dhe për lëvizjen e mjeteve në të njëjtën kohë. Të dy proceset e punës duhet të kryhen në mënyrë të sigurtë.

Në zonat ku ka kufizime ndërtimi (p.sh kufizime mjedisore apo shfrytëzimi të tokës) dhe në përgjithësi aty ku nuk ka shumë hapësirë, brezi i punimeve mund të reduktohet nga 40 m në 30 m (shihni *Figurën 4.2*).

**Figura 4.1 Brezi Normal i Punimeve**



**Figura 4.2 Brezi i Reduktuar i Punimeve**



Kufizimet kryesore për përdorimin e tokës mbi tubacion do të prekin një korridor të ngushtë, maksimalisht 10 m të gjerë, në të cilin do të kufizohet rritja e pemëve me rrënjë të thella, një korridor maksimalisht 60 m, në të cilin ndërtimi i shtëpive do të kufizohet dhe një korridor prej maksimum 200 m, në të cilin krijimi i lagjeve të shtëpive dhe/ose i infrastrukturës industriale do të jetë i kufizuar. Gjurma e preferuar u përzgjedh duke marrë në konsideratë këto kritere dhe ajo krijon gjithashtu hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e ardhshëm të komuniteteve përreth.

Tubacioni kalon nëpër 1 autostradë, 7 rrugë kryesore, 30 rrugë dytësore, 228 rrugë transportuese dhe shtigje si dhe 1 hekurudhë. Për më tepër, kërkon 26 kalime lumi, përfshirë këtu 14 lumenj kryesorë. Aty ku është e nevojshme, do të përdoren metoda ndërtimi që shmangin ndërhyrjet apo ndikimet afatgjata të dukshme, me qëllim që të minimizohen ndikimet në trafik dhe në mjedis.

### *Stacionet e Valvolave të Bllokimit*

Tubacioni do të ketë 6 stacione të valvolave të bllokimit për të rritur sigurinë e tubacionit. Me anë të këtyre valvolave operatori mund të izolojë çdo segment të linjës në rast punimesh të mirëmbajtjes apo të izolojë një shpërthim ose rrjedhjeje. Valvolat e bllokimit nuk do të operohen nga personel dhe do të ndodhen në një ndërtesë të vogël të rrethuar me gardh për të shmangur ndërhyrjet. Ato do të zenë një sipërfaqe përafërsisht 20x30m. Në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare, këto stacione do të instalohen rregullisht për çdo 30 km të tubacionit dhe pajisja kryesore e këtij stacioni do të instalohet në tokë.

### *Stacionet e Kompresorit CS2 & CS3*

Stacionet e kompresorit duhet të transportojnë gazin duke rritur presionin. Në rastin specifik të stacionit të kompresorit afër Fierit, reduktimi i diametrit për seksionin në det nga 48" në 42" (nga 1.219 m në 1.067 m) kërkon një rritje shtesë të presionit.

Një stacion karakteristik i kompresorit përbëhet nga: 1 – Instrumentat matës për Inspektimin e tubave; 2 – Filtërat; 3 – Djegësit me gaz; 4 – Ndërtesa e Turbinës-Kompresorit; 5 – Ftohësit e gazit; 6 – Ndërtesa e Kontrollit dhe 7 – Ndërtesa e Mirëmbajtjes dhe Magazina (shihni *Figurën 4.3*).

**Figura 4.3** *Stacioni i Kompresorit – Planimetria tipike*



### CS3

Stacioni i kompresorit do të përbëhet kryesisht nga pajisje për trajtimin e gazit (filtërat veçues), matësi, kompresori dhe ftohësi. Sipërfaqja e terrenit të nevojshëm për stacionin e kompresorit është vlerësuar të jetë rreth 100 ha. Sipërfaqja e nevojshme për ndërtimin e stacionit të kompresorit është përafërsisht 2 ha. Pjesa tjetër e mbetur e sipërfaqes do të mbetet bosh, duke qenë se stacioni i kompresorit do të jetë i pozicionuar brenda kësaj sipërfaqeje, për të siguruar largësi të mjaftueshme nga ndërtesat e tjera apo nga infrastruktura përreth.

Filtërat veçues do të përdoren për të pastruar gazin nga depozitat që mund të mblidhen në pjesën e sipërme të tubacionit gjatë funksionimit të matësit. Pas pastrimit dhe matjes, gazi do të kompresohet në presionin e duhur. Për rritjen e presionit, është planifikuar instalimi i kompresorëve turbo me turbinë me lëndë djegëse. Për rastin e transportit të 10 Miliardë m<sup>3</sup>/në vit gaz do të përdoren turbina gazi të tipit 15 MW. Në rastin e rritjes së transportit deri në 20 Miliardë m<sup>3</sup> / në vit, do të shtohen kompresorë me turbina gazi të tipit 25 MW. Lënda djegëse për turbinat me gaz është gazi natyror i marrë nga tubacioni. Gazi i çliruar nga secila turbinë gazi do të shkarkohet në atmosferë nëpërmjet një gypi shkarkues për çdo turbinë gazi me një lartësi prej 40 m. Është parashikuar gjithashtu dhe një gyp ventilimi rreth 70 m i lartë. Pas ngjeshjes, gazi do të ftohet deri në 50°C nëpërmjet ftohësve të këmbimit të nxehtësisë. Filtërat veçues, matësi dhe një ftohës gazi do të instalohen si pajisje më vehte, ndërsa kompresorët dhe turbinat e gazit do të instalohen brenda ndërtesave. Për momentin parashikohet ngritja e ndërtesave me nga dy kompresorë brenda. Në të ardhmen do të nevojiten ndërtesa të tjera, si për shembull ndërtesa për kontrollin elektrik, për riparimet dhe ato të administrimit.

Konsumi i energjisë së stacionit të kompresorit është afërsisht 2,000 kw me voltazh të mesëm. Lidhja me burimin e energjisë për stacionin e kompresorit do të bëhet brenda hapësirës së përzgjedhur të stacionit. Pavarësisht nga kjo, çdo stacion do të pajiset me një gjenerator për të siguruar energjinë në rast të humbjes së energjisë nga burimi i jashtëm. Për momentin është duke u shqyrtuar instalimi i kompresorëve turbo me një turbinë të kombinuar me gaz dhe avull. Në këtë rast nxehtësia e çliruar nga kompresorët me turbinë me gaz do të përdoret për prodhimin e avullit. Më pas ky avull do të përdoret për funksionimin e një ose më shumë turbinave të lidhura me një kompresor turbo për ngjeshjen e gazit. Sipas kësaj alternative, kompresorët e turbinës me gaz do të pajisen me një ngrohës për rigjenerimin e nxehtësisë. Më tej do të jetë i nevojshëm një impiant për trajtimin e ujit dhe një ftohës për rigjenerimin e avullit.

## CS2

Stacioni i kompresorit do të përbëhet kryesisht nga pajisjet për trajtimin e gazit (filtërat veçues) dhe matësit. Gjithsesi, sipërfaqja e tokës duhet të bëjë të mundur instalimin e pajisjeve të ftohjes dhe kompresimit, të cilat duhet të transportojnë 20 MMK / gaz në vit. Sikurse dhe në rastin e CS3 hapësira e tokës së nevojshme për stacionin e matësit/kompresorit përlllogaritet përafërsisht tek 100 ha. Sipërfaqja e nevojshme për ndërtimin e stacionit të kompresorit është përafërsisht 2 ha. Pjesa tjetër e mbetur e sipërfaqes do të mbetet bosh.

Për 10 Miliardë m<sup>3</sup>/ në vit, nuk kërkohet asnjë njësi kompresioni brenda kësaj vendndodhjeje. Në rastin e rritjes në 20 Miliardë m<sup>3</sup>/ në vit, do të shtohen kompresorë me turbina gazi të tipit 25 MW. Për këtë rritje, detajet e lëndës djegëse, tubat shkarkues, këmbyesit e nxehtësisë, filtërat, ndërtesat etj., do të jenë të njëjta sikurse ato të përmendura më sipër për CS3.


## *Tuneli*

Një tunel i gjatë prej 2.5 km do të kalojë në pikën më të lartë të gjurmës për të shmangur shtrirjen e tubave në shpatet anësore horizontale (shihni

Figurën 4.4). Tuneli ka një diametër prej rreth 4 m dhe është i aksesueshëm vetëm për inspektim e mirëmbajtje. Për shkak të vendndodhjes së tij të largët, tuneli do të ndërtohet me metodën tradicionale të shpimit dhe shpërthimit dhe pritet që puna të ecë me rreth 6 m/ në ditë, çka kërkon një kohë të përgjithshme ndërtimi prej 24 muajsh, përfshirë ndërtimin e rrugëve hyrëse dhe ri-ndërtimin e zonave të përdorura përkohësisht si, sheshet e kampit dhe zonat e grumbullimit të mbeturinave. Si rezultat i kohës së nevojshme, ndërtimi i tunelit duhet të fillojë një vit përpara punimeve në tubacion.

Për një tunel me gjatësi 2.5 km do të gërmohet një sasi e përgjithshme prej afërsisht 31.000 m<sup>3</sup> material shkëmbor. Materiali i gërmuar nuk mund të riciklohet dhe do të hidhet në vende të përshtatshme sa më afër pikave të hyrjes për të shmangur transportimet në distanca të largëta.

**Figura 4.4** Tuneli



Futja në tunel do të bëhet nga lindja nëpërmjet rrugëve ekzistuese duke kaluar përmes fshatrave të Vithkuqit dhe Shtyllës. Këto rrugë të përdorura aktualisht për transport publik dhe të druve të prerë do të përmirësohen dhe rreth 7 km rrugë të reja duhet të ndërtohen në kreshtat e sheshta afër Styllës për të arritur hyrjen lindore të tunelit. Në përfundim, rrugët midis Çorovodës dhe Potomit do të përmirësohen dhe do të ndërtohen rreth 7 km rrugë të reja për t'u afruar në hyrjen perëndimore të tunelit. Kjo rrugë do të ndjekë kreshtat dhe do të përdoret gjithashtu si korridor ndërtimi për tubacionin. Një rrugë shtesë prej 3 km do të lidhë dy hyrjet dhe mund të përdoret pas përfundimit të ndërtimit për të lidhur Çorovodën me Korçën.

#### *Ambientet/Lehtësirat Shoqëruese*

Për magazinim dhe lëvizjen/transportimin gjatë ndërtimit, TAP do të ketë nevojë për 7 sheshe të përkohshme magazinimi për tubat, 5 zona magazinimi për pajisjet (kamionë, etj.) dhe 5 sheshe kampimi për punëtorët (shihni *Shtojcën A – Harta 1*). Përzgjedhja e vendndodhjes së lehtësirave shoqëruese u krye në bazë të hyrjes tek sheshet e ndërtimit dhe DGJ. Me qëllim që të minimizohen ndërhyrjet, u krye një vlerësim jo në terren i ndikimeve mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore, të rrugëve dhe shesheve.

Përmasat e shesheve të tubacioneve do të variojnë nga 15.000 m<sup>2</sup> - 24.000 m<sup>2</sup> me kapacitete që variojnë midis 1.260 dhe 2.772 tuba. Tubat me një diametër 48" do të sistemohen në tre shtresa sipër njëra-tjetrës, tubat me armaturë

betoni (p.sh për kalimin e lumenjve) do të sistemohen maksimalisht në dy shtresa.

Kampet e punëtorëve do të variojnë nga 20.000 m<sup>2</sup> (200 x 100 m) në 50.000 m<sup>2</sup> (200 x 250 m) ku do të sistemohen midis 80 dhe 200 punëtorë. Sheshet e tubave dhe kampet e punëtorëve priten që të funksionojnë përafërsisht për 1 vit përgjatë fazës së ndërtimit.

Pika kryesore e hyrjes së tubave dhe të atyre pajisjeve që nuk mund të blihen në Shqipëri do të jetë porti i Durrësit. Sheshi kryesor i tubave do të gjendet rreth 15-20 km në jug të këtij qyteti për të shmangur ndikimet në turizëm dhe popullsinë urbane. Me qëllim që të transportohen 15.000 tuba në vendin e duhur, TAP do të përmirësojë 90 km rrugë të gjurmës ekzistuese, do të ndërtojë rreth 40 km rrugë të reja dhe rehabilitojë të gjitha rrugët dhe tokën në gjendjen e tyre të mëparshme të para projektit.

#### 4.2.3

##### *Para-Përdorimit*

Sapo të instalohet tubacioni, do të duhet të ndërmerren një sërë aktivitete për t'u siguruar që tubacioni do të përmbushë kërkesat e funksionimit. Objektivi kryesor i këtyre aktiviteteve është të verifikojë që linja është shtruar pa defekte të rëndësishme dhe që është në gjendjen e përshtatshme për t'u mbushur dhe për të qenë nën tryshinë e gazit të transportuar. Pajisja e para-përdorimit do të përdoret për pastrimin, hidrotestimimin dhe për instrumentat matës për inspektim të tubacionit të instaluar. Pajisja do të vendoset kryesisht tek stacionet e kompresorit CS2 dhe CS3 dhe stacionet e valvolave të bllokimit.

Uji i nevojshëm për hidrotestimimin duhet të jetë ujë i freskët dhe i pastër, i cili do të merret (dhe shkarkohet) nga burimet ujore përgjatë gjurmës (lumenjtë, rezervuarët, liqenet). Një konceptim dhe vlerësim më i detajuar për aktivitetet e propozuara për hidrotestimimin dhe burimet ujore që do të përdoren, do të përcaktohet në detaje në VNMS mbi bazën e studimeve të detajuara. Gjatësia maksimale e një seksioni testimi do të kufizohet në 10 km horizontalisht; gjatësia e seksioneve vertikale do të varet nga projektimi përfundimtar i tubacionit. Seksione të veçanta, si kalimet nëpër lumenj kryesorë do të testohen në mënyrë individuale.

#### 4.2.4

##### *Funksionimi*

Do të krijohen procedura të detajuara të funksionimit të sistemit të tubacionit. Procedurat e funksionimit do të jenë këto të mëposhtmet:

- Një sistem administrimi që mbulon anën ligjore, kontrollin dhe sigurinë në punë;
- Procedura të emergjencës të qarta dhe efikase dhe udhëzime përdorimi;
- Trajnim i mjaftueshëm dhe i rregullt për të gjithë personelin e përfshirë në çështjet operacionale dhe ato të mirëmbajtjes;
- Një sistem gjithëpërfshirës për monitorim, dokumentimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të gjendjes së tubacionit dhe pajisjeve ndihmëse;
- Një sistem për të kontrolluar të gjitha zhvillimet apo punën afër tubacionit;
- Kontroll efikas dhe monitorim i gërryerjeve;

- Një sistem për të mbledhur dhe sistemuar informacionin në lidhje me aktivitetet e palëve të treta;
- Monitorim i ri-vendosjes dhe ndërmarrje e punimeve riparuese, aty ku është e nevojshme;

Tubacioni do të monitorohet dhe kontrollohet nga një dhomë qendrore kontrolli, në një vend që pritet të konfirmohet. Gjatë funksionimit, zbulimi i rrjedhjeve do të bëhet nga matja e vazhdueshme e presionit dhe shkallës së rrjedhës së gazit në hyrje dhe në dalje të tubacionit. Nëse zbulohet ndonjë rrjedhje, do të zbatohen procedurat e emergjencës të mbylljes. Do të instalohen instrumenta matës të inspektimit për të lejuar inspektimin e brendshëm. Sistemi i tubacionit është projektuar për të lejuar përdorimin e pajisjeve të kontrollit, nëse është e nevojshme.

#### **4.2.5** *Nxjerrja nga përdorimi*

Jetëgjatësia e pritur e shërbimit të tubacionit është 50 vjet. Nxjerrja nga përdorimi i tubacionit në pjesën kontinentale do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në atë kohë, së bashku me autoritetet përkatëse rregullatore. Kërkesat përfundimtare të nxjerrjes nga përdorimi do të merren parasysh gjatë fazës së projektimit duke siguruar që të gjitha alternativat e mundshme do të jenë të disponueshme. Tubacioni do të transportojë vetëm gaz të përpunuar dhe për këtë arsye hedhja e lëngjeve pastruese që do të përdoren nuk do të jetë një shqetësim.

### **4.3** *PJESA DETARE*

#### **4.3.1** *Hyrja*

Dalja në det është pika ku tubacioni kontinental lidhet me tubacionin detar. Për momentin, vendndodhja e preferuar e daljes në det në bregdetin shqiptar është afër qytetit të Fierit. Nga ajo pikë, gjurma është afërsisht 60 km e gjatë deri në pikën e mesit midis Shqipërisë dhe Italisë në detin Adriatik (shihni *Shtojcën A – Harta 2*).

Ky projekt parashikon një gjurmë pothuajse të drejtë, që kalon zonat më të pjerrëta të (detit Adriatik) në një drejtim pingul, duke shmangur zonat e mundshme të rrëshqitjes së shpatit detar nën det. Tubacioni lë territorin e Shqipërisë në mesin e ngushticës së Otrantos. Më pas, tubacioni do të vazhdojë drejt bregdetit të Italisë nga kjo pikë, por ky seksion do të trajtohet në dokumenta të tjerë. Në gjurmë do të kalojnë gjashtë kablllo në total, katër prej tyre në anën shqiptare. Një Kabëll Fibre Optike (KFO) do të shtrihet paralel me tubacionin në det për të siguruar komunikimin e nevojshëm të të dhënave midis stacioneve përkatëse të tubacionit në të dy anët e detit Adriatik.

#### **4.3.2** *Ndërtimi i Tubacionit*

##### *Seksioni në Det*

Tubacioni në det do të instalohet duke përdorur një platformë lundruese, që është një mjet lundrimi tipik për vendosjen e tubave. Seksionet e tubave

saldohen sëbashku në platformën lundruese dhe tubacioni shtrihet në fund të detit ndërsa platforma lundruese ecën përgjatë gjurmës. Do të jetë e nevojshme të përdoren masa të veçanta (d.m.th mbrojtja e elementëve ekzistues me një shtrojë betoni) kur kalohet në kablllo, brenda korridorit të vrojtuar. Për vendosjen e tubacionit do të punohet 24 orë në ditë, me qëllim që të sigurohet ndikimi minimal në lundrim për përdoruesit e tjerë dhe të shfrytëzohen me efikasitet kushtet e përshatshme të motit dhe koha e mjetit të lundrimit si dhe pasjisjet. Do të nxirren njoftime në përputhje me procedurat statutore për të siguruar lundrim dhe funksionim të sigurtë. Përveç, mjetit(eve) lundrues(e) të instalimit, do të përfshihen dhe mjete të tjera lundrimi furnizuese dhe të rojes bregdetare, për mbështetje shtesë, gjatë funksionimit.

Mund të jetë i mundshëm edhe përdorimi i dy platformave lundruese të ndryshme – një për seksionin e ujërave të cekta dhe një tjetër për ujërat më të thella. *Figura 4.5* tregon një platformë lundruese standarte të ujërave të cekta.


**Figura 4.5** Platformë Lundruese Standarte për Vendosjen e Tubave në Ujëra të Cekta



Shtrirja e tubave në det arrihet nëpërmjet vendosjes të njëpasnjëshme, saldimit dhe lëshimit të tubave nga mjetet lundruese të instalimit. Seksionet e tubave (normalisht 8 deri në 18 m të gjatë) transportohen drejt mjeteve lundruese të instalimit pasi janë izoluar më parë. Pas shtrirjes, seksionet bashkohen së bashku duke përdorur teknikat e saldimit automatik dhe lëshohen me tërheqës në fund të detit.

*Figura 4.6* paraqet një skicë skematike të një metode të zakonshme të shtrimin të tubave.

**Figura 4.6**      **Teknika Tipike e Shtrimit të Tubave**



Në ujërat e cekta, tubacioni do të futet nën tokë për të siguruar një qëndrueshmëri në fund dhe si një masë sigurie për të shmangur dëmtimet dhe ndërveprimin me infrastrukturën e palëve të treta (për shembull, pajimet e rrjetave të peshkimi dhe spirancat) dhe për të minimizuar rrezikun e tubacionit për “hapësira boshe” mbi hendeqet që mund të sjellin dobësim të tubacionit.

Tubacioni do të futet nën tokë në një thellësi përtej 2 m. Tek pika e kalimit në det, thellësia e futjes nën tokë pritet që të jetë deri në 4 m. Për momentin, pritet që tubacioni të futet nën fundin e detit për 2 km e parë në det, deri sa të arrijë një thellësi prej afërsisht 10 m nën nivelin e detit.


Në sedimentet e buta, ka dy mënyra për të futur nën sedimente një tubacion:

- Dragimi dhe rimbushja;
- Hapja e kanalit pas shtrimit.

#### Dragimi dhe Rimbushja

Hapja e kanalit pranë bregut do të bëhet nëpërmjet teknikave të dragimit. Më poshtë *Figura 4.7* paraqet pamjen nga njëra anë të veprimeve tipike gjatë dragimit, materiali i draguar thithet dhe ruhet në vetë mjetin lundrues, para se të hidhet në vendin e lejuar.

Figura 4.7 Skema e një Veprimi Dragimi me Thithje



Mjetet lundruese të dragimit nuk mund të përdoren në ujërat e cekta, kështu që në këtë rast përdoret një ekskavator. Ekskavatorët përdorin një kovë të fiksuar e të montuar në vinç dhe janë të projektuar për t'u përdorur në ujëra të cekta, në tokë ose pranë bregut. Materiali i draguar ngarkohet në një barkë/lundër të veçantë pranë ekskavatorit. Në përgjithësi, kanali i draguar do të rimbushet duke përdorur materialet e nxjerra më parë. Në ujërat e cekta, kanali mund të ketë edhe një shtresë betoni/ zhavorri për të stabilizuar tubacionin.

#### Hapja e kanalit pas shtrimit

Hapja e kanalit pas shtrimit arrihet duke e vënë tubacionin në fund të detit dhe duke hequr materialin poshtë tij, duke bërë të mundur zhytjen e tij në kanal (kjo metodë e dytë njihet si futja nën tokë pas shtrimit). Futja nën tokë pas shtrimit mund të arrihet duke përdorur lloje të ndryshme pajisjeje, përfshirë këtu sistemet reaktive (duke përdorur rryma uji me presion të madh) dhe plugjet.

#### *Qasja në Breg dhe Dalja në Det*

Dragimi përdoret gjithashtu në ndërtimin e kalimit në det. Zakonisht mënyra e ndërtimit është e bazuar në metodën e instalimit pa e futur nën tokë, për shkak të kufizimeve të mjedisit, sepse këtu përdoret një teknologji e provuar me rrezik minimal ndërtimi. Ndërtimet në sipërfaqe në pikat e kalimit në det zakonisht përfshijnë si më poshtë:

- Gërmimin e kanalit dhe ndërtimin e digës izoluese (diga izoluese është një rrethim brenda ujit, e ndërtuar për të lejuar ujin që të nxirret jashtë me pompë për të krijuar një mjedis të thatë pune);
- Lëshimin e tubit në kanal nëpërmjet vinçave të vendosur në tokë ose në det;
- Heqjen e digës izoluese dhe rivendosjen e dheut të gërmuar si dhe materialeve përforcuese për të kufizuar erozionin; dhe
- Rimbushjen me materiale si zhavorr dhe gurë shkëmborë me qëllim që të sigurohet një mbrojtje mekanike e përshtatshme e tubacionit për të arritur stabilitetin e tij në fundin e detit.

Diga izoluese do të mbrojë kanalën, duke penguar ri-mbushjen e kanalit me sedimente.

#### **4.3.3** *Para-Përdorimi (Hidrotestimi)*

Pajisja e para-përdorimit është planifikuar që të vendoset në pikën e daljes në det në Itali. Veprimi i parë do të jetë përmbytja, pastrimi dhe inspektimi i tubacionit në një veprim të vetëm inspektimi duke filluar nga Italia dhe duke përfunduar në Shqipëri.

Hidrotestimi do të bëhet menjëherë me pompa të vendosura në të njëjtin vend në Itali. Heqja e ujit nga tubacioni do të bëhet me anën e një pajisjeje lëvizëse brenda tubacionit nga Italia në Shqipëri. Shkarkimi i ujit të detit të papërpunuar (afërsisht 170.000 m<sup>3</sup>) të përdorur për testimin hidrostatik do të bëhet në Shqipëri. Tharja e tubacionit ka shumë mundësi të bëhet me ajër të thatë.

Qëllimi është që para-përdorimi i tubacionit të bëhet me një veprim të vazhdueshëm që mund të zgjasë nga 1.5 -2 muaj.

#### **4.3.4** *Funksionimi*

Tubacioni do të vihet në funksionim pas futjes së gazit nga Shqipëria, vetëm pasi të gjitha sistemet e kontrollit dhe monitorimit janë përdorur në të dy anët e tubacionit. Aktivitetet e përdorimit dhe nxjerrjes nga përdorimi janë të përmbledhura në *Seksionet 3.2.3-4*.

Gjendja e jashtme e tubacionit të zhytur nën-det, përfshirë këtu dhe gjendjen e sistemit katodik të mbrojtjes, do të monitorohen rregullisht. Për të lejuar inspektimin e brendshëm do të instalohen instrumenta matës për inspektim. Sistemi i tubacionit është projektuar për të lejuar përdorimin e pajisjeve të kontrollit, nëse është e nevojshme.

#### **4.3.5** *Nxjerrja nga Përdorimi*

Nxjerrja nga përdorimi e tubacionit në det do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në atë kohë, së bashku me autoritetet rregullatore përkatëse (shihni *Seksionin 4.2.5*). Efektet e mundshme në mjedis gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit të lidhura me paqëndrueshmërinë e fundit të detit janë të njëjta me ato të përshkruara për fazën e ndërtimit.

**5.1 PJESA KONTINENTALE****5.1.1 Hyrja**

Karakterizimi bazë mjedisor, socio-ekonomik dhe i trashëgimisë kulturore i prezantuar në seksionin e mëposhtëm është përqendruar në një korridor 2 km të gjerë (1 km në secilën anë të linjës qendrore të propozuar) përgjatë të gjithë gjatësisë së gjurmës kontinentale. Korridorit 2 km të gjerë i referohemi gjithashtu si zona e studimit.

Për të lehtësuar përshkrimin e karakteristikave bazë, gjurma është ndarë në seksionet e mëposhtme:

- Seksioni lindor: seksioni midis kufirit grek / shqiptar dhe në veri të qytetit të Mollasit;
- Seksioni qendror: seksioni midis qytetit të Mollasit dhe qytetit të Poliçanit;
- Seksioni perëndimor: seksioni midis qytetit të Poliçantit dhe bregdetit.

*Hartat 1 në Shtojcën A përfaqësojnë përdorimin e karakteristikave mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore të gjurmës kontinentale të rastit bazë.*

**5.1.2 Mjedisi***Kushtet Klimatike*

Shqipëria ka një variacion kushtesh klimatike, duke qenë se pozicionohet në zonën e tranzicionit midis klimës tipike mesdhetare në perëndim dhe të klimës kontinentale të moderuar në lindje. Temperatura mesatare vjetore është 15° C. Dimrat me shi (me ciklone të shpeshta) dhe verat e thata dhe të nxehta janë tipike për pjesën bregdetare. Temperaturat në brendësi ndikohen më shumë prej ndryshimeve në lartësi sesa prej gjerësisë ose prej ndonjë faktori tjetër. Temperaturat e ulëta në dimër në zonat malore shkaktohen prej masës ajrore kontinentale e cila mbizotëron motin në Evropën lindore dhe në Ballkan.

Reshjet vjetore janë prej 1000 mm në pjesën bregdetare, me sasinë më të madhe në veri, në më shumë se 2500 mm në male, në disa zona veriore. Thuhet 95 përqind e sasisë së shiut bie në dimër. Rënia e shiut është më e madhe në pjesën malore të brendshme. Pjesa jug-perëndimore e vendit vuan nga thatësira gjatë verës.

*Gjeografia*

Seksioni lindor ndahet nga Mali i Moravës i cili kalon përmes aksit veri-jug dhe ngrihet deri në më shumë se 1800 m në pjesën e tij më të lartë. Ka lugina të gjera të hapura të formuara prej ndikimit të tributareve të lumenjve Devoll dhe Osum nga të dyja anët e maleve, të cilat zbresin në rreth 900 m brenda

zonës së studimit. Këta dy lumenjkrijojnë pellgjet kryesore lumore ujembledhës brenda kësaj pjese të gjurmës. Lumi i Osumit rrjedh në drejtimin jugor dhe perëndimor ndërsa pellgu ujembledhës i lumit Devoll e grumbullon ujrën prej veriut dhe lindjes së zonës së studimit dhe lumi rrjedh në drejt veriut përpara se të drejtohet drejt perëndimit, për në bregdetin Adriatik në Shqipëri.

Seksioni qendror kalon përmes një zone të karakterizuar prej një relievi malor, terren të thepisur, me lartësi që fillojnë nga 200 m mbi nivelin e detit deri në më shumë se 2000 m. Lartësitë më të mëdha gjenden pranë malit të Ostrevicës (2383 m) dhe malit të Rungajës (1945 m).

Sekesioni perëndimor kalon përmes një game të relieveve të ndryshme gjeografike, duke filluar nga zonat malore në lindje, përmes kodrinave dhe ultësirës bregdetare në perëndim. Pikat më të larta arrijnë deri në 200 m dhe për të rënë më pas në nivelin e detit në vendin e kalimit nga toka në det. Ka dy sisteme lumore ujembledjesish kryesore, Lumi Seman-Osum (dhe tributaret e tij) dhe Lumi Vjosë. Të dy këto sisteme lumenjsh fillimisht kalojnë përmes kodrave të ulëta përgjatë luginave të ngushta të cilat zgjerohen gradualisht përpara se të hapen në ultësirën bregdetare.

### *Gjeologjia*

Gjurma kalon përmes një shumëllojshmërie të njësive shkëmbore bazë dhe mbivendosjeve të depozitimeve të buta shkëmbore. Shkurtimisht, këto njësi përfshijnë:

- Sekuenca bazë të mbizotëruara prej depozitimeve sedimentare.
- Sekuenca bazë të mbizotëruara nga ophiolites dhe karbonati, në seksionin lindor-qendror;
- Shkëmbinj të butë holocene, kryesisht në seksionin perëndimor deri në pjesën ku transeja e tubacionit kalon në det .

Ka 43 shkarje të njohura ose të presupozuara aktive përgjatë gjurmës, pjesa më e madhe në seksionet lindore dhe perëndimore.

Është e rëndësishme të përmendet se Mali i Ostrovicës, i cili është një masiv gëlqeror i thepisur dhe thyer, i përbërë prej mureve shkëmborë të thepisur mbi shpatet e përkulura më butësisht të depozitave sedimentare, dhe i cili përbën një pengesë të madhe morfologjike për shkak të pjesës së thepisur dhe të ngritjes së shpateve. Kjo pengesë do të kalohet përmes një tuneli (shikoni *Seksionin 4.4.2*). Pjesa perëndimore (rreth Fierit dhe pikës ku tubacioni futet në det) karakterizohet prej një lymishte d.m.th. depozitime deltike të lumenjve Seman dhe Vjosë. Kjo zonë është potencialisht e ekspozuar ndaj përmbytjeve, tërmeteve dhe zonave të lëngëzimit.

### *Bimësia dhe Flora*

Habitatet pyjore që gjenden në pjesën lindore të seksionit të gjurmës përfshijnë pyje ahu (*F. sylvatica*), pyje të dominuar prej drurëve gjethegjerë, kryesisht prej lisit (*Quercus sp.*) dhe pyje halorë të dominuar nga pisha (*Pinus nigra*), ose bredhi (*Abies alba*). Zonat me pyje/shkurre tranzitore dominohen kryesisht prej shkozës (*Carpinus orientalis*). Pritet që të ketë prani të pyjeve të

vjetër me vlerë të madhe, por ato janë kryesisht në sipërfaqe të vogla. Pjesa e sipërme e Ujëmbledhësit të lumit të Devollit konsiderohet e një rëndësie të veçantë.

Zonat që shfaqin interes të madh për bimësinë dhe florën gjenden në pjesën qendrore të gjurmës. Këto përfshinë drurë të ndryshëm gjethegjërë (*Quercus* sp.) ose pyje të vjetër pranë qytetit të Çorovodës, zona barishtore natyrale në pjesën sub-alpine, 1500 m mbi nivelin e detit me një numër të llojeve në mbrojtje, habitatin lumor të Osumit me grumbuj drurësh të vjetër dhe habitatin lumor pranë qytetit të Çorovodës të dominuar nga *Platanus orientalis* dhe *Salix alba*.

Zonat pyjore përgjatë seksionit perëndimor të gjurmës janë në faza të ndryshme të zhvillimit. Pjesa më e madhe e habitateve pyjore i përket shkurreve / pyjeve sklerofile përherë blerta të dominuar nga *Arbutus unedo*. Habitatet natyrore janë më të rralla brenda këtij seksioni për shkak të shfrytëzimeve më të mëdha (kryesisht bujqësor). Një rezervuar uji ndodhet brenda zonës buferike prej 1 km dhe habitatet lumore dhe ligatinat paraqesin interes të madh ekologjik. Përpara se të arrijë bregdetin, gjurma kalon përmes tokave të kripura bregdetare dhe habitatit lagunor. Gjurma kalon gjithashtu përmes një zone të vogël të fushës së naftës të Marinzës, pranë Jagodinës.

#### *Fauna*

Pyjet gjethegjërë dhe halorë të seksionit lindor janë habitate të rëndësishme për shumë gjitarë të mëdhenj dhe mishngrënës. Këtu përfshihen lloje si ariu i murrmë (*Ursus arctos*) dhe ujku (*Canis lupus*), por gjithashtu dhe një numër i madh shpendësh (qukapikët, gardalinat, trishtlilat, mëllënjat, boçethyesit, kacavjerrësit). Tokat barishtore sub-alpine në këtë zonë janë habitate të rëndësishme për një numër gjitarësh (urithët dhe minjtë) dhe shpendësh (thëllëzat, laureshat, cerlat, korbat dhe shpendët grabitqarë, përfshirë shqiponjat, skifterët dhe shkabat). I vetmi habitat ligatinor i identifikuar në këtë zonë është rezervuari i ujit të Gjançit, i cili paraqet një mundësi të mirë për praninë e lundërzës (*Lutra lutra*).

Në seksionin qendror të gjurmës konsiderohen si shumë të rëndësishëm dy lloje hapitatesh të faunës: pyjet e vjetër dhe ligatinat. Gjurma kalon përmes zonave me habitat të ndjeshëm ligatinorë përgjatë Lumit Osum, në veri të Çorovodës. Ky habitat është i përshtatshëm për llojet e lumenjve si p.sh. lundërza. Zonat e pa shqetësuara të ahishteve të vjetra dhe të pyjeve me lisë janë shumë të rëndësishme për gjitarët dhe për një gamë llojesh të veçanta pyjore. Areali i përhapjes së Ariut mbulon pjesën lindore të zonës së studimit deri në Çorovodë.

Në pjesën perëndimore, lagunat bregdetare dhe moçalet e kripura janë habitate të rëndësishme për shpendët e ujit, sidomos për shpendet dimerues që përbëhen prej baltakëve, rosave, zhytësit, çafkave, dallëndysheve të detit, pulëbardhave, kredharakëve, dhe shpendeve grabitqarë. Lagunat bregdetare, si dhe kanalet kullues, ofrojnë terren për ushqim dhe riprodhim për një numër peshqish dhe amfibësh. Zona të tjera të rëndësishme për faunën përgjatë gjurmës janë seksionet përgjatë lumit Osum midis Poliçanit dhe Beratit, të cilat mbështesin habitatet bregorë relativisht të ndjeshëm që janë të përshtatshëm për një gamë llojesh të peshqeve dhe në disa vende dhe për lundërzën.

Zonat e mbrojtura brenda zonës së studimit janë paraqitur në Hartën 1 në *Shtojcën A* dhe janë renditur më poshtë:

- *Parku Kombëtar Bredhi i Drenovës*: Parku Kombëtar Bredhi i Drenovës shtrihet përafërsisht 3 km në veri të korridorit të Alternativës 6 të gjurmës në zonën lindore të studimit. Ai u shpall për herë të parë Park Kombëtar në vitin 1966 (Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 96, datë 21/11/1966) (MMPAU6 2008). Zona e mbrojtur ka një sipërfaqe prej 1.380 ha dhe mbështet një gamë të gjerë të habitateve malore, duke përfshirë pyllin halor me pishe te zeze *Pinus nigra* dhe pyllin me frashër (*Fraxinus sp.*), përrrenjtë malore, livadhet dhe kullotat malore. Habitati brenda parkut kombëtar është i përshtatshëm për gjitarët e mëdhenj të tillë si, ujku dhe ariu.
- *Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës Dangëlli*: Parku ndodhet në pjesën qendrore të gjurmës, rreth 10 km në jug të saj. Parku u krijua në vitin 1996 për të mbrojtur pyllin e bredhave të Hotovës, një nga parqet e ruajtura më mirë dhe që ofron vazhdueshmërinë më mirë të pyjeve me bredh Maqedonie (*Abies borisii-regis*) në vend. Në vitin 2008 Parku Kombëtar i Hotovës u zgjerua në një sipërfaqe të përgjithshme prej 34.361 ha, dhe u quajt Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës Dangëlli. Ky vendim e ktheu Parkun Kombëtar të Hotovës në zonën më të madhe të mbrojtur në Shqipëri në ditët e sotme.
- *Parku Kombëtar i Lagunës së Karavastasë*: laguna ndodhet në pjesën perëndimore të gjurmës, rreth 3 km në veri të pikës së kalimin në det D. Kjo është laguna më e madhe në Shqipëri dhe një nga më të mëdhatë në detin Mesdhe. Parku Kombëtar i Karavastasë (Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta) shtrihet përtej lagunës drejtjugut deri në grykededhjen e lumin Seman dhe në lindje deri përafërsisht në fshatin Gungage. Laguna është përcaktuar gjithashtu dhe si një zonë Ramsar (ligatinë e rëndësishme ndërkombëtare).
- *Rezervatet Natyrore*: Rezervatet natyrore që gjenden brenda korridorit prej 2 km (1 km në secilën anë të gjurmës) përfshijnë Rezervatin Natyror të Menaxhuar të Bogovës (Kategoria IV, sipas IUCN).
- *Monumentet e Natyrës*: Edhe pse ekziston një listë e Monumenteve të Natyrës të përfshira në vendimin e qeverisë shqiptare Nr. 676, datë 20/12/2002, nuk ekziston një hartë zyrtare me vendndodhje dhe kufij të saktë. Si rezultat, vendndodhja dhe distanca e saktë nga linja qendrore e alternativës e të gjitha Monumenteve të Natyrës brenda zonës së studimit nuk është ende e njohur. Monumentet e njohura të Natyrës që gjenden brenda korridorit 2 km (1 km në secilën anë të gjurmës) përfshijnë: Pyllin e Shën Pjetrit, Bredhin e Vishajt, Pyllin e Markezës, Burimin e Voskopit dhe Symizën. Më tej, i vetmi Monument i Natyrës me një perimetër të përcaktuar është Monumenti Natyror i Pyllit të lartë përgjatë shtratit të vjetër të Lumit Seman, i cili ndodhet rreth 3 km në veri të gjurmës.
- Peizazhe të mbrojtura:
  - *Zona e Peizazhit të Mbrojtur të Nikolicës*: Zona e mbrojtur e Nikolicës (kategoria V, sipas IUCN) gjendet rreth 4.5 km në jug të gjurmës në zonën lindore të studimit. Zona u shpall zonë e mbrojtur në vitin 1996

(Vendimi i Këshillit të Ministrave No.102, datë 15/1/1996) (MMPAU 2008). Zona e mbrojtur ka një sipërfaqe prej 510 ha dhe mbështet një sërë habitatesh duke përfshirë: pyje gjethegjere të vjetër të përziera Quercus sp. dhe zona pyjore halore me pishe të zeza Pinus nigra.

Zona të mbrojtura të propozuara, bazuar mbi Strategjinë dhe Planin e Veprimtimit për Biodiversitetin (SPVB):

- *Cangonji - Bredhi i Drenovës – Nikolicë – Gramoz Zona e Peizazhit të Mbrojtur (e njohur gjithashtu dhe si Morava):* SPVB parashtron vizionin e tij për një rrjet kombëtar të zonave të mbrojtura dhe planet për një hapësirë të zgjeruar të zonave të mbrojtura, të cilat përfshijnë Zonën e Peizazhit të Mbrojtur të Nikolicës, Parkun Kombëtar të Bredhit të Drenovës, Rezervatin e Menaxhuar të Cangonjit dhe një numër të Monumenteve të Natyrës. Përveç kësaj, kjo zonë do të jetë gjithashtu pjesë e një zone të mbrojtur ndërkufitare me Greqinë.
- Peizazhi i mbrojtur i masiveve malore që përfshijnë Malin e Ostrovicës, Vithkuqit dhe Rungajës
- *Vendndodhjet e Rrjetit Emerald:* Rrjeti Emerald është një sistem Pan Evropian i zonave të mbrojtura, i projektuar për të përmbushur disa nga kërkesat e përcaktuara në Konventën e Bernës. Në vendet jo anëtare të BE, të tilla si Shqipëria, përcaktimi i vendndodhjeve Emerald bëhet në nivel kombëtar dhe i dorëzohet drejtpërdrejt Këshillit të Evropës për pranim. Në vendet e BE, vendndodhjet përcaktohen dhe i dorëzohen Këshillit të Evropës nëpërmjet rrjetit Natyra 2000 (d.m.th. rrjeti Natyra 2000 përfshin zonat e përcaktuara të mbrojtura në vendet e BE për t'u përfshirë në Rrjetin Emerald). Shqipëria ka tashmë disa zona Emerald të propozuara, por po punon për shpalljen dhe ngritjen e tyre. Në vitin 2009 u botua (nga Këshilli i Evropës) një listë e 25 vendndodhjeve të propozuara Emerald (të gjitha vendndodhjet Emerald konsiderohen automatikisht si Zona me Interes Mbrojtje të Veçantë (ASCIs) në të gjithë vendin.

Gjurma nuk kalon nëpër ndonjë nga zonat e mbrojtura aktualisht. Në pjesën lindore dy zonat e mbrojtura më të afërta me gjurmën janë Parku Kombëtar Bredhi i Drenovës (rreth 3 km në veri të gjurmës së propozuar) dhe Zona e Peizazhit të Mbrojtur të Nikolicës (rreth 4.5 km në jug). Brenda korridorit prej 2 km të gjerë përgjatë gjurmës gjenden katër Monumente Natyre: Pylli i Shën Pjetrit, Bredhi i Vishajt, Pylli i Markezës, Burimi i Voskopit. Përveç kësaj, gjurma kalon dhe zonën e propozuar për mbrojtje të Peizazhit të Cangonjit - Bredhi i Drenovës – Nikolicë - Gramoz (e njohur edhe si Morava). Kjo zonë është propozuar si një zonë e mbrojtur në nivel kombëtar, por edhe si pjesë e rrjetit Emerald evropian. Ministria e Mjedisit e Shqipërisë ka qartësuar se kalimi i një tubacioni nëpër këtë zonë nuk bie ndesh me strategjinë e ruajtjes për këtë rajon dhe mund të përfshihet në planin e menaxhimit të një zone me peizazh të mbrojtur.

Në pjesën qendrore gjurma kalon Zonën e propozuar për Mbrojtje të Peizazhit të Vithkuqit. Aktualisht nuk disponohet asnjë informacion i detajuar mbi

statusin e zonës së propozuar të peizazhit të mbrojtur, mbi përkatësinë e saj të mundshme në rrjetin Emerald ose mbi vendndodhjen e saktë dhe kufijtë e zonës (vetëm SPVB 2000 ofron një hartë të përafërt reference). Më në veri, gjurma kalon pranë Rezervatit Natyror të Menaxhuar të Bogovës, një pjesë e të cilit ndodhet brenda korridorit prej 2 km të gjerë. Brenda korridorit është identifikuar një Monument Natyre, një zonë pyjore e quajtur Symizë, në afërsi të Backës.

Në seksionin perëndimor zona e mbrojtur më e afërt me gjurmën është Monumenti Natyror i Pyllit të lartë përgjatë shtratit të vjetër të Lumit Seman (Adriatik, Libofshe), i cila ndodhet përafërsisht 3 km në veri të gjurmës. Kufiri i zgjeruar i Parkut Kombëtar të Lagunës së Karavastasë ndodhet rreth 3 km në veri të kalimit të propozuar në det D (i cili është ende nën shqyrtim - shihni seksionin 3.3.3).

#### *Zonat e Tjera me Interes Ekologjik*

Brenda zonës së studimit janë identifikuar një numër biotopesh KORINE. Biotopet KORINE janë zona që janë identifikuar si "vendndodhje të rëndësishme të natyrës" në të gjithë Evropën nga Agjencia Evropiane e Mjedisit dhe përfshijnë habitate të ndjeshme apo të rralla. Megjithatë këto zona, nuk kanë asnjë status mbrojtjeje (as kombëtar, as ndërkombëtar), por konsiderohen si një referencë e rëndësishme për të identifikuar vendet me interes mjedisor të rajonit.

Biotopet KORINE që përshkohen nga gjurma e propozuar janë:

- Biotopi KORINE i Cangonjit - Bredhi i Drenovës - Nikolicë;
- Biotopi Vithkuq-Ostrovicë;
- Biotopi i grykëderdhjes së Semanit - Pishë Poro (Fier).

#### *Peizazhi*

Pjesa lindore (sidomos në lindje të fshatit Floq) karakterizohet nga vlera të larta të peizazhit. Gjurma kalon në zona që përfshijnë një kombinim të mjediseve natyrore dhe përdorimit tradicional të tokës të tilla si, kullotat, tokat bujqësore, etj. Pjesa qendrore e gjurmës kalon nëpër peizazhe malore me bimësi të rrallë përreth Malit të Ostrovicës. Më pas gjurma vazhdon në perëndim përmes zonave malore me kaçube dhe zonave kodrinore me bimësi të rrallë, gjithashtu me zona të rastësishme të peizazheve të pyllëzuara në Çorovodë. Në këtë pikë gjurma zbret në luginën e lumit Osum, përgjatë të cilës ajo shtrihet në drejtim të veriut dhe kalon nëpër luginë dhe përgjatë kreshtave në anën perëndimore të tij në Poliçani. Seksioni perëndimor i gjurmës kalon nëpër disa zona të mbjella me ullinj, disa prej të cilave, kryesisht përreth Beratit, janë pemë të lashta, të cilat ka të ngjarë të jenë mbi 100 vjeçare. Pjesa më e madhe e terrenit nëpër të cilin kalon gjurma është relativisht e sheshtë dhe asnjë seksion i gjurmës nuk e kalon pjerrësinë 30°.

*Hyrja*

Shqipëria është e përbërë prej 12 ndarjesh administrative rajonale (*Qarku ose Prefektura*) të cilat janë të ndara në 36 Rrethe, ku secili ka një qytet kryesor. Prefekturat janë të ndara në njësi të pushtetit vendor të cilat përfaqësohen nga bashkitë dhe komunat. Koridori kalon në tre Prefektura: Korçë, Berat, Fier dhe 23 bashki/komuna.

Ekonomia shqiptare varet shumë nga bujqësia, e cila në 2008 përbënte 21% të GDP (me çmimet aktuale). Sektori privat është dominuar prej ndërtesave të vogla private që prej rënies së komunizmit në 1991, ku u shkrinë fermat kolektive. Pra, bujqësia ngelet sektori më i rëndësishëm i punësimit në Shqipëri pasi përbën rreth 60% të të gjithë punësimit në vend. Në vitet e fundit një rritje në bizneset e vogla, kryesisht në ndërtim dhe industrinë prodhuese, ka krijuar mundësinë për më shumë punë të reja. Sektori publik ngelet gjithashtu një punëdhënës i rëndësishëm lidhur me numrin e punonjësve.

*Konteksti Socio-Ekonomik*

Seksioni lindor i korridorit karakterizohet prej zonave të mëdha pyjore dhe depozitime të zonave të ulëta për prodhimet sezonale të të korrurave. Ka 11 vendbanime brenda korridorit prej 2 km me një total prej 5.465 banorësh. Këto vendbanime kanë një popullatë prej 80 banorësh (Sinicë, Komuna Miras) dhe deri në 2,387 banorë (Miras, Komuna Miras). Banimet e Çetë dhe Miras, pranë kufirit Grek, dhe Kamenica janë të vetmit vendbanime me një popullatë prej mbi 400 banorësh. Thuhet se 90% e popullatës që jeton brenda zonës së studimit, është e përqendruar në këto tre vendbanime. Pyjet dhe zona me shkurre përbëjnë zonat më të mëdha brenda korridorit prej 2 km dhe përfaqësojnë 70% të të gjithë tokës në përdorim. Kjo tokë, së bashku me tokën për rritjen e bagëtisë, përdoret nga banorët për kullota. Prodhimi i të korrurave sezonale zë 28% të përdorimit të tokës brenda korridorit. Prodhimi i përhershëm i të korrurave gjendet vetëm në komunën e Mollajt dhe përbën 1% të përdorimit të të gjithë tokës. Ka të ngjarë që ekonomia e zonës rreth Miras të jetë më e shumëllojshme.

Në pjesën qendrore të korridorit, përdorimi i tokës karakterizohet prej zonave pyjore dhe malore me zona të vogla të tokës bujqësore që rrethojnë vendbanimet. Çorovoda është qyteti kryesor i zonës me një popullatë prej 8.907 banorësh. Pjesa tjetër e vendbanimeve janë relativisht të vogla me 5.033 banorë të shpërndarë në 15 vendbanime. Aktiviteti kryesor ekonomik i vendbanimeve malore rurale përbëhet nga prodhimi bujqësor, e cili konsiston në një kombinim të prodhimit të të korrurave dhe të blegtorisë; një pjesë e madhe e së cilës është ndërmarrë në nivele të larta.

Pjesa përfundimtare e Korridorit kalon rrethin e Beratit, i cili është kodrinor, duke krijuar një mozaik të prodhimit të korrurave dhe kullotjes sezonal dhe të përhershëm. Koridori gjithashtu kalon dhe në rrethin e Fierit i cili është më i sheshtë dhe më uniform, terren i cili përdoret për prodhimin e të korrurave sezonale. Koridori kalon përmes një zone të nxjerrjes së naftës midis komunës së Roskovecit dhe Mbrostarit. Për pothuajse gjysmën e komunës mjeti kryesor i jetesës është prodhimi i të korrurave sezonale dhe të përhershëm.

29% e komunave mbështeten në një kombinim të prodhimit të korrurave dhe të blegtorisë. Afërsia e qyteteve të Beratit dhe Fierit, përveç zonës së komunës së Roskovecit për nxjerrjen e naftës, rezulton që 24% e komunave të kenë një ekonomi të shumëllojshme.

#### 5.1.4 *Trashëgimia Kulturore*

Zonat me interes për trashëgiminë kulturore që gjendet përgjatë gjurmës përfshijnë:

- Luginën e lumit Devoll pranë Mirasit;
- Zonën përreth fshatit Vithkuq;
- Zonat midis Floqit, Kamenicës, Pulahës dhe Bellovodës;
- Fshatrat e Osojës, Jaupasit, Vojakës, Mbrakullit, Shën Todit, Peshtanit, Vodices, Beratit, Lapardhasë, Zharrëzës, Mbrostarit, Petovës dhe Topojës;
- Pjesën lindore të ultësirës bregdetare.

Vendndodhjet e identifikuara të trashëgimisë kulturore u përkasin periudhave Parahistorike, Antikitetit të Vonë, periudhës Klasike dhe Mesjetës.

Vendndodhjet më të zakonshme janë pirgje varresh, vendndodhje të hapura, fortifikime në majat e kodrave, arkitekturë historike, kisha/manastire, ura dhe fortifikime e struktura helenike.

## 5.2 *SEKSIONI DETAR*

### 5.2.1 *Mjedisi*

#### *Studimi i Thellësive dhe Lëvizja e Ujit*

Thellësia e ujit përgjatë gjurmës së propozuar varion nga thellësia midis baticës zbatues dhe deri në rreth 800 m. Platforma kontinentale shtrihet përgjatë 25 km të gjurmës së propozuar nga brigjet shqiptare, duke arritur një thellësi prej rreth 200 m.

Rrymat në Detin Adriatik karakterizohen nga prania e një vërtitje/vorbulle të madhe rryme në qendrën të tyre, e cila lëviz në drejtimin e kundërt të akrepave të orës. Kjo vorbull e madhe ndonjëherë shpërbëhet në vorbulla të vogla. Në të dyja variantet, rrymat rrjedhin përgjithësisht në drejtim të veriut përgjatë brigjeve lindore të detit Adriatik (Rryma Lindore - Adriatiku Jugor), çfarë korrespondon me zonën e studimit, dhe në drejtim të jugut përgjatë brigjeve perëndimore. Vorbullat dhe rrymat bregdetare janë më të forta në verë dhe vjeshtë (Poulain, 2001). Baticat dhe zbaticat në këtë zonë kanë një ndryshim maksimal prej rreth 45 deri në 50 cm.

#### *Sedimentet e Fundit të Detit*

Në terma të përgjithshme Deti Adriatik është një pellg molasësh që ushqehen nga sedimentet e ardhura nga masat e tokës përreth. Sedimentet vijnë kryesisht nga materialet e transportuara nëpërmjet lumenjve në këtë zonë. Grykëderdhjet më të afërta të lumenjve në pikën e kalimit në det janë lumi Seman në veri dhe lumi Vjosë në jug.

Shkarkimi sipas stinëve të sedimenteve është i kushtëzuar nga kushtet e Mesdheut, me përmbajtje të mëdha gjatë dimrit (nëntor-prill) dhe nivele të ulëta të ujit nga qershori deri në gusht. Për rrjedhim, fundi i detit përgjatë gjurmës së propozuar është i mbuluar me sedimente të buta, të formuara kryesisht nga rëra e butë dhe baltërat. Pranë bregut mund të gjenden një sërë brezash me rërë të ashpër dhe zhavorr

Sedimentet në afërsi të kanalit të Hoxharës priten të jenë të ndotura nga hidrokarburet, si rezultat i ndotjes së gjerë të naftës që vjen nga fushat e naftës përreth Fier. Gjatë vëzhgimeve në terren përgjatë plazheve pranë kanalit të Hoxharës, janë vërejtur shenja të dukshme të ndotjes nga nafta. Për momentin ende nuk dihet shkalla aktuale e ndotjes.

#### *Habitatet Bentike dhe Komunitetet Biologjike*

Në vitin 2006 u krye një vëzhgim i mjedisit detar gjatë gjurmës detare të rastit bazë (Ref. 3, Shtojca E). Vëzhgimi u përqendrua kryesisht në seksionin e gjurmës pranë bregut ku bëhet kalimi A në det (shihni Figurën 3.2) dhe përfshiu aktivitetet e mëposhtme:

- Vëzhgime video/fotografike për të përcaktuar praninë/mungesën e livadheve fundore detare përgjatë gjurmës;
- Marrjen e kampionëve të sedimenteve të fundit të detit për të mbledhur organizma bentikë që jetojnë brenda shtresave të sipërme të sedimenteve të buta.

Zona karakterizohet nga një diversitet i ulët llojesh fundore detare, si rezultat i depozitimeve të sedimenteve terrigjene që shkarkohen nga lumenjtë e shumtë të bregdetit shqiptar.

Ky shkarkim i vazhdueshëm i sedimenteve të imta dhe të paqëndrueshme së bashku me një sasi të caktuar të lëndës organike krijojnë një mjedis që karakterizohet nga paqëndrueshmëria e dheut dhe turbullirat. Kushte të tilla sjellin mungesën e fanerogameve detare, të tilla si *Posidonia oceanica*, por edhe të llojeve më tolerante si *Cymodocea nodosa* dhe *Zostera spp.*

Thellësitë deri në 14 metra përgjatë gjurmës janë të mbizotëruara nga komuniteti biologjik i Rërave të Imta të Mirë-Ndara (RIMN) (Peres & Picard, 1964), i cili është formuar kryesisht nga molusqët shpuese dyvalvësh të tilla si, *Acanthocardia paucicostata*, *Tellina donacina* dhe *T. nitida*, gastropodet si *Natica ebraea* dhe anelidi *Arenicola marina*. Ky komunitet biologjik është tolerant ndaj ndryshimeve të nivelit të kripërave dhe është tipik për grykëderdhjet e lumenjëve.

Brenda këtij komuniteti biologjik, në intervalin e thellësive 6 dhe 14 m, u vu re prania në rritje e llojeve shumë tolerante ndaj mbulimeve periodike nga fenomenet e depozitimit të sedimenteve. Këto lloje përfshinin, ndër të tjera bivalvoret *Nucula nucleus* dhe *N. sulcata*, gasteropodet *Natica filosa* dhe *Nassarius pygmaeus*, skafopodet *Antalis inaequicoasttus*, anelidet polikete *Heteromastus filiformis* dhe *Cirratulus cirratus*, gaforret Dekapode *Alpheus glaber*

dhe *Jaxea nocturna*, stomatopodet *Squilla mantos* dhe ekinodermatet *Amphiura chiajei* dhe *Brissopsis lyrifera*.

Përveç kësaj, në thellësitë nën 14 m u vunë re dhe disa breza të komunitetit biologjik të Rërës së Trashë dhe Zhavorrit të Imët të Trazuar nga Valët (SGBV) (Peres & Picard, 1964).

Në thellësitë midis 15 dhe 75 m shfaqet komuniteti biologjik i Baltërave Bregdetar Terrogjene (VTC) (Peres & Picard, 1964). Ndër llojet e vëzhguara të tipit zoo-bentik, të cilat karakterizojnë komunitetin biologjik, gjenden anelidi *Sternopsis scutata* dhe mollusku *Turritella communis*.

Në thellësitë më të mëdha detare, përafërsisht në 170 m, mund të vërehet një zonë e gjerë e karakterizuar nga prania e bollshme e bivalvorit të ngordhur *Neopycnodonte cochlear*. Prania e këtij bivalvori sugjeron ekzistencën e mundshme të mëparshme bregdetare të komuniteteve më të pasura dhe më të larmishme bentike se ato që vërehen aktualisht. Është e qartë se me kalimin e kohës ata kanë qenë objekt i një fenomeni gradual të groposjes si rrjedhojë e nivelit të lartë të sedimentimit të materialeve të imta të sjella nga shkarkimet e shumta të ujit të pranishme përgjatë bregdetit.

Ujërat më të thella në këtë zonë janë më pak të njohura, megjithatë, dy vrojtimitet detare të ndërmarra në rajon nga një institut kërkimor italian, CoNISMa (Consortio Nazionale per le Interuniversitario Scienze del Mare) treguan se në zonën batiiale (200 - 1000 m) diversiteti i llojeve dhe numri i tyre ulet në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me ato të zonës circalitorale (40-200 m).

#### *Plankton*

Të dhënat ekzistuese mbi fitoplanktonin dhe zooplanktonin brenda zonës së projektit janë të kufizuara. Në kampionet e mbledhura në tetor të vitit 2000 nga CoNISMa, kopepodet ishin grupi mbizotërues, e ndjekur përse i përket numrit nga Ketognatet, Ostrakodet, Apendikularët, vezët e invertebroreve *Doliolida*, *Cladocera* dhe taksone të tjera.

#### *Ikti fauna*

Ikti fauna e zonës është e pasur si në demersalë (peshqit që jetojnë në afërsi të fundit të detit) ashtu dhe në pelagjikë (peshq që jetojnë zakonisht në kolonën e ujit në zonën pelagjike).

#### *Breshka e Detit dhe Gjitarët e Detit*

Në detin Adriatik ndeshen tre lloje breshkash detare, me të cilat nënkuptojmë breshkën e detit (*Caretta caretta*), breshkën e gjelbër (*Chelonia mydas*) dhe breshkën lëkurore detare (*Chelonia mydas*), kjo e fundit konsiderohet një vizitore e rrallë.

Përse u përket gjitarëve të detit, me gjithë mungesën e studimeve të veçanta, pesë lloje mund të konfirmohen si banorë të ujërave shqiptare: *Physeter macrocephalus* (kashaloti), *Ziphius cavirostris* (balena me sqep), *Tursiops truncatus* (delfini turishkurtër), *Stenella coeruleoalba* (delfini me viza) dhe *Delphinus delphis* (delfini i zakonshëm).

*Hyrja*


Shqipëria ka një vijë bregdetare prej 300 km përgjatë Deteve Adriatik dhe Jon. Kufiri detar midis Shqipërisë dhe Italisë mbi ndarjen kontinentale është përcaktuar prej një Marrëveshje të nënshkruar më 18 Dhjetor 1992. Peshkimi dhe lundrimi janë të hapura për vendet e tjera për aq kohë sa nuk janë përcaktuar Zona të Përrjashtimit Ekonomik ose të Rezervës së Peshkimit. Midis Italisë dhe Shqipërisë nuk ekziston as Rezervë për Peshkimin as Zonë e Përrjashtimit Ekonomik.

*Peshkimi*

Peshkimi brenda ujërave territoriale (12 milje detare) në Mesdhe është rezervuar për anijet kombëtare. Jashtë ujërave territoriale nuk ekziston ndonjë kufizim i tillë. Numri i punonjësve në sektorin e peshkimit në Shqipëri është përlogaritur të ketë qenë 5.200 për 2002 (të dhënat e FAO-s).

Sektorin e peshkimit në Shqipëri arriti nivelet më të larta të produktivitetit në fund të viteve 1980 deri në 1990. Produktiviteti ra shumë në vitet '90 dhe kjo korrespondon me ndryshimet drastike në vend dhe fillimin e tranzicionit drejt një ekonomie tregu. Drejt fundit të dekadës, prodhimi filloi të rritej përsëri. Tendanca e produktivitetit të kapjes (kapjet e peshkut që kanë ardhur në Shqipëri), ilustron në *Figurën 5.1*.

**Figura 5.1** *Prodhimi i Peshkut sipas Kapjes në Shqipëri midis 1970 dhe 2007*



Burimi: FAO – Shërbimi i Statistikave dhe Informacionit mbi Peshkimin dhe Akuakulturën

Kapjet në det përbëjnë afërsisht gjysmën e prodhimit të përgjithshëm, sipas të dhënave të FAO-s të 2002, pjesa tjetër përbëhet nga kapjet në ujë të ëmbël dhe akuakulturë. Sipas të njëjtit burim, sasi të peshkut të importuar në Shqipëri janë shumë më të mëdha krahasuar me prodhimin në vend me 15.000 t kundrejt 3.500 t prodhuar në 2003.

Përsa i përket llojit të peshkut të kapur, është i disponueshëm fusha e mëposhtme informative:

- **Peshkrimi fundor detar:** Peshkarexha dhe anije të vogla duke përdorur litarët e gjatë dhe rrjetat që aktualisht shfrytëzojnë burimet detare fundore. Në përgjithësi, anijet janë të vjetra dhe gjendja e tyre është e dobët. Peshku i kapur nga anijet e mëdha vendoset në kuti dhe mbulohet me akull në det. Pak anije janë të pajisura me ndihmësit modernë të peshkimit, të tilla si jehona e tingullit ose regjistruet të pozicionit global. Merluci (*Merluccius Merluccius*) është një nga llojet fundore të peshkut në Adriatik më të shfrytëzuara nga ana komerciale.
- **Peshkimi i vogël në det të hapur:** Në të shkuarën, anijet shqiptare kapnin sardele dhe në nivele më të ulëta, një lloj të veçantë sardeleje duke përdorur rrjetë të vogël. Për momentin ky peshkim nuk është i shfrytëzuar dhe modernizimi i flotës është prioritet. Prodhimi i këtij lloji të veçantë të sardeles në detin Adriatik dominohet aktualisht prej daljes në breg të italianëve me rreth 90%, dhe prej flotave që dalin në det të hapur prej Sllovenisë, Kroacisë dhe Shqipërisë të përqendruar kryesisht te sardelet.

#### Flota e Peshkimit të Shqipërisë

Flota e peshkimit të Shqipërisë gjendet kryesisht në portet e mëdha të Durrësit dhe Vlorës. Në portin e Durrësit gjendet numri më i madh i barkave të peshkimit, ku ka 98 anije të regjistruara krahasuar me 45 Vlorë<sup>1</sup>.

#### *Turizmi*

Të dhënat mbi udhëtimet dhe arsyet e udhëtimit të ofruara nga INSTAT (të dhënat e 2007) tregojnë se niveli i turizmit po rritet. Pjesa më e madhe e vizitorëve janë me origjinë shqiptare por numri i vizitorëve ndërkombëtarë po rritet gjithashtu me një shpejtësi të madhe. Pjesa e rajonit të Fierit ka një potencial të mesëm – të lartë për zhvillimin e turizmit. Aktualisht ka vetëm pak struktura portuale detare dhe turistike përgjatë bregut.


#### *Lundrimi dhe Transporti Detar*

I gjithë Deti Adriatik përbëhet nga një zonë publike transporti mallrash ku trafiku i mallrave është intensiv. Figura 5.2 ofron një tregues të zonave ku përqendrohet më shumë trafiku i mallrave dhe është paraqitur përmes një densiteti më të lartë të vizave të zeza.

---

(1) : Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit, 2008

**Figura 5.2** Linjat e Transportit të Mallrave në Detin Adriatik dhe Jon



Burimi: Qendra Kombëtare për Analizat dhe Sintezën Ekologjike, NCEAS

Durrësi është porti i parë i Shqipërisë dhe ndodhet në veri. Durrësi ofron lidhje me portet italiane të Ankonës, Barit, Brindisit dhe Triestes. Vlorë, porti më i afërt në jug, ofron lidhje me portet italiane të Barit dhe Brindisit.

Trajetet për në portet shqiptare zakonisht vijnë në mëngjes dhe nisen pasdite. Periudhat më të ngarkuara për trajetet janë midis muajve gusht dhe shtator dhe për Krishtlindje. Trafiku i trajecteve dhe i atyre që transportojnë mallra është planifikuar që të funksionojë gjatë gjithë vitit, megjithëse mund të pengohet gjatë muajve të dimrit, sidomos në nëntor dhe dhjetor për shkak të kohës së keqe.

### 5.2.3 *Trashëgimia Kulturore*

#### *Arkeologjia Detare*

Si pikë lidhëse midis Ballkanit perëndimor dhe lindor, ujërat e Shqipërisë kanë qenë trafikuar intensivisht që prej kohëve të lashta dhe mesjetare. Mundësitë për të ndeshur gjetje arkeologjike të këtyre periudhave janë më të mëdha në zonat pranë bregdetit sesa në zonat në det të hapur, duke qenë se zakonisht anijet qëndronin pranë bregut që të kishin kontakt viziv me tokën.

Duke pasur parasysh informacionin e disponueshëm mbi rajonet pranë, sidomos në zonën e Vlorës në jug të rajonit tonë të interesit, prania e mbetjeve arkeologjike marine të periudhave Greke, Romake dhe Ilire, si dhe të Luftës së Parë dhe Dytë Botërore janë të pritshme. Nuk ka ndonjë informacion specifik të publikuar paraprakisht për mundësinë e pranisë së këtyre mbetjeve në zonë.

## 6.1

## HYRJA

Tabelat 6.1 – 6.8 pasqyrojnë një listë të ndikimeve kryesore të mundshme mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore për pjesën në tokë (Tabela 6.1 – 6.6) dhe për pjesën në det (Tabela 6.7 dhe 6.8) të TAP në Shqipëri. Tabelat prezantojnë informacionin e mëposhtëm:

- **Zona e Ndikimit:** listë e zonave të ndikimit të synuara ndërsa komponentët mjedisor, socio-ekonomik dhe të trashëgimisë kulturore janë potencialisht të ndikuar t prej aktiviteteve të projektit;
- **Ndikime të Mundshme të Rëndësishme:** listë e llojeve të ndikimeve ose burime të ndikimeve të cilat mund të ndodhin prej projektit mbi bazën e informacionit i cili është aktualisht i disponueshëm (projekti dhe gjendja bazë). Madhësia dhe rëndësia e ndikimit duhet të sigurohen gjatë vlerësimit të detajuar të ndikimit.
- **Zona e Influencës:** zona gjeografike e cila mund të preket nga ndikimi. Përcaktimi i zonës së ndikimit mendohet të jetë orientuese. Shtrirja e zonës së ndikimit duhet të sigurohet gjatë vlerësimit të detajuar të ndikimit.
- **Opsionet e Zbutjes:** listë e llojeve të zbutjeve dhe të masave të kontrollit që mund të merren në konsideratë atje ku janë identifikuar ndikime të rëndësishme gjatë vlerësimit.

Lidhur me Zonën e Influencës janë përdorur kriteret e mëposhtme:

- **Vendor** – ndikimet që ndikojnë burimet trashigimore vendore mjedisore, socio-ekonomike ose kulturore ose janë të kufizuara në një habitat/biotop të vetëm, një zonë më vete (vendore) administrative ose një komunitet më vete. Edhe pse konsiderohet si vendore, shtrirja e mundshme gjeografike e secilit ndikim brenda kësaj kategorie mund të jetë e ndryshme, në varësi të llojit të ndikimit dhe vendndodhjes. Ndikimet vendore mund të kufizohen të drejta për Gjurmën (DGJ, 10-20 m e gjerë), korridori i punimeve (rreth 40 m i gjerë) dhe zonat e ndikuara drejtë për drejtë prej strukturave respektive (p.sh. rrugët hyrëse, kampet e punëtorëve dhe fushat e tubave), megjithatë do të ketë ndikime vendore të cilat shtrihen përtej, por që janë ende brenda kontekstit (p.sh. brenda distancave qindra metrash ose kilometrike prej DGJ). Orientimet mbi madhësinë e distancës për secilin ndikim janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.
- **Rajonal/Vendor** - Do të tentohet që shtrirja gjeografike e ndikimit rajonal do të jetë deri në dhjetëra kilometra.

- **Kombëtar** - ndikimet që ndikojnë burimet trashëgimore kombëtare mjedisore, socio-ekonomike ose kulturore ose ndikojnë mbi një zonë e cila është e mborjtur në nivel kombëtar ose është e rëndësishme. Do të tentohet që shtrirja gjeografike e ndikimit kombëtar të jetë deri në qindra kilometra.
- **Ndërkufitar / Ndërkombëtar / Global** – ndikimet që ndihen në një vend (ose në disa vende) si rezultat i aktiviteteve të një vend tjetër, të cilat mund të arrijnë në disa raste në nivel planeti (p.sh. ngrohja globale).

Ndërtimi, futja në punë, ndikimet operacionale dhe të nxjerrjes nga përdorimi, janë organizuar sipas zonave të ndikimit të mëposhtme:

- Zhvendosje e Përdorimit të Tokës, Pronës dhe Njerëzve;
- Burimet dhe Mbetjet;
- Gjeologjia, Tokat dhe zonat e Ndotura;
- Mjedisit Ujor;
- Cilësia e Ajrit dhe Faktorët Klimatikë;
- Zhurma dhe Dridhjet;
- Biodiversiteti dhe Mbrojtja Mjedisore;
- Peizazhi dhe Ndikimi Vizual;
- Ndikimet Socio-ekonomike;
- Siguria dhe Shëndeti i Komunitetit;
- Kushtet e Punës;
- Arkeologjia dhe Trashëgimia e Ndërtuar.

## 6.2 PJESA KONTINENTALE

### 6.2.1 Ndërtimi

**Tabela 6.1 Ndikimet e Mundshme Mjedisore dhe Masat Zbutëse Lidhur me Ndërtimin në Tokë dhe Futjen në Punë**

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Burimet dhe mbetjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdorim i sasive të mëdha të materialeve ndërtimore</li> <li>Hedhja e mbetjeve të ndërtimit</li> <li>Transporti i materialeve ndërtimore dhe mbetjeve</li> <li>Konsumimi i karburantit prej makinave dhe makinerive</li> <li>Menaxhimi i kanalizimeve (ujërat e zeza dhe gri) dhe hedhja</li> <li>Përdorimi i ujit për aktivitetet ndërtimore, kampeve dhe kantierëve</li> <li>Përdorimi i ujit për futjen në punë (testimi hidrik)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nga Vendore në Rajonale, në varësi të ndikimit dhe vendit specifik të hedhjes së mbeturinave dhe origjinës së materialeve ndërtimore dhe karburantit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Materialet të gjenden dhe të hidhen sipas parimeve të prokurimit më të përshtatshme dhe sa më pranë që të jetë e mundshme me projektin në mënyrë që të minimizohen ndikimet e prodhimit dhe transportit.</li> <li>Identifikimi i përdorimeve përfituese ose i mundësive për riciklimin e dëmit të ndërtimit dhe të mbetjeve të tjera, atje ku është e mundshme.</li> <li>Plani dhe sistemi i menaxhimit të mbetjeve për t'u zbatuar.</li> <li>Plani Menaxhimit Social dhe Mjedisor</li> <li>Vlerësim i burimeve ujore për testin hidrik në mënyrë që të minimizohen ndikimet ndaj përdoruesve të tjerë të ujit dhe të habitateve ujore.</li> </ul>
Gjeologjia, Toka dhe toka e ndotur	<ul style="list-style-type: none"> <li>Punime gërmimi gjatë ndërtimit duke përfshirë shfrytëzimin në terren atje ku është e nevojshme (stacionet e kompresorit, stacionet e valvolave të bllokimit, vendi i shkarkimit dhe tuneli)</li> <li>Pastrimi i korridorit të punimeve, zona logjistike (kantieret, vendet e kampeve) dhe rrugët lidhëse do të ndikojnë shtresën e punueshme, duke krijuar një rrezik për humbjen e burimeve</li> <li>Duhet, gjithashtu, të merret në konsideratë ngjeshja e tokës dhe ndotja aksidentale (referojuni, gjithashtu, burimeve dhe mbetjeve)</li> <li>Sedimente të ndotura prej aktiviteteve të mëparshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, brenda korridorit të punimeve (40 m) dhe gjurmës së lehtësirave shoqëruese (stacionit të kompresorit dhe valvolave të bllokimit)</li> <li>Ndikimet prej sedimenteve të ndotura do të jenë Vendore ose Rajonale në varësi të vendndodhjes së hapësirës për hedhjen e mbeturinave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani i menaxhimit të zonës së ndërtimit</li> <li>Ruajtja e shtresës së punueshme</li> <li>Rivendosja e shtresës së punueshme pas përfundimit të veprimtarisë ndërtuese</li> <li>Planifikimi &amp; Ruajtja e e rrjedhjeve të Karburanteve &amp; Kimikateve</li> <li>Hulumtime të detajuara të gjurmës për të shmangur zonat e ndotura</li> </ul>

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Mjedisi Ujor	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet mbi habitatet ujore, cilësisë së ujit &amp; morfologjisë së lumit prej kalimeve të lumenjve të të drejtës së gjurmës dhe të rrugëve lidhëse</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimi mbi morfologjinë e lumit do të jetë vendor dhe zakonisht brenda korridorit të punimeve (40 m). Ndikimet mbi cilësinë e ujit do të varen prej lumit/kanalit që do të kalohet por mund të jetë deri në qindra metra prej kalimit në rrjedhën e sipërme (p.sh. në lumenjtë/kanalet e ndikuar nga batica) dhe midis qindra metra dhe një kilometri në pjesën e rrjedhës së poshtme. E njëjta gjë zbatohet te kalimet e lumit gjatë hapjes së rrugëve të reja lidhëse</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Minimizimi i numrit të kalimeve të lumit</li> <li>Përzgjedhja e vendeve të kalimit për të minimizuar ndikimin ndaj bimësisë anësore dhe ndaj kanaleve të lumenjve dhe habitatit</li> <li>Përzgjedhja e dritares së punës për të minimizuar ndikimet mbi llojet e ujit dimri)</li> <li>Monitorimi i cilësisë së ujit – Plani i Monitorimit Mjedisor</li> <li>Rikthimi i kanalit, brigjeve dhe i bimësisë bregore siç ishte në gjendjen e para-ndërtimit</li> <li>Menaxhimi i auditit dhe rikthimi</li> <li>Teknikat alternative të ndërtimit për të hapur kanalën e prerë dhe mbushja (p.sh. Gërryerja me Drejtim Horizontal)</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Perhapja e sedimenteve të krijuara prej korridorit të punimeve, kampit, kantierit dhe të rrugëve lidhëse për shkak të shirave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendor, distancat specifike në varësi të kushteve vendore Mund të jetë deri në një kilometër në pjesën e poshtme të rrjedhjes së vendndodhjes së shkarkimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Menaxhimi i korridorit të punimeve, rrugëve lidhëse, kantierëve dhe kampeve për të minimizuar që sedimentet të shkarkohen në rrjedhat ujore (gardhe, kurthe, mbjellja me bimësi e pirqjeve me balte dhe e zonave të marxhinalizuara etj.)</li> <li>Monitorimi i rrjedhave ujore / trupave ujorë – Plani i Monitorimit Mjedisor</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndotja prej naftës &amp; kimikateve prej makinerive që punojnë në korridorin e punimeve, kantiere, kampe dhe rrugët hyrëse.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, zakonisht brenda korridorit të punimeve (40 m). Distancat specifike varen prej kushteve vendore. Mund të jetë deri në një kilometër në pjesën e poshtme të rrjedhjes prej vendndodhjes së çlirimit aksidental</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Procedurat për furnizimin / mbajtjen e makinerive, gjeneratorëve etj.</li> <li>Magazina për mbajtjen e naftës/karburantit</li> <li>Planifikimi &amp; Ruajtja e rrjedhjeve të Karguranteve &amp; Kimikateve</li> <li>Procedurat për trajtimin e kimikateve</li> <li>Kiti për përgjigjen ndaj derdhjes së Naftës &amp; Kimikateve në terren.</li> <li>Trajnim i HSE i të gjithë punonjësve në terren mbi sensibilizimin mjedisor (duke përfshirë menaxhimin e erozionit dhe të depozitimeve në terren dhe menaxhimi i mbetjeve) dhe parandalimi dhe përgjigja ndaj derdhjes së naftës &amp; kimikateve. Kjo masë zvogëlimi është e vlefshme për të gjithë ndikimet.</li> </ul>

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i ujrave mbetës dhe mbetjeve të ngurta</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendore, distancat specifike në varësi të kushteve vendore Mund të jetë deri në një kilometër në pjesën e poshtme të rrjedhjes prej vendndodhjes së shkarkimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajtimi i ujrave mbetës përpara shkarkimit në ndonjë trup ujor</li> <li>• Vendosja e kantierëve dhe kampeve larg trupave ujore / rrjedhave ujore</li> <li>• Plani për menaxhimin e mbetjeve</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikimet prej shkarkimit të mbetjeve ujore që krijohen prej ndërtimit të tunelit (p.sh. ujërat e krijuar gjatë shpimeve – në varësi të metodës së përzgjedhur) dhe testi hidrik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendore, nga disa qindra metra deri në një kilometër në pjesën e poshtme të rrjedhjes. Distancat specifike varen prej kushteve vendore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhimi i mbetjeve ujore në terren (mbledhja dhe trajtimi në terren i mbetjeve ujore përpara shkarkimeve në trupat ujore ose në rrjedhat ujore).</li> <li>• Plani për menaxhimin e mbetjeve</li> <li>• Monitorimi i rrjedhave ujore / trupave ujorë – Plani i Monitorimit Mjedisor</li> <li>• Vlerësimi i burimeve ujore dhe vendndodhjet e shkarkimit</li> </ul>
Cilësia e Ajrit dhe faktorët Klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikimet prej pluhurit të krijuar prej lëvizjes së tokës, gërmimeve, lëvizjes së mjeteve, rezervave, sipërfaqeve të pashtruara etj. përgjatë korridorit të punimeve, rrugëve hyrëse, kantierëve dhe kampeve. Pjesët që do të ndoten përfshijnë popullatës rezidente, punëtorët, faunën dhe florën, kulturën, historinë, cilësinë e ujit etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendore, zakonisht në afërsi të korridorit të punimeve të tubacionit (brenda 100 m) dhe të strukturave përkatëse (rrugëve të reja, kantierëve, kampeve). Distancat specifike varen prej kushteve vendore dhe mund të arrijë deri në disa qindra metra në disa situata jo të favorshme meteorologjike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Praktika të mira të menaxhimit të zonës së ndërtimit si p.sh. mbulimi i materialeve mbetese, kufizime të shpejtësisë së makinave, hedhja e ujit mbi sipërfaqet me pluhur në kohë të thatë, mbulimi i kamionëve etj.</li> <li>• Plani menaxhimit social dhe mjedisor</li> </ul>

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimi i çlirimit të gazrave në atmosferë prej makinerive dhe mjeteve (p.sh. gjeneratorët, ekskavatorët, buldozerët, shpërthimet në terren, kamionët, makinat, kompresorët për testin hidrik etj. Pjesët që do të ndoten përfshijnë popullatën rezidente, punëtorët, faunën dhe florën, cilësinë e ujit etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, zakonisht në afërsi të korridorit të punimeve të tubacionit (brenda 100 m) dhe deri në disa qindra metra Distancat specifike varen prej kushteve vendore.</li> <li>Global- Gazrat Serrë (p.sh. CO<sub>2</sub>)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mirëmbajtja e pajisjeve dhe mjeteve</li> <li>Orientimi i lëvizjes së trafikut, lidhur me ndërtimin, larg zonave sensitive</li> <li>Trajnimi i operatorëve dhe shoferëve</li> <li>Shmangia e trafikut lidhur me ndërtimin prej zonave me popullatë të dendur ose qendrave historike</li> <li>Plani për menaxhimin e trafikut</li> <li>Përdorimi i karburanteve me nivel të ulët squfuri nëse është i disponueshëm</li> <li>Modelimi i shpërndarjes së ndotësve prej burimeve kryesore të çlirimit të gazrave (gjeneratorët, kompresorët)</li> <li>Monitorimi i burimeve kryesore të çlirimit (gjeneratorët, kompresorët) – Plani i Monitorimit Mjedisor</li> <li>Plani i menaxhimit social dhe mjedisor.</li> </ul>
Zhurmat dhe Dridhjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet nga zhurma dhe dridhja prej makinerive, makinerive të ndërtimit, shpërthimi i shkëmbinjve (nëse është e nevojshme) dhe kompresorët për testin hidro. Pjesët që do të ndoten do të përfshijnë popullatën rezidente (dhe pjesët e ndjeshme si p.sh. shkollat dhe spitalet), punëtorët, faunën, ndërtesat kulturore, historike etj)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike në varësi të kushteve dhe burimeve vendore: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mjetet e ndërtimit dhe makineritë. Zakonisht midis korridorit të punimeve (40 m) dhe deri në disa qindra metra</li> <li>Shpërthimi. Deri në 10 km.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Menaxhimi i mirë i zonës së ndërtimit.</li> <li>Kohë të kufizuara pune pranë pjesëve të ndjeshme</li> <li>Përdorimi i masave specifike për zvogelimin e zhurmave (mburojat akustike)</li> <li>Lokalizimi i pajisjeve të zhurmshme (p.sh. gjeneratorët, kompresorët) përtej zonave të ndjeshme ndaj zhurmës</li> <li>Kufizime shpejtësie për automjetet</li> <li>Pajisje e Përshtatshme për Mbrojtjen Personale (PPE) për punëtorët</li> <li>Modelimi i shpërndarjes së burimeve të çlirimeve të zhurmës (gjeneratorët, kompresorët)</li> <li>Monitorimi i burimeve kryesore të çlirimit të zhurmave (gjeneratorët, kompresorët) – Plani i Monitorimit Mjedisor</li> <li>Plani i menaxhimit social dhe mjedisor.</li> </ul>

<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Ndikimi/Burimi Potencial</b>	<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme</b>
Biodiversiteti dhe Habitatet Natyrore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet nga humbja e habitatit. Ndikimet do të jenë si të përkohshme dhe afat-gjata / përhershme. Ndikimi i përkohshëm do të krijohet nga korridori i punimeve, kampet, kantieret të cilat do të rivendosen në kushtet e para-ndërtimit pasi të jetë përfunduar ndërtimi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, korridori i punimeve (40 m) dhe gjurmët e lehtësirave shoqëruese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjurma dhe përzgjedhja e vendndodhjes së infrastrukturës përkatëse</li> <li>Teknikat alternative të ndërtimit për të hapur kanalin dhe mbushur ate (p.sh. Gërryerja me Drejtim Horizontal)</li> <li>Minimizimi i gjurmës kudo që mund të jetë e mundshme (p.sh. korridor i punimeve më i ngushtë)</li> <li>Rivendosja sipas kushteve të para ndërtimit aq sa është e mundshme (p.sh. mbjellja me bimë në korridorin e punimeve) – Plani për Restaurimin e Bimësisë / Peizazhit.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet ndaj faunës dhe llojeve të florës që duhen mbrojtur prej aktiviteteve të projektit (p.sh. zhurma, shkarkimet ujore, sasi të sedimenteve, marrja e ujit për testin hidrik, prani më e madhe njerëzore te zonat e pakalueshme më parë) gjatë ndërtimit dhe punimeve përpara ndërtimit duke iu referuar në mënyrë të veçantë zonave të ndjeshme si p.sh. vendefolezimet, pyjet e vjetër, ligatinat, lumenjtë, bimësia breglumore dhe zonat e identifikuara si të pasura me lloje të mbrojtura dhe endemike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike në varësi të burimit të ndikimit dhe kushteve vendore. Zakonisht në afërsi të korridorit të punimeve të tubacionit (40 m) dhe të strukturave përkatëse (rrugëve të reja, kantierëve, kampeve). Distancat specifike varen prej kushteve vendore dhe mund të arrijë deri në disa qindra metra në disa kushte jo të favorshme. Ndikimet mbi cilësinë e ujit dhe të habitateve ujore mund të arrijnë deri në një kilometër në varësi të ndikimit dhe kushteve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Si më sipër për cilësinë e ujit, cilësinë e ajrit, ndikimet e zhurmës dhe dridhjes</li> <li>Menaxhimi i pluhurit, çlirimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave dhe mbetjeve për të minimizuar ndikimin mbi florën, faunën dhe ekosistemet (p.sh. vendosja e makinerive të palëvizshme sa më larg që të jetë e mundshme prej habitateve të ndjeshme).</li> <li>Kufizimi i ndërtimeve gjatë periudhave të caktuara /stineve në disa zona</li> <li>Monitorimi i ndikimit mbi florën dhe faunën në vendet e ndjeshme – Plani i Monitorimit Mjedisor</li> <li>Plani i Menaxhimit Social dhe Mjedisor</li> <li>Plani i Veprimit të Biodiversitetit (PVB) për t'u hartuar për gjithë kohën e projektit. Plane Veprimi për llojet me rëndësi të veçantë (p.sh. ariu) dhe habitatet / mjediset duhet të zhvillohen.</li> <li>Zhvendosja e llojeve të rralla dhe endemike bimore pranë habitateve të përshtatshme aty pranë.</li> </ul>

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Ndikimet mbi Peizazh dhe Vizuale	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikime të përkohshme dhe të përhershme mbi peizazhin dhe vizuale prej zënies së tokës dhe strukturave mbi tokë. Ndikimet do të jenë të përkohshme për korridorin e punimeve, kampet, kantieret të cilat do të rivendosen në kushtet e para-ndërtimit pasi të jetë përfunduar ndërtimi. Seksionet me një potencial ndikimi të madh mbi peizazhin përfshinë kreshtat malore ose terrenet e ngritur dhe pyjet e vjeter dhe të maturuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike në varësi të kushteve vendore. Deri në 10 km në disa raste (Rajonale)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Minimizimi i gjurmës kudo që mund të jetë e mundshme (p.sh. korridor më ingushtë i punimeve)</li> <li>Rivendosja sipas kushteve të para ndërtimit aq sa është e mundshme (p.sh. mbjellja me bimë në korridorin e punimeve) – Plani për Restaurimin e Bimësisë / Peizazhit.</li> <li>Masa lehtësuese vizuale aty ku duket e nevojshme (stacionet e kompresorit)</li> <li>Vendndodhja e rrugëve të reja, hyrjet e përkohshme dhe kampet përtej vendeve me peizazh të ndjeshëm.</li> </ul>

*Tabela 6.2 Ndikimet e Mundshme Socio-ekonomike dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Ndërtimin në Tokë dhe Futjen në Punë*

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Zhvendosje e Prones dhe Njerëzve si dhe e aktiviteteve ekzistuese të përdorimit të tokës,	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet e përkohshme mbi përdorimin e tokës. Ndikimet e përkohshme do të krijohen prej korridorit të punimeve i cili do të kthehet në gjendjen e mëparshme pas përfundimit të aktiviteteve të ndërtimit, duke e kthyer tokën në gjendjen e përdorimit fillestar. Ndikimet mbi prodhimet vjetore do të jenë gjithashtu të përkohshme gjatë brezit të punimeve përgjatë së cilës do të rriten kultura njevjecare pas rikthimit në gjendjen fillestare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, korridori i punimeve të tubacionit (40 m) dhe të strukturave përkatëse (rrugëve të reja, kantierëve, kampeve) dhe zonave që do të zihen prej stacioneve të kompresorit, stacionet e valvolave të bllokimit dhe të strukturave të përhershme respektive.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i Planit të Veprimit të Risistemimit (RAP) për të përcaktuar se si risistemimi për përvetësimin e tokës në mënyrë të përhershme ose të përkohshme do të menaxhohet dhe të lehtësohet në linjë me Strategjinë e TAP për Përvetësimin e Tokës dhe Lehtësimin</li> <li>Zbatimi i planeve për restaurimin e tokës për të siguruar përdorimin e mëparshëm dhe kthimin të përdoruesi me përfundimin e ndërtimit.</li> </ul>
Ndikimet Socio-ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të ardhura të larta për qeverinë (p.sh. pagesat e lejeve &amp; të ndërtimit dhe taksat)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendor, Rajonal dhe Kombëtar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përfshirje e mëparshme me palët e interesuara të qeverisë kombëtare</li> </ul>

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet vendore mbi mjetet e jetesës dhe humbje të të ardhurave familjare si pasojë e punimeve për ndërtimin (p.sh. zotërim i përkohshëm dhe afatgjatë i tokës bujqësore).</li> <li>Pastrimi i terentit dhe hapja e rrugëve hyrëse në zonat malore mund të ndikojnë në mbledhjen e produkteve pyjore dhe në rritjen e bagëtive</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, korridori i punimeve të tubacionit (40 m) dhe të strukturave përkatëse (rrugëve të reja, kantierëve, kampeve) dhe zonave që do të zihen prej stacioneve të kompresorit, stacionet e valvolave të bllokimit dhe të strukturave të përhershme respektive. Breza toke dhe zona me aksesibilitet të kufizuar si rrjedhojë e prezencës së kantierëve të ndërtimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi që Plani i Veprimit të Rsisistemimit (RAP) përfshin një strategji për blerjen e tokës bazuar në kompensimin për humbjen e mjeteve të jetesës (p.sh. Plani i Rivendosjes së Mjeteve të Jetesës) siç është e shprehur në Strategjinë e TAP për Blerjen e Tokës dhe Lehtësimin</li> <li>Plani për Përfshirjen e Komunitetit (CEP) si pjesë e strategjisë së TAP të përfshirjes së palëve të interesuara</li> <li>Përfshirja e një grupi të Nëpunësve të Ndërlidhjes me Komunitetin (CLOs) për të menaxhuar dhe monitoruar marrëdhëniet e komunitetit me TAP</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përfitimet ekonomike të familjeve dhe të ekonomisë vendore si rezultat i krijimit të punëve në mënyrë të drejtë për drejtë ose jo të drejtë për drejtë gjatë punimeve të ndërtimit</li> <li>Përfitime të komunitetit dhe ekonomisë vendore si rezultat i prokurimeve vendore të materialeve për ndërtimin dhe shërbime të tjera për të mbështetur projektin</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nivelet Vendore dhe Rajonale (komunat dhe rrethet) përfitojnë prej punësimit dhe mundësive të prokurimeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i një Strategjie për Punësimin dhe Prokurimin për të siguruar maksimizimin e mundësive për banorët dhe bizneset vendorë</li> <li>Maksimizimi i punësimit vendor gjatë ndërtimit dhe ofrimi i një procesi rekrutimi të drejtë dhe transparent dhe forcimi i aftësive vendore përmes trajnimeve të ofruara nga TAP</li> <li>Deri sa e lejon mundësia, të prokurohen mallra prej furnitorëve vendore përmes nën-kontraktimit me firmat vendore (në varësi të disponueshmërisë, cilësisë dhe kostove) dhe blerja e mallrave prej shitësve me pakicë vendorë (të konfirmohet)</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prania e punëtorëve në terren gjatë punimeve të ndërtimit mund të ketë një ndikim mbi infrastrukturën sociale (ujin, energjinë elektrike, rrugët, qendrat shëndetësore)</li> <li>Ndërkohë që mund të ketë një trysni të përkohshme mbi këto infrastruktura në periudhën afat-shkurtër, mund të ketë gjithashtu një ndikim pozitiv mbi zhvillimin e infrastrukturës për periudhën afatmesme dhe afatgjatë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, zakonisht në afërsi të korridorit të punimeve së tubacionit (40 m) dhe të strukturave përkatëse (rrugëve të reja, kantierëve, kampeve) dhe zonave rreth stacioneve të kompresorit, stacionet e valvolave të bllokimit dhe të strukturave respektive.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i masave të infrastrukturës sociale për fuqinë punëtore.</li> <li>Lehtësimi i qasjes të komunitetit vendor ndaj infrastrukturave të reja, sidomos ndaj rrugëve të reja hyrëse</li> </ul>

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prania e punëtorëve në terren dhe të ardhurat që ata fitojnë dhe shpenzojnë mund të krijojnë ndryshime ndaj zakoneve dhe normave vendore.</li> <li>Ndikimet ndaj mjeteve të jetesës (p.sh. blektoria dhe kullotja) prej ndërtimit të projektit mund të kenë gjithashtu ndikim mbi institucionet sociale dhe kohezionin e komunitetit vendor duke qenë se mjetet e jetesës dhe institucionet sociale janë shpesh të lidhura me njëri-tjetrin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, zakonisht në afërsi të korridorit të punimeve së tubacionit (40 m) dhe të strukturave përkatëse (rrugëve të reja, kantierëve, kampeve) dhe zonave rreth stacioneve të kompresorit, stacioneve të valvolave të bllokimit dhe të strukturave respektive.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i Planit për Përfshirjen e Komunitetit (CEP) si pjesë e strategjisë së TAP te përfshirjes së palëve të interesuara</li> <li>Përfshirja e një grupi të Nën-punësve të Ndërlidhjes me Komunitetin (CLOs) për të menaxhuar dhe monitoruar zbatimin e kënaqshëm mbi efikasitetin e të gjithë procedurave të marrëdhënieve me komunitetin</li> <li>Zhvillimi i një Kodi Sjelljeje të Punëtorëve ku do të përfshihen masa disiplinore për ata që thyejnë kërkesat e Kodit.</li> </ul>
Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rreziqe për sigurinë e komunitetit si rezultat i punimeve ndërtimore.</li> <li>Rritje e ngarkesës së trafikut të rrugët pranë projektit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, komunitetet që aktualisht përdorin dhe jetojnë përgjatë rrugëve do të tranzitohen prej mjeteve të projektit, përfshirë dhe rrugët malore. Komunitetet përgjatë rrugëve të transportit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i një Plani për Menaxhimin e Sigurisë së Komunitetit për të trajtuar rreziqet e sigurisë së komuniteteve, përfshirë rreziqet lidhur me trafikun</li> <li>Ofrimi i trajnimeve për sensibilizimin ndaj trafikut në shkollat vendore dhe në nivel komuniteti për të rritur sensibilizimin e komuniteteve lidhur me shmangien e aksidenteve në rrugë.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Projekti ka potencialin për të pasur ndikim mbi komunitetet fqinje përmes ndryshimeve në zhurmë dhe cilësinë e ajrit, cilësinë e ujit, burimeve ujore, ndikimit viziv dhe ndryshimet në qasje (shikon më sipër), por gjithashtu përmes krijimit të ndarjeve, pengesave midis shtëpive të popullatës dhe vendeve që ata duan të vizitojnë ose që duan të shkojnë për të punuar (si p.sh. toka bujqësore dhe zonat e kullotjes së bagëtisë).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, komunitetet e vendosura në afërsi të zonës së ndërtimit (deri në 10 km në disa raste të veçanta)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet e ndarjeve/pengesave do të lehtësohen përmes masave të zëvendësimit të pikave të kalimit.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rritje e mundshme e ndodhive vendore e sëmundjeve të paraqitura dhe trysnia mbi shërbimet vendore (shëndeti, aktivitetet e kohës së lirë, policia etj.) prej forcës së punës të projektit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendor dhe Rajonal, komunitetet pranë kampeve të punëtorëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aplikimi i politikave të caktuara për menaxhimin e punëtorëve dhe masat parandaluese</li> <li>Ofrimi i ndihmës mjekësore për të gjithë forcat e punës për të shmangur barrën që mund t'u bjerë shërbimeve vendore në dëm të komunitetit vendor</li> <li>Zhvillimi i Kodit të Sjelljes që të binden punëtorët</li> </ul>

<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Ndikimi/Burimi Potencial</b>	<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendosja e forcës së punës në kampe pranë komuniteteve vendore mund të krijojë shqetësime dhe ngatërresa</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, komunitetet që jetojnë pranë (deri në 1 km) prej kampeve të punëtorëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shmangja e ngritjes së kampeve të punëtorëve pranë komuniteteve vendore</li> <li>Do të tregohet vëmendje e veçantë për vendosjen përfundimtare dhe shërbimet që i ofrohen punonjësve. TAP do të ofrojë qasje ndaj strukturave dhe shërbimeve për të ulur trysinë ndaj strukturave të komunitetit vendor (p.sh. spitalet, transporti etj.)</li> </ul>
Kushtet e Punës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrezik për dëmtime për forcën e punës si pasojë e gërmimeve të mëdha, tuneleve dhe të punimeve pranë rrugëve aktive</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, komunitetet e vendosura në afërsi të zonës së ndërtimit (deri në 200m )</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të HSE për projektin në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare. Plani HSE do të identifikojë rreziqet ndaj shëndetit të punëtorëve dhe sigurinë dhe do të përshkruajnë sistemin e menaxhimit të HSE.</li> <li>Praktika të mira të menaxhimit në terren (trajtime dhe kualifikime të punonjësve, standarde pune të mira) do të zbatohen për të ulur rreziqet e shëndetit dhe sigurisë.</li> </ul>

**Tabela 6.3** *Ndikimet e Mundshme të Trashëgimisë Kulturore dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Ndërtimin në Tokë dhe Futjen në Punë*

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Arkeologjia (e njohur dhe potenciale) dhe Trashëgimia e Krijuar përfshirë “trashëgimia kulturore e paprekshme” (ICH)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktivitete ndërtimore shqetësuese në terren duke përfshirë zënine e përkohshme dhe të përhershme (pra DGJ, korridorin e punimeve, stacionet e kompresorit, gjatësitë e tubave, kampet e forcës punëtore, portalet e tunelit, landfillet / marrja e tokës dhe qasjet).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, korridori i punimeve të tubacionit (40 m) dhe të strukturave përkatëse (rrugëve të reja, kantierëve, kampeve) dhe zonat që do të zihen prej stacioneve të kompresorit, stacionet e valvolave të bllokimit dhe të strukturave të përhershme respektive.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore (përfshirë TK Jomateriale)</li> <li>Një studim i detajuar i zbulimeve për monumentet e njohura, TK Jomateriale dhe zonat arkeologjike.</li> <li>Zbatimi i monitorimit arkeologjik dhe një procedure për “gjetjet e rastit” duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në zonat me një potencial të madh arkeologjik.</li> <li>Shmangie e ndikimeve të mundshme dhe të sigurta me ri-dizenjimin e projektit për zonat arkeologjike, monumentet dhe TK Jomateriale.</li> <li>Përdorimi i teknikave të ndërtimit me një ndikim të vogël të veçantë ku shmangja totale (p.sh. ri-rregullimi i gjurmës) nuk është e mundshme.</li> <li>Zhvendosja e gjetjeve përmes gërmimeve të shpëtimit dhe përmes studimeve respektive.</li> <li>PMMS brenda EISA për të planifikuar Planin për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore.</li> </ul>

## 6.2.2 Operimi

**Tabela 6.4** *Ndikimet e Mundshme Mjedisore dhe Masat Lehtësuese lidhur me Operimin ne Pjesen Kontinetale*

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Burimet dhe mbetjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbetjet dhe uji i mbetur i krijuar nga stacionet gjatë mirëmbajtjes. Kjo përfshin mbetjet e krijuara prej veprimtarive inspektuese (mbeturinat, llumi).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike në varësi të kushteve vendore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani për menaxhimin e mbetjeve</li> </ul>
Cilësia e Ajrit dhe faktorët Klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet nga çlirimet në ajër prej stacionit të kompresorit (turbinat)</li> <li>Aktivitete jo rutinë si p.sh ajrosja emergjente (dhe ulja e trysnisë për mirëmbajtje) te stacioni i kompresorit ose mos funksionimi i tubave përbëjnë një potencial më të lartë për të ulur cilësinë e ajrit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike varen prej kushteve vendore, zakonisht dhe mund të arrijë deri në disa qindra metra, por në disa kushte jo të favorshme mund të arrijë deri në një kilometër.</li> <li>Globale, gazrat serrë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mirëmbajtja dhe monitorimi</li> <li>Monitorimi i cilësisë së ajrit</li> <li>Vendosja e stacionit të kompresorit larg marrësve të ndjeshëm</li> <li>Adoptimi i Teknikave më të Mira të disponueshme (BAT) për uljen e ndotjes së ajrit</li> </ul>
Zhurmadhe Dridhjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimi nga krijimi i zhurmës gjatë operimit normal të stacioneve të kompresorit (p.sh. kompresorët, motorët e turbinës). Aktivitete jo rutinë si p.sh. ajrimi për arsye emergjente Receptorët që do të ndikohen përfshijnë popullatën rezidente (dhe pjesët e ndjeshme si p.sh. shkollat dhe spitalet) punëtorët, faunën, ndërtesat kulturore, historike etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike në varësi të burimit të ndikimit, kushteve vendore dhe vendndodhjes se receptorëve të ndjeshëm ndaj zhurmës dhe dridhjeve</li> <li>Zhurma e kompresorëve prej 200 m deri në më shumë se një kilometër në disa kushte meteorologjike të pafavorshme Mbi një kilometër për zhurmën e krijuar gjatë ajrimit të emergjencës (zakonisht për periudha të shkurtra kohe).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mirëmbajtja dhe monitorimi</li> <li>Monitorimi i nivelit të zhurmës</li> <li>Vendosja e stacionit të kompresorit larg marrësve të ndjeshëm</li> <li>Modelimi i shpërndarjes së burimeve të zhurmës (gjeneratorët, kompresorët)</li> <li>Monitorimi i burimeve kryesore të zhurmës (gjeneratorët, kompresorët) – Plani i Monitorimit Mjedisor</li> <li>Përdorimi i pajisjeve të veçanta për zvogelimin e zhurmshme (mburojat akustike)</li> <li>Lokalizimi i pajisjeve të zhurmshme (kompresorët) larg zonave të ndjeshme ndaj zhurmës</li> </ul>

<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Ndikimi/Burimi Potencial</b>	<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme</b>
Biodiversiteti dhe Ruatja e Natyres	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimi në fauna prej zhurmës se prodhuar nga stacionet e kompresorëve</li> <li>Ndikimi mbi faunën dhe florën prej mirëmbajtjes / pastrimit rutinë të korridorit të brendshëm të sigurisë (maksimum 10 m i gjerë) ku nuk do të lejohet një bimësi me rrënjë të thella për të shmangur ndërhyrjen me tubacionin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, DGJ (20 m) prej 200 m deri në më shumë se një kilometër në disa kushte jo të favorshme meteorologjike përreth stacioneve të kompresorit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhurmat, si më sipër</li> <li>Rivendosja sipas kushteve të para ndërtimit sa më larg që të jetë e mundshme (p.sh. mbjellja me bimë në korridorin e punimeve) dhe mirëmbajtja ebimësisë – Plani për Restaurimin e Bimësisë / Peizazhit.</li> <li>Monitorimi i ndikimit mbi florën dhe faunën në vendet e ndjeshme</li> <li>Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social Plani i Veprimit të Biodiversitetit (PVB) për t'u hartuar për gjithë kohën e projektit. Të zhvillohen Plane Veprimi për llojet me rëndësi të veçantë (p.sh. ariu) dhe habitatet / mjediset.</li> </ul>
Ndikimet mbi Peizazh dhe Vizuale	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet mbi peizazhin lidhur me zenien e përhershme të tokës për stacionet e kompresorit dhe të stacioneve të valvolave të bllokimit</li> <li>Ndikimi mbi peizazh prej mirëmbajtjes rutinë te DGJ</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, DGJ (20 m) dhe qasje për pastrimet e mirëmbajtjes, distanca të tjera specifike lidhur me strukturat e përhershme (stacionet e valvolave të bllokimit dhe të kompresorit) në varësi të kushteve vendore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shikoni më sipër</li> <li>Plani për Restaurimin e Bimësisë / Peizazhit duhet të tregojë vëmendje të veçantë për zonat me shikueshmëri të madhe ose aty ku duhet te zbatohen teknika për ri-vendosjen e bimësisë (p.sh. teknika për stabilizimin e shpatit në shpatet malore)</li> </ul>

**Tabela 6.5** *Ndikimet e Mundshme Socio-ekonomike dhe Masat Zbutëse lidhur me Operimin në Pjesën Kontinentale*

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Zhvendosje e Perdorimeve ekzistuese te Tokës, , Prones dhe Njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Marrja e përhershme e tokës / lehtësimet gjatë operimit</li> <li>Ndryshime të përhershme të përdorimit të tokës në toka të veçanta bujqësore për prodhimin e përhershëm (p.sh. pemë ulliri, pemët frutore, vreshtat).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, DGJ (20 m) dhe zonat që do të zihen prej stacioneve të kompresorit dhe struktura të tjera të përhershme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i një Plani Veprimi për Rivendosjen e Mjeteve të Jetesës / Strehimit i cili përcakton se si do të menaxhohet dhe lehtësohet strehimi në rast marrje të përhershme të tokës gjatë operimit dhe nxjerrjes nga përdorimi te gazsjellësit.</li> <li>Zbatimi i planeve për restaurimin e tokës për të siguruar përdorimin e mëparshëm dhe kthimin te përdoruesi pas përfundimit të veprimtarisë së projektit.</li> <li>Zhvillimi i Planit për Përfshirjen e Komunitetit (CEP) si pjesë e strategjisë së TAP e përfshirjes së palëve të interesuara</li> <li>Përfshirja e një grupi të Nëpunësve të Ndërlidhjes me Komunitetin (CLOs) për të menaxhuar dhe monitoruar marrëdhëniet e komunitetit të TAP dhe plani i restaurimit.</li> </ul>
Ndikimet Socio-ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtim i të ardhurave të qeverisë si rezultat i tarifave mbi transportin e gazit.</li> </ul>	Kombëtar, Rajonal	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përfitimet ekonomike të familjeve dhe të ekonomisë vendore si rezultat i krijimit të punëve në mënyrë të drejtë për drejtë ose jo të drejtë për drejtë gjatë punimeve (p.sh. stacionet e kompresorëve)</li> <li>Përfitime e komunitetit dhe ekonomise vendor si rezultat i prokurimeve vendore të materialeve për mirëmbajtje dhe shërbime të tjera</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nivelet Vendore dhe Rajonale (komunat, bashkitë dhe rrethet) përfitojnë prej punësimit dhe mundësive të prokurimeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i një Strategjie për Punësimin dhe Prokurimin për të siguruar maksimizimin e mundësive për banorët dhe bizneset vendore.</li> <li>Maksimizimi i punësimit vendor gjatë ndërtimit dhe ofrimi i një procesi rekrutimi të drejtë dhe transparent dhe forcimi i aftësive vendore përmes trajnimeve të ofruara nga TAP</li> <li>Deri sa e lejon mundësia, të prokurohen mallra prej furnitorëve vendore përmes nën-kontraktimit me firmat vendore (në varësi të disponueshmërisë, cilësisë dhe kostove) dhe blerja e mallrave prej shitësve vendorë me pakicë</li> </ul>

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kufizimi i përdorimit të tokës për arsye sigurie (ndërtimi i strukturave të përhershme dhe gjysmë të përhershme si p.sh. serat, infrastrukurat)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për të siguruar integritetin e tubacionit, ndërtimi i shtëpive do të jetë i kufizuar në një korridor prej maksimalisht 60 m dhe po ashtu ndërtimi i zonave të shtëpive dhe/ose infrastrukturës industriale në një korridor maksimal prej 200 m.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjurma e preferuar u përzgjedh për të akomoduar kriteret e sigurisë (shihni zonën e influencës) dhe lejon mjaftueshëm hapësirë gjithashtu dhe për zhvillimet e ardhshme të komuniteteve përreth.</li> </ul>
Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrreziqet e sigurisë për komunitetet si rezultat i aktiviteteve të zbatimit të projektit, sidomos ato të lidhura me veprimet e trafikut.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, komunitetet që aktualisht përdorin dhe jetojnë përgjatë rrugëve do të transportohen prej mjetet e projektit, përfshirë dhe rrugët malore. Komunitetet përgjatë rrugëve të transportit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i një Plani për Menaxhimin e Sigurisë së komunitetit për të trajtuar rreziqet e sigurisë së komuniteteve, përfshirë rreziqet lidhur me trafikun</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Projekti ka mundësi të ndikojëmbi komunitetet fqinje përmes ndryshimeve në nivelin e zhurmave dhe cilësinë e ajrit, ndikimit pamor dhe ndryshimet në qasje (shikon më sipër), por gjithashtu përmes krijimit të ndarjeve/pengesave midis shtëpive të popullatës dhe vendeve që ata duan të vizitojnë ose që duan të shkojnë për të punuar (si p.sh. toka bujqësore dhe zonat e kullotjes së bagëtisë).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, komunitetet e vendosura pranë tubacionit dhe rreth infrastrukturës së projektit si p.sh. stacione e kompresorit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet e ndarjeve/pengesave do të lehtësohen përmes masave të zëvendësimit të pikave të kalimit.</li> </ul>
Kushtet e Punës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rreziku për dëmtime në forcën e punës si rezultat i veprimeve rutinë të projektit, si mirëmbajtja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, komunitetet që aktualisht përdorin dhe jetojnë përgjatë rrugëve do të transportohen me mjetet e projektit, përfshirë dhe rrugët malore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të HSE për projektin në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare. Plani HSE do të identifikojë rreziqet ndaj shëndetit të punëtorëve dhe sigurisë dhe do të përshkruajnë sistemin e menaxhimit të HSE.</li> <li>Praktika të mira të menaxhimit në terren (trajtime dhe kualifikime të punonjësve, standarde pune të mira) do të zbatohen për të ulur rreziqet e shëndetit dhe sigurisë.</li> </ul>

**Tabela 6.6** *Ndikimet e Mundshme mbi Trashëgiminë Kulturore dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Operimin në Pjesën Kontinentale dhe Nxjerrjen nga Përdorimi te Gaz-sjellesit*

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Arkeologjia (e njohur dhe potenciale) dhe Trashëgimia e Krijuar përfshirë “trashëgimia kulturore e jomateriale” (ICH)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk pritet ndonjë ndikim specifik ose rrezik gjatë operacioneve (marrja e tokës dhe punimet në tokë të kufizuara gjatë fazës së ndërimit)</li> <li>Heqja e dherave dhe veprimet e restaurimit gjatë fazës së nxjerrjes nga përdorimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, DGJ (20) gjurmët e aktiviteteve të lidhura me nxjerrjen nga përdorimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore (përfshirë TK Jomateriale)</li> </ul>

### 6.3 PJESA DETARE

**Tabela 6.7 Ndikimet e Mundshme të Trashëgimisë Kulturore, socio-ekonomike dhe Mjedisore dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Ndërtimin në Det**

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Burimet dhe mbetjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Konsumimi i karburantit prej anijeve dhe makinerive</li> <li>Menaxhimi i kanalizimeve (ujërat e zeza dhe gri) dhe i shkarkimeve .</li> <li>Krijimi dhe hedhja e mbetjeve të ngurta</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nga Vendore në Kombëtare, në varësi të ndikimit dhe vendit specifik të hedhjes së mbeturinave dhe origjinës së materialeve ndërtimore dhe karburantit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Operim sipas standardeve ndërkombëtare (MARPOL)</li> <li>Mirëmbajtja dhe monitorimi</li> <li>Planet për menaxhimin e mbetjeve</li> </ul>
Fundi i Detit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndryshim i përkohshëm dhe i përhershëm i fundit të detit ku mund të kërkohen hapja e kanaleve ose ndërhyrje të tjera</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, gjurmë të punimeve ndërhyrëse, zakonisht deri në 40 m</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjurma e tubacionit</li> <li>Projektimi dhe menaxhimi i ndërtimit për të minimizuar ndryshimin e fundit detar</li> </ul>
Cilësia e Ujit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ngacmimi i sedimenteve (ka mundësi që të ketë ndotës) krijojnë faktorë pengues ose efekte të tjera demtuese për organizmat bentike dhe peshqit</li> <li>Shkarkimet e ujërave të mbetura gjatë veprimeve të anijeve</li> <li>Shkarkimi e ujrave prej testit hidrik</li> <li>Derdhje të mundshme të naftës ose rrjedhje prej makinerive dhe anijeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike në varësi të kushteve vendore. Zakonisht deri në disa qindra metra, por mund të jetë deri në disa kilometra si rezultat i kushteve jo të favorshme meteorologjike (p.sh. korrente të forta).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Veprim sipas standardeve ndërkombëtare (MARPOL)</li> <li>Procedurat e depozitimit</li> <li>Planifikimi &amp; Ruajtja e Rrjedhjeve të Karguranteve &amp; Kimikateve</li> <li>Projektimi dhe menaxhimi i ndërtimit</li> <li>Zgjidhje teknike për të minimizuar ngacmimin e sedimeveve p.sh. kova të mbyllura të ekskavatorit për anijet për të gërmuar, ndarje e baltrave (nëse është e nevojshme)</li> <li>Përdorimi i ujit të patrajtuar për testin hidrik</li> <li>Përdorimi i difuzorëve për shkarkimet e testit hidrik</li> </ul>
Cilësia e Ajrit dhe faktorët Klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tymrat e çliruar prej anijeve dhe makinerive</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike varen prej kushteve vendore, zakonisht, dhe mund të arrijë deri në disa qindra metra, por në disa kushte jo të favorshme mund të arrijë deri në një kilometër.</li> <li>Globale, gazrat serrë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mirëmbajtja dhe monitorimi</li> </ul>

<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Ndikimi/Burimi Potencial</b>	<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme</b>
Biodiversiteti dhe Ruajtja e Natyres	<ul style="list-style-type: none"> <li>Efekte direkte mbi habitatet bregdetare / të fundit të detit / komuniteteve përgjatë gjurmës së tubacionit gjatë ndërtimit (p.sh. gërryerjet, kanalet, instalimi i tubacionit, gërmimet, përdorimi i varkave dhe spirancave).</li> <li>Ndikime jo të drejperdrejta të sedimenteve të ngacmuara (turbullirat, ulje e penetrimit të dritës) dhe shkarkimeve të testit hidrik dhe të ujrave mbetes..</li> <li>Shqetësim i faunës bregdetare (shpendët)</li> <li>Krijimi i zhurmës nën ujë</li> <li>Derdhje aksidentale e kimikateve, karburanteve</li> <li>Lloje pushtuese të huaja prej anijeve të ndërtimit (p.sh. të sjella gjatë shkarkimit të ujit të zhavorrit)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, gjurma e punimeve ndërhyrëse, distancat specifike të tjera në varësi të burimit të ndikimit dhe kushteve vendore. <ul style="list-style-type: none"> <li>krijimi i pezullive të sedimentit, shkarkime të ujrave të testit hidrik: zakonisht, dhjetëra deri në qindra metra. Në disa kushte të pafavorshme, mund të arrijë deri në disa kilometra;</li> <li>Ndikimet e zhurmës nën-ujë mbi faunën. Distanca të ndryshme në varësi të burimeve (p.sh. lloji i anijes / aktiviteti), llojet dhe vendndodhja. Zakonisht, dhjetëra deri në qindra metra, por në disa kushte të përkohshme të pafavorshme, mund të arrijë deri në disa kilometra për disa lloje të cilat janë veçanërisht të ndjeshme</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shmangie e habitateve detare të ndjeshme (p.sh. zhvendosje e gjurmës së tubacionit).</li> <li>Planifikimi &amp; Ruajtja e Rrjedhjeve të Karburanteve &amp; Kimikateve</li> <li>Projektimi dhe menaxhimi i ndërtimit</li> <li>Zgjidhje teknike për të minimizuar krijimin e turbullirave të sedimenteve p.sh. kova të mbyllura të ekskavatorit për anijet për të gërmuar, ndarje e baltrave (nëse është e nevojshme)</li> <li>Përdorimi i ujit të patrajtuar për testin hidrik</li> <li>Përdorimi i difuzorëve për shkarkimet e testit hidrik</li> <li>Vlerësim i vendndodhjes së shkarkimit të ujit të testit hidrik</li> <li>Faza sezonale e punimeve</li> <li>Operim sipas standardeve ndërkombëtare (MARPOL)</li> </ul>
Ndikimet Socio-Ekonomike dhe të Sigurisë e Shëndetit të komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtim i të ardhurave të qeverisë si rezultat i tarifave mbi transportin.</li> <li>Ndalim i përkohshëm i trafikut të anijeve</li> <li>Kufizime të përkohshme ndaj varkave të peshkimit për tregti</li> <li>Rrezik i mundshëm i përplasjeve me përdorues të tjerë të detit, ose ndërhyrje me përdorues të tjerë, të cilat mund të përfshijnë edhe çështje sigurie</li> <li>Ndalim i përkohshëm i aktiviteteve turistike</li> <li>Efektet indirekte prej aktiviteteve të ndërtimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nga vendor në kombëtar, në varësi të origjinës së elementit potencial të ndikuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Atje ku është e mundur të minimizohen ndikimet ndaj peshkimit / zonave të flotës detare përmes zhvendosjes së gjurmës vendore)</li> <li>Informacion për autoritetet / peshkatarët / marinën Paralajmërimi lundrimi</li> <li>Dritat, komunikimi me radio dhe pajisje të tjera sigurie</li> <li>Përfshirja e palëve të interesuara, kompensim i mundshëm</li> </ul>

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Arkeologjia dhe Trashëgimia e Krijuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dëmtime të drejt për drejta fizike p.sh. prej shtrimit të tubacionit, gërmimit, ankorimit ose gërryerjes)</li> <li>Efektet indirekte (p.sh. përmes vendosjes së shkëmbinjve ose gërryerjes, respektivisht) të cilat çojnë në dëmtim, humbje, ose humbje të qasjes ndaj trashëgimisë kulturore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, gjurmë të ndërhyrjes, distanca të tjera specifike që varen nga kushtet vendore, zakonisht jo më shumë se disa qindra metra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore (përfshirë ICH)</li> <li>Studim i detajuar i gjurmës</li> <li>Zbatim i monitorimit arkeologjik dhe një procedurë për “shansin e gjetjeve”</li> <li>Përdorimi i teknikave të veçanta të ndërtimit me një ndikim të vogël, ku shmangia totale (p.sh. zhvendosja e gjurmës/gjurmës) nuk është e mundshme.</li> <li>Largimi i sigurve i objektit arkeologjik përmes gërmimeve të shpëtimit dhe përmes studimeve respektive.</li> <li>PMMS brenda VNMS për të planifikuar Planin për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore.</li> </ul>

**Tabela 6.8** *Ndikimet e Mundshme të Trashëgimisë Kulturore, Socio-Ekonomike dhe Mjedisore dhe Masat Lehtësuese Lidhur me Operimin në Det*

Zona e Ndikimit	Ndikimi/Burimi Potencial	Zona e Ndikimit	Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme
Burimet dhe mbetjet , cilësia e ujit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi dhe hedhja e mbetjeve të ngurta (aktivitete të mirëmbajtjes së tubacionit)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prej Vendor në Kombëtar, në varësi të ndikimit dhe të vendndodhjes specifike të hedhjes së mbeturinave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mirëmbajtja dhe monitorimi</li> <li>Planet për menaxhimin e mbetjeve</li> </ul>
Biodiversiteti dhe Ruajtja e Natyres	<ul style="list-style-type: none"> <li>Modifikimi i hidrodinamikës, me efektet pasuese mbi karakteristikat e fundit të detit, shpërndarjen dhe abondancën e organizmave</li> <li>Krijimi strukturave artificiale të përhershme (p.sh. tubacioni, strukturat lidhese në det, armatura shkëmbore,, dyshekët prej betoni) mbi fundin e detit, që shpien drejt kolonizimit prej epifaunës (përfshirë dhe mundësinë për llojet pushtuese)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendore, distancat specifike që varen nga kushtet vendore, zakonisht brenda disa dhjetëra metrave prej tubacionit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mirëmbajtja dhe monitorimi</li> <li>Planet për menaxhimin e mbetjeve</li> </ul>

<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Ndikimi/Burimi Potencial</b>	<b>Zona e Ndikimit</b>	<b>Masat parandaluese/lehtësuese të mundshme</b>
Ndikimet Socio-ekonomike dhe Ndikimet Shëndetësore dhe të Sigurisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërveprimi me rrjetat e peshkimit dhe rreziku ndaj varkave të peshkimit nëse tubacioni ekspozohet ose krijohen vrima në tubacion;</li> <li>Ndikimi në ankorimin e anijeve, ankorimi i emergjencës ose ankorimi i dragave në afërsi të tubacionit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendor në Kombëtar ose Ndërkombëtar në varësi të origjinës së anijes së peshkimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Monitorimi/mbikëqyrja e tubacionit</li> <li>Marrëveshjet për kompensimin e dëtimeve të vërtetuara</li> </ul>
Integriteti i Tubacionit / Rreziqet Gjeologjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktiviteti sizmik, gabimet, gjendja jo e qëndrueshme e shpateve të cilat përbëjnë një rrezikshmëri për integritetin e tubacionit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendor ose Rajonal, në varësi të kohëzgjatjes së aktivitetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Studimet për hartimin e sigurisë.</li> <li>Zgjedhja e kujdeseshme e gjurmës (gjatë fazës së pezgjedhjes të gjurmës së tubacionit)</li> </ul>
Trashëgimia Arkeologjike dhe e Ndërtuar/Krijuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>Modifikimi i hidrodinamikës, me ndikimet pasuese lidhur me karakteristikat e fundit të detit, ekspozimi dhe demtimi i shfaqjen e gjetjeve arkeologjike si p.sh. rrënojat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vendor, distanca specifike në varësi të kushteve vendore, zakonisht jo më shumë se disa qindra metra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shvendosja e gjurmës/transesë, shpetimi i objektit arkeologjik</li> </ul>

Vlerësimi paraprak i prezantuar në tabelën e mësipërme është bazuar në informacionin e projektit i cili është aktualisht i disponueshëm, informacionin bazë të mbledhur deri në këtë moment dhe eksperiencën e fituar në projekte të tilla me kontekst mjedisor dhe socio-ekonomik.

Mundësia, madhësia dhe rëndësia e ndikimit do të vlerësohet më tej në VNMS e detajuar. Megjithatë vlerësimi paraprak nxjerr në pah se ndikimet e ndërtimit të një tubacioni dhe të strukturave përkatëse janë në mënyrë tipike të një natyre të përkohshme dhe të vendorizuara. Ato përfshijnë zhurmat e përkohshme dhe shkarkimet ne ajer te makinave ndërtuese, ndikimin mbi përdorimin e tokës, humbjen/shqetësimin e habitatit natyror (flora dhe fauna), peizazhin dhe ndikimet e përkohshme mbi cilësinë e ujit dhe të habitateve ujore gjatë kalimeve të lumenjve dhe gjatë punimeve ne det pranë bregut. Madhësia dhe rëndësia e ndikimeve ndërtimore do të varen praj kushteve vendore. Zakonisht ndikimet e ndërtimeve mund të menaxhohen dhe zbuten me efikasitet.

Tubacioni në pjesen kontinentale do të mbulohet dhe toka do të ri-vendoset si në gjendjen përpara ndërtimit. Kufizimet kryesore për përdorimin e tokës mbi tubacion do të prekin një korridor të ngushtë, maksimalisht 10 m të gjerë, në të cilin do të kufizohet rritja e pemëve me rrënjë të thella, një korridor maksimalisht 60 m, në të cilin ndërtimi i shtëpive do të kufizohet dhe një korridor prej maksimum 200 m, në të cilin krijimi i lagjeve të shtëpive dhe/ose i infrastrukturës industriale do të jetë i kufizuar. Gjurma e preferuar u përzgjedh duke marrë në konsideratë këto kritere dhe ajo krijon gjithashtu hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e ardhshëm të komuniteteve përreth. Vënia në punë e stacionit të kompresorit do të shoqërohet me çlirime në ajër dhe me zhurmë dhe do të ketë një ndikim mbi peizazhin. Madhësia dhe rëndësia e këtyre ndikimeve janë të krahasueshme me ato të termocentraleve të vegjël të gazit të bashkëprodhimit. Praktika e mirë dhe masat lehtësuese do të adoptohen për të minimizuar ndikimet operacionale. Ndikimet ne peizazh do të menaxhohen përmes rivendosjes së peizazhit origjinal përgjatë gjurmës së tubacionit dhe përmes perzgjedhjes së vegjetacionit të strukturave të përhershme, aty ku kërkohet.

## 7.1

*HYRJA*

Një rezultat i rëndësishëm i procesit të studimit është përcaktimi i Termave të Referencës (apo TeR) të studimit të detajuar VNMS. Gjetjet e studimit VNMS do të paraqiten në një raport të VNMS (ose raport të VNM në përputhje me rregulloret shqiptare), i cili do të jetë i përgatitur në përputhje me standardet dhe rregulloret kombëtare shqiptare, si dhe standardet ndërkombëtare. Si për të gjitha hapat e mëparshëm për VNMS të kryera nga TAP (Vlerësimi i gjurmeve Alternative dhe i raportit “scoping”) TAP ka zgjedhur si pikë referimi Standardet më të rrepta të BERZH dhe standardet ndërkombëtare për raportin e VNMS.

Seksionet në vijim paraqesin Termat e Referencës të VNMS të detajuar që do të kryhet për TAP. Raporti është strukturuar si vijon:

- Përmbledhje e aktiviteteve për të përfunduar procesin e VNMS;
- Studimet e specialisteve;
- Angazhimi i palëve të interesit;
- Skica e strukturës për raportin përfundimtar VNMS; dhe
- Afatet paraprake për procesin e VNMS.

## 7.2

*OBJEKTIVAT E VNMS*

TAP pranon se planifikimi gjithëpërfshirës dhe menaxhimi i çështjeve mjedisore dhe socio-ekonomike janë thelbësore për ekzekutimin e çdo projekti të suksesshëm dhe, për këtë arsye, ai ka për qëllim të integrojë plotësisht konsideratat mjedisore dhe socio-ekonomike në ciklin e jetës së Projektit të propozuar.

Për të mbështetur këtë, TAP do të autorizojë kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (më poshtë të referuar si VNMS) të detajuar, të integruar, në përputhje me kërkesat Shqiptare të mëposhtme:

- Ligji Nr. 8990 për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (23 Janar 2003)

Përveç kësaj, VNMS do përgatitet në përputhje me Politikën e Mjedisore dhe Sociale (2008) të BERZH-it, duke përfshirë Kërkesat e Performancës (KP).

Qëllimi i VNMS është për të vlerësuar ndikimet e mundshme të projektit dhe aktivitetet e lidhura me projektin në mjedis (duke përfshirë edhe resurset bio-fizike dhe socio-ekonomike) dhe, kur është e zbatueshme, për të hartuar zbutjen ose zgjerimin e masave për të shmangur, eliminuar ose ulur ndikimet negative për mjedisin.

Në vijim të fazës Para-Studimore “Scoping” të projektit, VNMS do të:

- Ri-freskojë dhe finalizjë përshkrimin teknik të projektit pasi detaje të tjera inxhinierike të bëhen të disponueshme, duke punuar ngushtë me inxhinierët e projektit për të konfirmuar të dhëna të tilla si paraqitjen e përfundimtare të objekteve të lidhura me projektin (në veçanti stacionet e kompresionit dhe stacionet e bllokimit të valvolave), vend-ndodhjet përfundimtare dhe paraqitjen e infrastrukturave të përkohshme (vendet e vendosjes së tubave dhe kampet e punëtorëve), dhe planet e ndërtimit dhe operimit;
- Kryejë konsultime të tjera dhe të përsosë më tej qëllimin e VNMS si nevojshmëri;
- Mbledhë të dhëna të tjera bazë përmes kërkimeve nga zyra dhe studimeve në terren për të përfunduar një përshkrim të plotë të kushteve mjedisore, të trashëgimisë kulturore, dhe sociale;
- Zhvillojë masa lehtësuese dhe përmirësuese dhe të përshkruajë një Plan Menaxhimi Mjedisor dhe Social i (PMMS) duke përfshirë një përfaqje për monitorim;
- Raporti i gjetjeve në një raport të plotë VNMS.

#### *STUDIMET E SPECIALISTËVE*

Për të zhvilluar një te kuptuar të plotë të kushteve ekzistuese mjedisore, sociale dhe të trashëgimisë kulturore (burimet dhe receptorët) në zonën e ndikimit të projektit, do të kryhen më tej studime nga zyra, bibliografike dhe në terren, sikurse është përmbledhur në *Shtojcën D*. Çdo studim i modeluar i nevojshëm për vlerësimin e ndikimeve në VNMS dhe një afat i përafërt i aktiviteteve është raportuar në *Shtojcën D*.

##### *Studimet nga Zyra*

Studimet nga zyra do të përfshijnë kërkime të tjera shitesë për të identifikuar dokumentacionin ekzistues që përmban informata relevante për resurset kryesore të pranishëm në mjedisin e projektit. Burimet e mundshme përfshijnë literaturë të disponueshme publikisht me rëndësi për vendndodhjen e projektit dhe zonen në përgjithshsi.

Së fundi, studimet inxhinierike të projektit do të shqyrtohen për të dhëna sasiore mbi elementet e mjedisit. Studimet që mund të ofrojnë të dhëna të dobishme do të përfshijnë hulumtimet gjeoteknike, investigimet batimetrik dhe të fundit të detit, investigime mbi procesin dhe operimin e burimeve ujore, studime të kullimit të ujrave sipërfaqësore, studime të emetimit të gazrave dhe çdo studim tjetër me rëndësi.

*Studime të Planifikuara*

Të dhënat primare do të mblidhen nga studimet në terren që do të kryen nga specialistë të mjedisit, socio-ekonomik dhe të trashëgimisë kulturore. Do të përdoren specialistë me kualifikime në fusha të veçanta dhe me njohuri të kushteve vendore. Do të përdoren specialistë ndërkombëtare për të siguruar udhëzime teknike dhe garantuar cilësinë.

*Përcaktime të Variacioneve Sezonale*

Për projektin e TAP mostrat primare do të mblidhen midis pranverës dhe verës. Brenda këtij afati kohor, për çdo burim të veçantë, përzgjedhja e periudhës së marrjes së mostrave të veçanta do të marrë në konsideratë:

- kur marrja e mostrave do të jetë më përfaqësuese e kushteve ekzistuese;
- kur ekzistojnë kushtet “e rastit më të keq”, (p.sh. kur nivelet e zhurmave janë më të larta, kur nivelet e trafikut janë më të rënda), dhe
- në qoftë se variacionet sezonale do të kenë efekt të rëndësishëm në përcaktimin e ndikimeve të mundshme dhe të rëndësisë së tyre

Ku është relevante dhe e nevojshme, do të kryhen vezhgime të veçanta në vjeshtë dhe do të përfshihen në versionin përfundimtar të VNMS

Specialistët do të adaptojnë metodologji të mostrave të akredituara dhe të njohura shkencërisht.

***ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT***

Me përfundimin e konsultimit fillestar për fazën para-studimore “scoping” dhe paraqitjes së saj, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- Konsultimi i kushteve bazë;
- Paraqitja dhe konsultimet mbi raportin e VNMS.

***Konsultimi i kushteve bazë***

Angazhimi në aktivitetet e kryera më vonë në fazën e studimit VNMS përfshin konsultimet e planifikuara për të informuar aktorët vendorë mbi hartimin e projektit, për të marrë shqetësimet e tyre kryesore dhe çështjet me rëndësi të lartë dhe për të informuar zhvillimin e masave lehtësuese për projektin. Këto konsultime do të mundësojnë ekipin e VNMS të përsosin analizat e VNMS duke gjeneruar reagime plotësuese për përmbushjen e VNMS, çështjet kyçe dhe analizat e ndikimeve të mundshme (të tilla si vlerësimi relativ i rëndësisë së tyre).

Konsultimi do të kryhet me udhëheqësit e komuniteteve vendore dhe grupe të vogla të aktorëve kyç në komunitetet e afërta. Këto do të ndërmerren së bashku me studimin social mbi gjendjen bazë që do të kryhet për të kuptuar më mirë këta aktorë.

Drafti i VNMS do të prezantohet publikisht dhe do të mblidhen komente dhe sugjerime nga grupet e interesit dhe publiku. Prezantimi dhe konsultimet do të organizohen në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit. Do të ftohen të gjitha nivelet administrative nga rajoni te komunat, përfaqësuesit e fshatrave dhe komunitetet vendore, OJQ dhe palët e tjera të interesuara që të angazhohen në proces.

Njoftimi për seancat publike do të shpallet nëpërmjet mediave dhe këto seanca do të jenë të hapura për publikun. Pas 30 ditëve nga njoftimi dhe pas prezantimit të raportit të VNMS, TAP do të organizojë seanca publike (datat dhe vendet do të identifikohen dhe do të njoftohen).

Komentet dhe sugjerimet e seancave publike do të merren parasysh në raportin final të VNMS.

Një përmbledhje të përmbajtjes së propozuar të raportit VNMS është dhënë në Tabelën 7.1. Përmbajtja mund të ndryshohet gjatë evolucionit të projektit ose duke u bazuar në gjetjet e konsultimeve të vazhdueshme, gjithsesi është parashikuar që përmbajtja e raportit VNMS do të akordohet gjerësisht brenda kuadrit të sygjeruar.

**Tabela 7.1** *Struktura e Sygjeruar e Raportit VNM*

<i>Numri i Kapitullit</i>	<i>Titujt kryesore</i>	<i>Shënime Shpjeguese</i>
Parathenie		Titulli, falenderimet, autorët dhe bashkëpunëtorët, tabela e përmbajtjes (duke përfshirë listat e figurave, tabelave, dhe hartave)
Përmbledhje Ekzekutive		Përmbledhje e të tërë raportit VNMS.
1	Hyrja	Ky kapitull do të përshkruajë zhvillimin dhe strukturën e raportit VNMS duke përfshirë bekgrounindin, fushëveprimi, termat e referencës dhe deklaratën.
2	Justifikimi i projektit	Ky kapitull do të përfshijë diskutimin e bekgroundit të projektit, objektivat, nevoja për projektin, vlerën e projektit, qëndrueshmërinë e parashikuar, alternativat e konsideruara (duke mospërfshirë asnjë alternativë tjetër të projektit), mundësitë e zhvillimit të konsideruara dhe zgjedhjen e vendit.
3	Korniza Ligjore dhe Politikave	Ky kapitull do të përshkruajë, kornizën ligjore dhe të politikave institucionale brenda të cilit VNMS është kryer. Rregulloret kombëtare do të përmbledhen së bashku me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dhe konventat, në të cilat Shqipëria është palë, si dhe udhëzimet të zbatueshme ndërkombëtare të praktikës më të mirë dhe standardet e projektit.
4	Përshkrimi i projektit	Ky kapitull do të sigurojë një përshkrim konciz të projektit dhe kontekstin e tij geografik dhe kohor. Ai do të përfshijë një përshkrim të terrenit, një vështrim të përgjithshëm të projektit të hartuar të tubacionit dhe detaje të inputeve dhe rezultateve të projektit.

<i>Numri i Kapitullit</i>	<i>Titujt kryesore</i>	<i>Shënime Shpjeguese</i>
4	Përshkrimi i Mjedisit	Ky kapitull do të përmbledhë të dhënat bazë të disponueshme të burimeve mjedisore dhe sociale dhe receptorët në kuadër të Zonës Studimit të Projektit. Ai do të jetë i bazuar si në burime të të dhënave primare ashtu edhe sekondare dhe do të marrë në konsideratë ndryshimet në gjendjen bazë pa ndikimin nga zhvillimi i projektit TAP.
5	Konsultimet dhe Paraqitja	Ky kapitull do të paraqesë rezultatet e konsultimit të ndërmarra si pjesë e VNMS, plus planet për konsultim në të ardhmen. Ai do të identifikojë aktorët kryesorë të projektit dhe do të paraqesë reagimet e tyre mbi Projektin e TAP.
6	Ndikimet shoqeruese dhe Potenciale	Ky kapitull do të përmbledhë ndikimet pozitive dhe negative të parashikuara të projektit. Ndikimet kumulative do të vlerësohen në mënyrën më të përshtatshme.
7	Zbutja dhe ndikimet mbetëse	Ky kapitull do të përshkruajë masat e përgjithshme dhe specifike për të reduktuar, lehtësuar, hequr apo shmangur ndikimet negative në receptorët mjedisore dhe sociale. Cdo ndikim i mbetur (edhe pas masave zbutëse) do të përshkruhet.
8	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS)	PMMS do të mbledhë së bashku me masat e mundshme zbutëse; do të grupojë ato logjikisht në komponentë me tematika të përbashkëta; do të përcaktojë veprimet specifike të kërkuara dhe afatin për realizimin e tyre; do të identifikojë nevojat për trajnim, rolet dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin dhe do të vlerësojë kostot e ë masave zbutëse.
9	Konkluzionet	Ky kapitull do të përmbledhë përfundimet që janë bërë në bazë të vlerësimit, si dhe do të përshkruajë rekomandimet e mëtejshme.
	<i>Bibliografia dhe Referencat</i>	Të gjitha referencat e bëra në raport dhe dokumentet e hartuara gjatë ecurisë së vlerësimit.
	<i>Anekset</i>	Këto do të përfshijnë anekset teknike me detajet e vrojtimeve specifike teknike, bibliografinë dhe listat e shkurtesave.

Një plan paraprak për VNMS është dhënë në *Tabelën 7.2* më poshtë.

**Tabela 7.2** *Kalendari për VNMS dhe Konsultimet me Grupet e Interesit*

<b>Aktiviteti</b>	<b>Afati</b>	
	<b>Fillimi</b>	<b>Mbarimi</b>
Dokumenti Para-Studimor "Scoping"	Nëntor 2010	Mars 2011
Paraqitja e Dokumenti Para-Studimor "Scoping" tek Grupet e Interesit	Fundi i Marsit 2011	Prill 2011
Angazhimi në Vjim i Grupeve të Tnteresit (duke përfshirë edhe Anketat Familjare)	Prill 2011	Gusht 2011
Studime të Specialistëve në Terren	Prill 2011	Mesi i Qershorit 2011
Hartimi i Raportit të VNMS	Maj 2011	Shtator 2011
Paraqitja e Draftit Final të VNMS tek Autoritetet		Shtator 2011
Konsultimet dhe Paraqitja Publike e Draftit të VNMS	Shtator 2011	Nëntor 2011
Shqyrtimi nga Autoritetet i Draftit të VNMS	Shtator 2011	Qershor 2012
Finalizimi Përfundimtar i VNMS	Qershor 2012	Gusht 2012

## 8.1

*HYRJA*

TAP e konsideron konsultimin dhe angazhimin me palët e interesuara një pjesë integrale të procesit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS). Në përputhje me zhvillimin e pjesës Shqiptare të tubacionit të propozuar nga *Trans-Adriatik*, TAP ka zhvilluar një Strategji Angazhimi të Aktorëve, qëllimi i përgjithshëm i së cilës është të sigurojë një përfaqje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, e koordinuar, dhe e përshtatshme për nga pikëpamja kulturore për konsultimin dhe paraqitjen tek palët e interesuara. Përfaqja e ndërmarrë nga TAP është në përputhje të plotë me Rregulloret Shqiptare për VNM, Kërkesat për Performancë nga BERZH, si dhe politikat përkatëse të IFC-së dhe Bankës Botërore.

TAP ka ndërmend të ndërmarrë një proces të angazhimit të palëve të interesuara gjatë planifikimit të projektit, ndërtimit, operimit dhe fazave të nxjerrjes jashtë pune të tubacionit. Plani për këtë angazhim, duke përfshirë identifikimin e palëve të interesuara (dmth njerëz dhe organizata që kanë një rol në këtë projekt, ose mund të ndikohen nga aktivitetet e projektit, ose që janë të interesuar në projekt) dhe shpalosjen e informacioneve, konsultimit, dhe trajtimit të sugjerimeve, komentet dhe shqetësimet e tyre, është i dokumentuar në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesuara në Shqipëri. Ky plan do të jetë i përditësuar, siç kërkohet sipas përparimit të projektit.

Në *Seksionin 8.2* është paraqitur një pasqyrë e angazhimit të grupeve të interesit sipas fazave të planifikuara gjatë gjithë projektit. Aktivitetet e planifikuara për tu angazhuar gjatë fazës së studimit “scoping” janë detajuar më tej në *Seksionin 8.3*

## 8.2

*FAZAT E ANGAZHIMIT TË GRUPEVE TË INTERESIT PËR PROJEKTIN TAP*

## 8.2.1

*Përmbledhje*

Për të përmbushur objektivat e angazhimit të palëve të interesuara, Projekti TAP ka zhvilluar një plan për angazhim me palët e interesuara gjatë ciklit të jetës së Projektit. Plani parashtron një proces për konsultimin dhe paraqitjen e gjetjeve në pesë faza, ku secili ka objektiva pak të ndryshme. Këto faza janë përshkruar në *Tabelën 8.1*.

**Tabela 8.1 Fazat e Angazhimit të aktorëve gjatë VNMS**

<i>Faza</i>	<i>Objektivi</i>	<i>Statusi</i>
<i>Vlerësimet e Alternativave</i>	Objektivi i përgjithshëm i angazhimit të aktorëve kryesorë gjatë procesit të identifikimit të gjurmës së tubacionit ishte që të identifikoheshin problematikat mjedisore, sociale dhe kulturore që duhet të merren parasysh në zgjedhjen e gjurmës së preferuar.	<i>Përfunduar</i>
<i>Faza Para Studimore (Para VNMS)</i>	Qëllimi i këtij angazhimi gjatë fazës para- studimit të VNMS është të sigurojë hollësi të mëtejshme për projektin dhe një mundësi për palët e interesuara për të siguruar opinione mbi qëllimin, qasje në çështjet kyçe që do të trajtohen gjatë VNMS si dhe planet për aktivitetet e angazhimit të ardhshëm.	<i>Vijon</i>
<i>Studimi VNMS</i>	Angazhimi i grupeve të interesit gjatë fazës së VNMS do të ketë dy objektiva: të ruajë marrëdhëniet e zhvilluara gjatë fazave të mëparshme, dhe të sigurojë që të gjitha çështjet e palëve të interesuara janë identifikuar dhe trajtuar nga ana e Projektit. TAP do të rivizitojë autoritetet kombëtare dhe rajonale dhe do të angazhohet me komunitetet e prekura përgjatë korridorit të tubacionit të zgjedhur. Të gjitha palët e interesuara do të pajisen me përditësimin e projektit dhe një mundësi për të komentuar, të shprehur ndonjë shqetësim dhe për të diskutuar çështjet e ndryshme.	<i>Planifikuar</i>
<i>Paraqitja e VNMS</i>	Aktorëve do t'u paraqitet raporti draft të VNMS në fund të procesit të VNMS dhe ata do të ftohen të japin komentet e tyre. Informacionet mbi ndikimet e projektit do të paraqiten së bashku me masat lehtësuese të projektuara për të minimizuar apo përmirësuar ato.	<i>Planifikuar</i>
<i>Ekzekutimi i Projektit (ndërtimi, operimi dhe nxjerrja nga përdorimi)</i>	TAP do të vazhdojë të angazhohet me grupet e interesit në të gjithë ciklet e jetes së projektit. Metodologjia për këtë do të zhvillohet dhe do të përfundojë duke përdorur informacionin e hartuar gjatë procesit të VNMS.	<i>Planifikuar</i>

**8.2.2 Konsultimet Para fazes Para-Studimore “Scoping”**

Angazhimi i palëve të interesuara për të mbështetur zgjedhjen e korridorit për Projektin TAP u ndërmor në periudhën Maj 2009 dhe Mars 2010 dhe ka përfshirë një seri takimesh konsultative përgjatë korridorit të tubacionit në Korrik dhe Tetor 2009. Objektivat e përgjithshme të angazhimit të aktorëve kryesorë gjatë procesit të përzgjedhjes së alternative të korridoreve ishin: i) të prezantohej projekti i propozuar për palët e interesit të prekur potencialisht, dhe ii) të mblidhte informacionet përkatëse për procesin e përzgjedhjes së korridorit.

Angazhimi me autoritetet vendore dhe komunitetet e prekura potencialisht ka shërbyer për të mbledhur informacion mbi problematikat sociale, mjedisore dhe të trashëgimisë kulturore. Çdo shqetësim kyç ose çështje të nivelit të lartë që komunitetet kishin në lidhje me secilën alternativë të korridorit u identifikuan në këtë fazë të hershme. Për më tepër, gjatë prezantimit të projektit të propozuar tek palët e interesuara, ekipi ishte gjithashtu në gjendje të përfitonte një kuptim të asaj se si të popullata vendore e shikon projektin, nëse ata kishin ndonjë preferencë për korridorin dhe në qoftë se ka ndonjë ndikim të madh ose limitim.

Pas përfundimit të procesit të përmirësimit të gjurmës, *Alternativa 6* u konsiderua si korridori i preferuar - një përmbledhje e vlerësimit është dhënë në *Seksionin 3* të këtij raporti. Një program për paraqitjen publike është bërë në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor gjatë periudhës Qershor dhe Korrik 2010 për të informuar palët e interesuara qeveritare dhe OJQ në lidhje me rezultatet e procesit të përzgjedhjes së gjurmës dhe vendin e korridorit ku kalon gjurma e propozuar. Aktivitetet e Paraqitjes Publike përfshinë takime me Ministrinë në Tiranë, si dhe takimet në qarqet e Korçës, Beratit dhe Fierit. Një takim i katërt u mbajt në Çorovodë (Berat), për të lehtësuar pjesëmarrjen e kryetarëve të të gjitha komunave në fjalë.

Çështjet e identifikuar gjatë këtyre konsultimeve janë përmbledhur në *Tabelën 8.2* më poshtë.

**Tabela 8.2** *Përmbledhje e Çështjeve të Paraqitjes*

<b>Çështje</b>	<b>Komente</b>
<i>Cilësia e Vlerësimit</i>	Cilësia e punës u vlerësua dhe pjesëmarrësit në përgjithësi nuk patën kundërshtime ndaj arsytimit për zgjedhjen e <i>Alternativës 6</i> .
<i>Angazhimi i Hershëm</i>	Strategjia për angazhimin e palëve të interesuara që në fillim u konsiderua si mjaft pozitive duke qënë se ajo vendosi kuadrin për fazat e ardhshme të projektit.
<i>Në favor të projektit të propozuar</i>	Palët që u takuan në përgjithësi ishin në favor të projektit dhe shprehën dëshirën që aktivitetet e ndërtimit të fillonin menjëherë.
<i>Burimi i energjisë për Alternativën</i>	Projekti TAP u pa si një mundësi për furnizimin dhe një burim alternativ dhe i qëndrueshëm energjie në vend, duke kontribuar kështu në zhvillimin e tij. Aktualisht burimet kryesore të energjisë janë, hidrocentralet, nafta dhe drutë. Megjithatë, TAP informoi palët e interesuara që marrja e gazit në Shqipëri nuk ishte konceptuar aktualisht në kuadër të planit të projektit

Me qëllim për të mësuar më shumë për zhvillimet e planifikuara (të energjisë, minierave, urbane, etj), përgjatë gjurmës së preferuar dhe identifikimin e pengesave të mundshme në vend-ndodhjen finale të Stacioneve të Kompresionit dhe zbarkimit (dalja në det) (*shihni Seksionin 3*), TAP u ri-angazhua me disa palë interesi të qeverisë qendrore dhe rajonale për të mbledhur të dhëna kryesore bazë për vlerësimin.

Takimet u zhvillua në javën e fundit të Janarit 2011. Takimet janë mbajtur me Ministrinë e Qeverisë qendrore në Tiranë dhe Autoritetet Rajonale, Këshillat e Qarkut, Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), Drejtoritë e Pyljeve në Korçë dhe Fier.

## 8.3.1

## Objektivat

Objektivi i angazhimit gjatë fazës para-studimore që paraprin VNMS është të sigurojë hollësi të mëtjeshme për projektin dhe një mundësi për palët e interesuara që të japin komente mbi fushë-veprimin, përfaqshjen dhe çështjet kyçe që do të trajtohen gjatë fazës së studimit VNMS si dhe planet për aktivitetet e angazhimit të ardhshëm .

Theksi kryesor i angazhimit gjatë fazës para-studimore është të paraqesë projektin tek agjencitë qeveritare, OJQ dhe grupet e tjera kyçe, si dhe për udhëheqës të komunitetit. Këto organizata janë të shënuara në *Tabelën 8.3* më poshtë. Informacion gjithashtu do të shpërndalet për komunitetet vendore dhe për publikun e gjerë dhe do të hapen kanale komunikimi për të marrë reagimet e tyre.

**Tabela 8.3** Grupet kryesore të palëve të interesuara për Fazën e Angazhimit gjatë VNMS

Grupet e Interesit	Palët e Interesit
Qeveria Qëndrore	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) Ministria e Turizmit, Kultures dhe Sporteve Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPTT) Ministria e Mbrojtjes Ministria e Brendshme Enti Rregullator i Energjisë (ERE) Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)
OJQ dhe palë të tjera të interesit	OJQ (duke përfshirë ato rajonale / vendore) Grupet e komunitetit Organizatave me Bazë Komunitare Organizatave të Akademikëve dhe Kërkimit Agjensitë Ndërkombëtare të zhvillimit Media <i>Të tjerë (per tu identifikuar)</i>
Qeveritë Rajonale	Qeveria Rajonale (Prefektura Korçë, Berat dhe Fier) Kryetarët e Qarqeve Këshillat Rajonale Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM) Drejtoritë Rajonale të Rrugëve Drejtoritë Rajonale të Pyjeve Zyrat Rajonale e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Palët Vendore dhe Vendore	29 Kryetarë të Komunave / Bashkive 62 Kryepleq të Fshatrave Publiku i Gjerë

Lista e plotë e grupeve të interesuara, organizatave individuale dhe të komuniteteve është paraqitur në *Shtojcën C*.

### 8.3.2 *Aktivitetet e Angazimit të Aktorëve*

#### *Vështrimi i Përgjithshëm*

Takimet me Palët e Interesuara janë planifikuar në Tiranë, si dhe në qarqe për të lehtësuar pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar, në veçanti kryepleqtë e fshatrave që udhëtojnë nga zonat e thella. Plani për këto takime tregohet në *Tabelën 8.4*.

Aktivitetet specifike për paraqitjen e informacioneve dhe të kërkimit të komenteve nga grupe të ndryshme janë të përmbledhura në seksionet vijuese.

**Tabela 8.4** *Takimet për fazën Para-Studimore “Scoping”*

	<b>Tipi i Angazimit</b>	<b>Vendi</b>
11-15 Prill 2011	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbledhje kokë më kokë me palët e interesuara të Qeverisë Qendrore</li> <li>• Takim për fazën Para-Studimore me OJQ dhe palët tjera të interesuara</li> </ul>	Tirana
26-29 Prill 2011	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 4 takime rajonale për fazën Para-Studimore – “Scoping” (Autoritetet Rajonale dhe Vendore, Kryepleqtë e Fshatrave dhe OJQ vendore)</li> </ul>	Korça, Berat, Çorovoda dhe Fier

#### *Angazimi me Qeverinë Qendrore*

Agjencitë qeveritare qendrore kanë shprehur preferencë për takime një-me-një me Projektin TAP për të diskutuar projektin dhe raportin e studimit. Si pasojë, është planifikuar të dërgohet ky dokument (Dokumenti Para-Studimor të VNMS, ESD “Scoping”) në gjuhën shqipe tek palët e interesit të qeverisjes qendrore, me një letër shoqëruese duke i ftuar ata në një takim 1-1 me TAP. Letra e gjithashtu do të informojë ata për projektin dhe studimin VNMS.

Letra së bashku me ESD do të dërgohet 15 ditë para datës së propozuar për takim.

#### *Angazimi me OJQ dhe Organizata të tjera*

ESD do të dërgohet pranë OJQ, duke përfshirë OJQ rajonale, dhe palët e tjera të interesuara të shoqëruar nga një letër duke i ftuar ata të marrin pjesë në një takim të fazës Para-Studimore në Tiranë. ESD së bashku me letrën do të dërgohen 15 ditë para takimit të propozuar për të lejuar një në shqyrtim të thellë të dokumentit gjatë takimit.

Në takimin e fazës Para-Studimore, është planifikuar që të paraqitet një prezantim i projektit dhe i raportit të studimit përpara hapjes së takimit për pyetje dhe komente. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të paraqesin pyetjet apo të ngrejnë çështje, si dhe të paraqiten pyetjet dhe komentet për ndjekje gjatë takimit nëpërmjet fletëve për komente ose do të dërgohen më pas me postë ose përmes faqes ëeb të projektit.

### *Angazhimi me Autoritete Rajonale dhe Vendore, dhe me Kryepleqtë e Fshatrave*

Platët e Interesit të Autoriteteve Rajonale dhe Vendore, dhe Kryepleqtë e Fshatrave do të jenë të ftuar së bashku për të marrë pjesë në një nga katër takimet e fazës Para-Studimore që do të organizohet nga TAP. Në përgatitjen për takimet, TAP do të dërgojë ESD në gjuhën shqipe për të gjithë palët, me një letër shoqëruese duke i ftuar ata në takimin në rajonet e tyre përkatëse. Letra e gjithashtu do ti informojë ata për projektin dhe studimin VNMS.

### *Angazhimi me Komunitetet Vendore*

TAP/ENT është e angazhuar të vazhdojë angazhimin dhe konsultimet me komunitetet e prekura përgjatë gjurmës së tubacionit të zgjedhur për tu siguruar që projekti është shpjeguar plotësisht për komunitetet vendore dhe se shqetësimet e tyre dhe pikëpamjet mbi Projektin janë dëgjuar dhe marrë në konsideratë.

Gjatë fazës Para-Studimore, kanali kryesor i komunikimit do të jenë kryepleqtë e fshatrave. Kryepleqtë e Fshatrave do të marrin pjesë në takime rajonale për fazën Para-Studimore ku do të përfaqësojnë zonat e tyre dhe si të tilla do të ketë një rol për të luajtur në informacionet e mëtejshme mbi projektin dhe në bërjen të aksesueshme të kopjeve të ESD për palët e interesuara individuale.

Për këtë qëllim një fletëpalosje e shkurtër dhe një poster shoqërues me informacion në lidhje me Procesin e Studimit VNMS dhe mekanizmin e reagimeve do t'u shpërndahet të gjithë kryepleqve të Fshatrave gjatë takimeve rajonale për shpërndarjen e mëtejshme për tek komunitetet (shihni më lart). Kryepleqtë e Fshatrave do të kërkohen zyrtarisht të vënë një poster dhe fletëpalosjet në një vend të aksesueshëm në çdo fshat ose qytezë (p.sh. komunat, shkollat). Përveç kësaj një njoftim i përditshëm do të transmetohet në radiot vendore në javën para dhe pas takimeve rajonale për tu siguruar që të gjithë anëtarët e komunitetit dhe palëve tjera të interesuara në nivel vendor janë të informuar rreth projektit dhe procesit të Studimit VNMS, si dhe mekanizmit për dhënien e komenteve mbi projektin.

Konsultime të mëtejshme do të kryhen me anëtarët e komunitetit vendor duke përfshirë dhe popullatën e prekshme dhe grupet gjinore gjatë fazës së studimit VNMS. Për më tepër, të gjitha komunitetet do të ftohen të marrin pjesë në seanca të hapura publike gjatë paraqitjes të raportit përfundimtar VNMS kur informacioni mbi ndikimet e projektit do të paraqitet së bashku me mitigimet të përcaktuara për ti shmangur ose minimizuar ato.

### *Publiku i Gjerë*

Do të shkruhet një njoftim për gazetatat kombëtare për të siguruar që palët e interesuara dhe publikut i gjerë jashtë zonës së prekur drejtpërdrejt, janë të informuar rreth projektit dhe procesit të Studimit VNMS.

ESD do të jetë vendosur në faqen e internetit të projektit me një adresë e-mail për dorëzimin e komenteve.

Në përputhje me praktikën ndërkombëtare të mirë, është ngritur një proces me të cilin çdo person apo organizatë mund të kontaktojë projektin për të bërë pyetje ose të ngrejë një shqetësim. Ky proces do të detajohet në projektin e Planin e Menaxhimit të Mjedisit dhe Social (PMMS) dhe do të kryhet në përputhje me standardet e BERZH-it. Ky proces do të jetë i hapur dhe i arritshëm për të gjithë, i dizajnuar që ti përshtatet nevojave të ndryshme kulturore të të gjitha palëve të interesuara të mundshme, dhe do të merret me ankesat në mënyrë të drejtë dhe transparente. Të gjitha ankesat do të regjistrohen dhe do iu jepet përgjigje menjëherë, para se të mbyllet procesi.

Mekanismi i ankesave është pjesë e procesit të gjerë të angazhimit të palëve të interesuara nga TAP dhe sigurimit të cilësisë dhe të pajtueshmërisë. Ndërsa TAP është i angazhuar për të shmangur ankesat përmes përkushtimit të tij për një procesi të mirë e gjithmbarshëm të angazhimit të palëve të interesuara, Projekti është i vetëdijshëm se ankesat do të ndodhin dhe duhet të adresohen në besim të mirë dhe nëpërmjet një procesi transparent dhe të paanshëm.

Detaje mbi procesin e ankesave, duke përfshirë format e ankesave, do të jenë në dispozicion në faqen e internetit të projektit. Ato gjithashtu do të barten nga kryepileqtë e fshatrave gjatë angazhimit në fazën para-studimore.

Angazhimi i grupeve të interesit është një element i integruar i rëndësishëm i aktiviteteve të TAP dhe është menaxhuar me të njëjtat parime si të gjitha funksionet e tjera të biznesit: me objektiva të përcaktuara qartë dhe objektiva profesionale, staf të dedikuar, afate të përcaktuara dhe buxhete, përgjegjësi, dhe kontroll. TAP njihet rëndësinë e përkushtimit të burimeve të përshtatshme për procesin e angazhimit dhe krijimin e vijave të qarta të përgjegjësisë.

*Punëso, trajno, dhe angazho personelin e duhur : Gjatë angazhimit fillestar të palëve të interesuara, TAP do të konfirmojë se cilat prej grupeve të interesuara do të duhet të jenë të angazhuar gjatë fazave të ndryshme të ciklit të projektit. Angazhimi i llojeve të ndryshme të palëve të interesuara kërkon aftësi të ndryshme dhe konsiderata të personelit. Gjatë punësimit të personelit ndërlidhës me komunitetin, TAP do të konsiderojë njerëz të cilët kanë një njohuri të mira të problematikave vendore dhe të cilët do të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe të mbajnë marrëdhënie të mira pune me komunitetet vendore.*

*Qëndro në kontroll të angazhimit të palëve të treta: Stafi i TAP duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë angazhimeve me palët e interesuara, në mënyrë të veçantë me autoritetet për të siguruar që konsultimet janë të përshtatshme nga pikë pamja kulturore, nuk përjashtojnë ndonjë prej grupeve të interesuara, rrisin shpresat e rreme ose rezultojnë në angazhime jo realiste.*

*Strukturo punën rreth angazhimeve të regjistruara: TAP është e angazhuar plotësisht me përgjegjësi në procesin e angazhimit të palëve të interesuara pasi kjo është e domosdoshme, kur është fjala për të ndërtuar besimin dhe për të vendosur marrëdhënie të mira pune me palët e interesuara. Ndjekja e vazhdueshme kërkon regjistrimin e të gjitha angazhimeve të ndryshme të bëra për secilin aktor në emër të projektit.*

Një nga objektivat e rëndësishme të procesit të prezantimit të “Scoping” të VNMS është që t’u krijojë mundësi grupeve të interesit të japin opinionet e tyre në lidhje me Projektin. Në këtë kuadër, TAP ka parashikuar një proces që u krijon grupeve të interesit mundësinë për t’i dërguar komentet dhe sugjerimet e tyre me shkrim tek TAP, pasi të jenë zhvilluar takimet për procesin e “scoping”.

Kështu, TAP do të donte të ftonte të gjitha grupet e interesit të përfshira në procesin “scoping”, duke përfshirë komunitetet vendore dhe publikun e gjerë, që të paraqesin me shkrim komentet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me seksionin shqiptar të Tubacionit Tran Adriatik (TAP) deri në 30 Qershor 2011. Shtojca B paraqet një formular standard për të lehtësuar paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve si në anglisht ashtu dhe në shqip. Pjesëmarrësit në takimet “scoping” si dhe publiku i gjerë që është i interesuar për projektin, janë të ftuar të dërgojnë formularët e komenteve nëpërmjet postës elektronike ose në adresën e mëposhtme:

Trans Adriatic Pipeline AG – Albania (Dega e Shqipërisë)

Torre Drin, Rruga Abdi Toptani

Tel: + 355 44 308 770

Faks: + 355 42 265 685

Tirana, Shqipëri


[www.trans-adriatic-pipeline.com](http://www.trans-adriatic-pipeline.com)

[esia-comments@tap-ag.com](mailto:esia-comments@tap-ag.com)



Shtojca A  
**Hartat**

**(TAP-FEED-AL-EIA-REP-7028)**



### Legjenda

- Korridor (2 km)**: Dashed yellow line
- Alternativat**: Dashed red line
- Logjistike**:
  - Shesh kampimi: Yellow square
  - Shesh Ndërtimi: Purple square
  - Vendndodhje e mundshme e Stacionit të Kompresorit: Green square
- Rrugë Hyrëse**:
  - Rrugë të reja: Dashed green line
  - Rrugë të përmirësuara: Dashed orange line
- Kufij Administrativë**:
  - Prefekturat: Green outline
  - Komutat: Orange outline
  - Rrethe: Dashed orange line
- Rrugë Automobilistike**:
  - RD-1 Autostradë, Rrugë Kombëtare: Solid red line
  - RD-2 Rrugë Kryesore: Solid orange line
- Sociale**:
  - Bujqësi shumëkultureshe: Sun icon
  - Prodhim bujqësor: Sun icon
  - Ferma Blektorale: Sun icon
  - Mjete Jetike: Sun icon
  - Industriale: Sun icon
  - Ekonomi e Shumëllojshme: Sun icon
- Rëndësia e siteve të Trashëgimisë Kulturore**:
  - Shumë i rëndësishëm: Pink circle with X
  - Mesatarisht i rëndësishëm: Yellow circle with X
  - Pak i rëndësishëm: Yellow circle with X
- Potencial Arkeologjik**:
  - Potencial i Lartë Arkeologjik: Orange line
- Hidrologji Kryesore**:
  - Lumë: Blue line
  - Ligatinë: Light blue line
- Zonë e Mbrojtur**:
  - Zonë e Mbrojtur: Green area
  - Monument natyre: Green tree icon


(\*) Kufijtë e Parkut Kombëtar të Lagunes së Karavastasë janë marrë nga një hartë dixhitale. Shkalla është e përafërt. Shkalla origjinale 1:4000,000 Data: 2009


VIZATIME REFERUESE:

TITULLI I DOKUMENTIT:	Nr. DOC.:
Raporti i Studimit, Scoping të VNMS-së (ESIA) për Shqipërinë	TAP-FEED-AL-EIA-REP.7028



2	30/03/2011	IFA	MCP	MTV	ASM
RSHK	DATA	ISSUE, SCOPE OF REVISION	PËRG.	KONTROLL	MIR.
KLIENT:					
Trans Adriatic Pipeline					
PROJEKT: Gazsjellësi Trans Adriatic (TAP) Faza e Prejktimit Inxhinierik (FEED)					
TITULLI I VIZATIMIT: Gjendja bazë Mjedisore-Ekonomiko Sociale Trashëgimisë Kulturore – Në pjesën kontinentale					
SHKALLA:	PROJEKT:	Nr. VIZATIMIT:	FLETË E		
shih grafikun e shkallës	0092333	1	1 / 3		





### Legjenda

**Korridor (2 km)**  
 Korridor (2 km)

**Lojistike**  
 Shesh kampimi  
 Shesh Ndërtimi  
 Vëndndodhje e mundshme e Stacionit te Kompresorit

**Rrugë Hyrëse**  
 Rrugë të reja  
 Rrugë të përmirësuara

**Kufij Administrativë**  
 Prefekturat  
 BERAT  
 FIERÇE  
 KORÇE  
 Komutat  
 Rrethe  
 Kapital  
 Vëndbanime

**Rrugë Automobilistike**  
 RD-1 Autostradë, Rrugë Kombëtare  
 RD-2 Rrugë Kryesore

**Sociale**  
 Bujqësi shumëkulturëshe  
 Prodhim bujqësor  
 Ferma Blektorale  
 Mjete Jetike  
 Industriale  
 Ekonomi e Shumëllojshme

**Rëndësia e siteve të Trashëgimisë Kulturore**  
 Shumë i rëndësishëm  
 Mesatarisht i rëndësishëm  
 Pak i rëndësishëm

**Potencial Arkeologjik**  
 Potencial i Lartë Arkeologjik

**Hidrologji Kryesore**  
 Lumë  
 Ligatinë

**Zonë e Mbrojtur**  
 Monument natyre  
 PARKU KOMBËTAR BREDHI I HOTOVËS DANGËLLI


(\*) Kufijtë e Parkut Kombëtar të Lagunes së Karavastasë janë marrë nga një hartë dixhitale.  
 Shkalla është e përafërt.  
 Shkalla origjinale 1:4000,000  
 Data: 2009


VIZITIME REFERUESE:

TITULLI I DOKUMENTIT:	Nr. DOC.:
Raporti i Studimit, Scoping të VNMS-së (ESIA) për Shqipërinë	TAP-FEED-AL-EIA-REP.7028



2	30/03/2011	IFA	MCP	MTV	ASM
RSHK	DATA	ISSUE, SCOPE OF REVISION	PËRG.	KONTROLL	MIR.
KLIJENT:		Trans Adriatic Pipeline			
PROJEKT:		Gazsjellësi Trans Adriatic (TAP) Faza e Prejktimit Inxhinierik (FEED)			
TITULLI I VIZITIMIT: Gjendja bazë Mjedisore-Ekonomiko Sociale Trashëgimisë Kulturore – Në pjesën kontinentale					
SHKALLA: shih grafikun e shkallës	PROJEKT: 0092333	Nr. VIZITIMIT: 1	FLETË E 2 / 3		





### Legjenda

- Korridor (2 km)
- Logjistike**
  - Shesh kampimi
  - Shesh Ndërtimi
  - Vendndodhje e mundshme e Stacionit te Kompresorit
- Rrugë Hyrëse**
  - Rrugë të reja
  - Rrugë të përmirësuara
- Kufij Administrativë**
  - Prefekturat
  - Komutat
  - Rrethe
- Rrugë Automobilistike**
  - RD-1 Autostradë, Rrugë Kombëtare
  - RD-2 Rrugë Kryesore
- Sociale**
  - Bujqësi shumëkultureshe
  - Prodhim bujqësor
  - Ferma Blektorale
  - Mjete Jetike
  - Industriale
  - Ekonomi e Shumëllojshme
- Rëndësia e siteve të Trashëgimisë Kulturore**
  - Shumë i rëndësishëm
  - Mesatarisht i rëndësishëm
  - Pak i rëndësishëm
- Potencial Arkeologjik**
  - Potencial i Lartë Arkeologjik
- Hidrologji Kryesore**
  - Lumë
  - Ligatinë
- Zonë e Mbrojtur**
  - Zonë e Mbrojtur
  - Monument natyre
  - PARKU KOMBËTAR BREDHI I HOTOVËS DANGËLLI

(\* Kufijtë e Parkut Kombëtar të Lagunes së Karavastasë janë marrë nga një hartë dixhitale. Shkalla është e përafërt. Shkalla origjinale 1:4000,000 Data: 2009

### VIZATIME REFERUESE:

TITULLI I DOKUMENTIT:	Nr. DOC.:
Raporti i Studimit, Scoping të VNMS-së (ESIA) për Shqipërinë	TAP-FEED-AL-EIA-REP.7028




2	30/03/2011	IFA	MCP	MTV	ASM
RSHK	DATA	ISSUE, SCOPE OF REVISION	PËRG.	KONTROLL	MIR.

KLIENT: **Trans Adriatic Pipeline**

PROJEKT: **Gazsjellësi Trans Adriatic (TAP) Faza e Prejktimit Inxhinierik (FEED)**

TITULLI I VIZATIMIT: **Gjendja bazë Mjedisore-Ekonomiko Sociale Trashëgimisë Kulturore – Në pjesën kontinetale**

SHKALLA:	PROJEKT:	Nr. VIZATIMIT:	FLETË E
shih grafikun e shkallës	0092333	1	3 / 3



### Legjenda

- Rasti bazë
- Alternativat Shqiptare
- Gjurma 00a
- Gjurma 00b
- Gjurma 01 1.2
- Gjurma 01
- Gjurma 02
- Gjurma 03a
- Gjurma 03b
- Gjurma 04
- Gjurma 04a
- Gjurma 04b
- Gjurma 04c
- Gjurma 04d
- Gjurma 04d alternativë
- Ndalim Ankorimi
- Zona e Ngarkimit
- Zonë grumbullimi materialesh eksplozive
- Zonë Peshkimi
- Zonë Ushtarake
- Zonë Trafiku
- Kryepus
- Kabëll
- Linjë 12 milje
- Batimetri e hollësishme (10m)
- Batimetri

### VIZITIME REFERUESE:

TITULLI I DOKUMENTIT:	Nr. DOC.:
Raporti i Studimit, Scoping të VNMS-së (ESIA) për Shqipërinë	TAP-FEED-AL-EIA-REP-7028



2	30/03/2011	IFA	MCP	MTV	ASM
RSHK	DATA	ÇESHTJE, QËLLIMI I RISHIKIMIT	PËRQ.	KONTROLL	MIR.

KLIENT:

Trans Adriatic Pipeline


PROJEKT:

Gazsjellësi Trans Adriatic (TAP)  
Faza e Prejektimit Inxhinierik (FEED)

TITULLI I VIZITIMIT:

Alternativat e gjurmës së TAP në det

SHKALLA:	PROJEKT:	Nr. VIZITIMIT:	FLETË E
shih grafikun e shkallës	0092333	2	1 / 1



### Legjenda

- Alternativat e kalimit nga toka ne det
- Korridor
- ZONË E MBROJTUR
- PARKU KOMBËTAR BREDHI I HOTOVËS DANGËLLI
- Kufiri me Greqinë
- Komunat
- Rrethe

(\*) Kufijtë e Parkut Kombëtar të Lagunes së Karavastasë janë marrë nga një hartë dixhitale. Shkalla është e përafërt. Shkalla origjinale 1:4000,000 Data: 2009

#### VIZATIME REFERUESE:

TITULLI I DOKUMENTIT: Raporti i Studimit, Scoping të VNMS-së (ESIA) për Shqipërinë	Nr. DOC.: TAP-FEED-AL-EIA-REP.7028
---	---------------------------------------



2	30/03/2011	IFA	MCP	MTV	ASM
RSHK	DATA	ÇESHTJE, QËLLIMI I RISHIKIMIT	PËRG.	KONTROLL	MIR.

KLIENT:  
**Trans Adriatic Pipeline**



PROJEKT:  
**Gazsjellësi Trans Adriatic (TAP)  
Faza e Prejktimit Inxhinierik (FEED)**

TITULLI I VIZATIMIT:  
**Gjurmët Alternative të TAP në territorin Shqipëtar**

SHKALLA: shih grafikun e shkallës	PROJEKT: 0092333	Nr. VIZATIMIT: 3	FLETË E 1 / 1
--------------------------------------	---------------------	---------------------	------------------



Shtojca B  
**Formulari i Komenteve**  
**(TAP-FEED-AL-EIA-REP-7028)**





Shtojca C  
**Lista e Grupeve të Interesit**  
**(TAP-FEED-AL-EIA-REP-7028)**

## **PËRMBAJTJA**

<b>1</b>	<b>GRUPET E INTERESIT TË QEVERISJES QENDRORE</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>GRUPET E INTERESIT TË QEVERISJES RAJONALE DHE VENDORE</b>	<b>3</b>
<b>3</b>	<b>OJF DHE PALËT E TJERA TË INTERESUARA (NË NIVEL KOMBËTAR &amp; RAJONAL)</b>	<b>6</b>

<b>Institucionet</b>	<b>Departamentet</b>
Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtoria e Përgjithshme e Politikave</li> <li>▪ Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave</li> <li>▪ Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit</li> <li>▪ Drejtoria e Biodiversitetit</li> <li>▪ Drejtoria e Burimeve Ujore dhe Peshkimit</li> </ul>
Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit Ekonomik</li> <li>▪ Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Tregtare</li> <li>▪ Departamenti i Liçensimit dhe Konçesionit</li> <li>▪ Drejtoria e Planifikimit Strategjik</li> <li>▪ Departamenti i Zhvillimit të Biznesit</li> <li>▪ Drejtoria e Integritetit Tregtar</li> </ul>
AKBN – Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtoria Hidroenergjetike</li> <li>▪ Drejtoria e Hidrokarbureve</li> </ul>
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtori</li> </ul>
ERE- Enti Rregullator i Energjisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut</li> </ul>
Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtoria e Turizmit</li> <li>▪ Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore</li> </ul>
Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtoria e Arkeologjisë</li> </ul>
Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtori</li> </ul>
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtoria e Politikave dhe Planifikimit të Transportit</li> <li>▪ Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor</li> <li>▪ Instituti i Studimeve dhe Projektmeve Urbanistike</li> <li>▪ Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës-Kanalizime</li> <li>▪ Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve</li> </ul>
